

PETRO

MARKO

BIBLIOTEKA

E

814-32

2432

SHTETIT

GJIROKASTËR

rrugë
pa
rrugë

85A-32

PETRO MARKO

V. Shkëlzi
Kl. i K. i
H. Zan

M 32

RRUGË PA RRUGË

tregime dhe skica

2630



N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1964

VARFËRIA

Jam i varfër!

Gdhihet dita shumë e çmuarshme e stinës ëngjëllore dhe unë, duke hedhur mënjanë shkorsën time të vjetër, ngrihem prej gjumit të ëmbël e plot ëndra. Shikoj me sytë gjysmë të çelur agimin freskatar që zbardhulloi me dritë argjëndare gjithë katundin e vogël. Shtëpia ime varfanjake e pret me padurim diellin, se vetëm ai ka mirësinë ta vizitojë. . .

Vij rrotull dhomës sime, një dhomë e varfër dhe e vetme e kasolles. Të katër muret e palyera më vështrojnë dhe bëjnë sikur duan të më thonë: «Mirëmëngjes!» Nuk ka dyshime. Dheu këtu-atje është bërë gropa gropa prej pikave të shiut që hyjnë pa pikë turpi dhe frike. Atje, afër dritares së vockël, nga duket fusha e bukur dhe deti i gjërë, atje mbi një cipal të futur në mur, është varur trasta ime lumëmadhe dhe pak më poshtë, afër derës së mbyllur me një degë ulliri, ndodhen opin-gat e mia të coptuara. Pa larë sytë, se s'kisha ujë, ngrita rrobat e fjetjes, domethënë vetëm shkorsën, se atë kisha, dhe e hodha në gardhin gati të rrëzuar të kopshtit tim të lënë djerr. Vura re se disa in-

sekte të vogla, disa kafshëza... hidheshin hera-herës në duart e mia. Dukej se u prisha edhe këtyre zotrive qetësinë! Nuk bënin zhurmë, nuk ndiheshin dhe nuk deshën gjë tjetër veçse pak gjak prej timit, se kisha shumë! Dhe çudi, këto kafshëza na e pijnë gjakun, po me qetësi, duke mos na çarë kokën, ndërsa kafshët e tjera... na e pijnë gjakun me fuqi dhe me mundime. Vërtet çudi është, thashë po nuk mejtova rrënjëdali se jam i varfër. Deh! Kjo mëndje e të varfërit ku vete e ku është!

Hodha përçark sytë mos shihja ndonjë copë bukë, po më kot, se ëndra ishte shuar bashkë me errësirën. Trazoj trastën, shikoj i uritur, po më kot, se as thërrime s'gjeta. Nuk e mbaja mënd mirë se kur kisha ngrënë...

Hodha trastën mbi supe dhe u nisa për ku nuk dija... Këngës ja thosha, po çudi se përcillej prej disa lotëve që rrokulliseshin në faqet e mia të thara petë.

— Jam i ri, — brita, — jam i ri ! Dua të punoj, dua të rroj, dua... po pse kështu? Pse!...

E, po pse bërtas kështu unë? Mos më dëgjon ndonjë njeri se më quajnë e më quajnë të varfër, po të më thërrasin edhe të çmendur... Dale, ku jam këtu!

Duke ecur qëndrova më një vend dhe thashë me vete: — Për ku jam nisur?

Dreqi e marrtë, dua të bëhem njeri, dua te punoj, po s'gjej dot punë, s'gjej bukë, s'kam shtëpi, s'kam se ç'bëj, s'kam se ku vete. Shikoj këta të tjerët si këndojnë e si shkojnë me gaz, veshur mirë, thonë çfarë të duan, bërtasin, por unë i ziu s'kam gojë, më mungon gjuha. Dreqi e marrtë këtë punë

— e thashë prapë këtë fjalë — dua të flas, po kam frikë se do të më rrahin më rëndë se herët e tjera. Unë s'u bëj gjë. S'i ngas. Jam si jam, siç më bëri Zoti. Unë i dua, por ata s'më duan, s'më shikojnë dot me sy. Unë i mburr, u bie në gjunjë, u puth dorën,... këmbën, po ata më japin shqelme. Gjithçka që kisha m'i muarën se dinë të flasin, janë të fortë... më dhanë një herë bukë të helmatisur. të qullur me djersën time. Edhe shtëpinë që kam, duan të ma marrin, edhe atë kopsht që kam, s'duan të ma lënë. Ata kanë plot! Janë njerëz... ç'të duan bëjnë, po unë i gjori! E ç'e duan kasollen time, o djall — o zot, desha të thosha — ë de ç'e duan?

Për zotin, unë s'kam mendje, s'kam kalem, s'ma pret, po prapë marr guximin t'i them vetes mengadalë: «ç'e duan?» Kanë të drejtë, se janë njerëz. Unë hallemadhi u bie ndër këmbë e u them të më japin ndonjë punë ose fundi të më lënë të lirë bashkë me vëllanë tim, që mori dynjanë më këmbë për bukë, të na lënë të lirë të punojmë në kopshtin tonë, po Zoti mos e dhëntë, s'më dëgjojnë. Tashiti nuk u flas më se kam frikë mos më fusin edhe... në burg. Çudi nuk është, jo, se shokët e mi jetëshkurtër po prehen në hijen e varrit të të gjallëve. S'i kam pyetur e nuk e di, atje a u japin bukë?!...

Dhe, se ç'mendime më shkonin ndër mënd, ose ç'ëndra të kota... Ja dhe një çudi e tetë: Të ëndërosh syhapët! Do të ëndëroja akoma, po të mos kish ardhur një zonjë që më doli përpara:

— Ku shkon kështu, o djali im? — më tha dhe më ndenji nja dy hapa larg. Unë, i harruar, u ndala dhe, duke mos humbur kohë, i thashë:

— Mbeta keq, o mëma ime!

Ama jo i harruar. Mua mëma më kish vdekur kush e di që kur dhe unë i fola «o mëma ime!»

— Duhet të kesh qënë i lumtur, biro! Pse këshu të mbetesh keq? Tregomë shkakun.

Unë desha t'i thosha gjithë sa ëndëroja dhe thosha me mendjen time pak më përpara, po nuk munda se u hutova më tepër kur më tha «duhet të kesh qënë i lumtur». Nuk e kisha parë mirë, por, kur i hodha sytë, u harrova më tepër. E ç'të shihja? Një zonjë, një zërë, zërë, e gjallë, me leshrat e lëshuar, e zbardhur; vetëm një rrobe e vjetër mbulonte trupin e perëndishëm të saj...

Fytyra e saj gjithmonë buzëqeshte, e shumë herë m'i vrau sytë e mi të pafuqishëm. Në brez kish-te një fyell të gjatë.

Në duar mbante një furkë dhe një bosht që tirtë lesh apo nuk e di se ç'ishte. Ballin ja mbulonin leshrat e hirta.

— Pse, pra, të mbetesh keq, — vazhdoi duke më thënë. — Oh, se sa i lumtur duhet të kesh qënë! Ti pse i le fëmijt e tu të vdisnin për bukë? Pse s'u bashkove me vëllanë tënd, por e le të iki... A nuk ishe i lumtur kur shkoje me gruan tënde, aty afër shtëpisë sate, në kopsht, e punoje me të duke kënduar? Nuk ishe i lumtur, kur i lodhur, shtrihesh në barërat e lira të natyrës? Eh, sa lumturi, kur të dy bashkë mblidhnit lakrat që sa të lira janë, aq shtrenjtësi kanë, dhe me një kusi të vjetër i zienit dhe prapë kur nxirrnit kulaçin bojëari të nxehtë dhe shtronit tryezën tuaj dhe hanit bukë të kënaqur?

Nuk të gëzohej shpirti kur gruaja jote kthehej prej burimit e ngarkuar me bucelë dhe me një kungull në duar, duke të gostitur me ujë të freskët,

i cili sa i lirë është, aq shtrëjtësi ka? A nuk ishte i lumtur kur agimeve magjiplote këndoje bashkë me zogjtë e bilbilat, që të zgjonin dhe thithje erë të pastër, e cila sa i lirë është aq shtrëjtësi ka? Ç'thua, pra, nuk të pëlqen ajo jetë plot lumturi, ajo jetë e shtrënjtë e plot gëzime, kur dhe unë me këtë fyell që kam në brez të argëtonja e të bëja më të lumtur në botë?...

Fliste dhe më tepër nxehej e bërtiste. Dhe unë, i harruar, nuk dija ç't'i thoshja.

— Jam unë, mëma jote, që ndjej atë që më falli i madhi Zot, jam mëma jote që tjerr jetën time. Shihe këtë lëmsh, dhe këtë shtëllungë se sa e madhe që është. Do të vonoj shumë ta tjerr, se është i shumtë dhe i ngatruar... E po të mbaroj, mbaron dhe ti të jesh djali im. Dhe unë të jem mëma jote!...

U bë gati që të ikëte. Dorën e djathtë, së cilës i pështynte nganjëherë dy gishtrinjtë, e ngriti lart, bëri mënjanë leshtrat, sa mezi munda të dalloja në ballin e saj fjalën «VARFËRIA»

* * *

Një të tundur të fortë ndjeva.

— Ç'pate, pse ke rënë këtu në mes të udhës?

Mezi hapa sytë dhe pashë një njeri të më ngrente mengadalë. Ishte një njeri me fytyrë të zbetë që pasqyronte një mijë të zeza. Fuqia më ishte prerrë. S'mund të flisja më...

— Ah, ti je, o vëllai im! E pse kështu, kush të vrau? E shikoj mirë e me kujdes... Qënkësh vëllai im, që kish tri ditë që ish zhdukur nga shtëpia për të gjetur ndonjë punë. I pashë lotët që i shkonin

rrëke. I pashë dorën që ma zgjati duke më dhënë një bukë...

...U përmënda, e përqafova vëllanë tim të dashur dhe bashkë me të u nisëm për në kasollen tonë. Rrugës më binin në mend fjalët e zërës, m'u kujtua dhe emri i bukur që mbante në ballë dhe. i çuditur, thashë me vete:

— Vërtet, ajo qënka mëma ime!

«ORA» Korrik 1932

Z I A

Bota bërtiste — Bukë, bukë!... Po kush e dëgjonte? E po ç'të bënte populli i shkretë, kujt t'i drejtohej!

Mblidheshin katundarët. Ziheshin e bërtisnin, «jo unë s'kam shtëpi», «jo unë s'kam asgjë se e shita»... «jo m'u tha misri...» një zhurmë, një ankim i vdekur.

— Eja, more, kuje, e marrtë dreqi e marrtë... Kemi parë, or kemi parë, po si këtë zi! Jo more shpirt, kurrë, për zotin e vërtetë.

Thoshin pleqtë të çuditur. Çdo vit dhe më keq. Familje vdisnin për bukë, për bukë misri! Më i pashuri ose princi i vëndit ishte ai që hante bukë, bukë!...

Lart, në mal, na ishte një bareshë, grua e ve, me dy fëmijë të saj. Qante, vajtonte.

— Nëno, duam bukë, kemi uri.

— Ja po u bie unë, djemo, duroni dhe pak...

Gruaja fatkeqe, e vetme në kasolle, thërrte ndonjë berr, e piqte në hell dhe ushqente djemt e saj. Kaluan ditë. Të vegjëlit kërkonin bukë. Mishi u griu zorrët! Ajo nuk kishte. Shkonte në stanet e largme dhe lypte ndonjë thërrime, por edhe ata s'kishin.

— Ç'të bëj nata, mbeta qyqe! Kujt t'i drejtohem!

Mori dhe ajo katër a pesë kokë dhën, i vuri përpara, puthi fëmijt e saj, të cilët i la vetëm në stan, dhe u nis për në treg.

— E ku shkon, o Fatime? — i briti një çoban që, duke i rënë fyellit, po kulloste kopenë e tij të madhe. Ajo s'e dëgjoi, se mejtotej për fëmijt e saj dhe lotët i derdheshin rrëke duke vajtuar me vaj shpirtkëputës.

— Bariu bërtiste..

— Ja, po shkoj të blejë... pak miell.

— Shko, moj, dhe ki mëndjen se mos të derdhet udhës! — i tha bariu ironikisht, dhe filloi punën e tij duke i rënë fyellit ligjëronjës.

Me mundime mbrijti në treg. Për gjithë ditën mundahej t'i shiste dhëntë, po njeri s'i blinte. Jo vetëm, po as që i shikonte njeri fare.

Dëgjonte baresha trubullira, ankime populli që kërkonte bukë. Burra, fëmijë, pleq, çanin magazi, thyenin furra, bërtisnin: — Vdesim për bukë!

Kjo u tërbua. Nuk e mbante vëndi për fëmijt e saj.

— Do shkoj... po bukë? Më presin! Janë gjallë?... Po, po, u kam lënë mish!.. po...

U ra dyerve të qytetit. Nuk la shtëpi.

— Më falni... pak bukë, se fëmija më vdes nga uria. Kam pesë kokë dhën!

Të gjithë e vështronin, mallëngjeheshin për të, po ç'ti jipnin.

U hutua. «Djemt e mi!» Iku. Dielli perëndonte. Shashica ishte larg.

— E zeza, o djemo!

U fut në ullijt që shpërndanin një errësirë.

Shikonte në anët gurë të bardhë që ndriconin nën hijen e majme. Janë shënjat që dëftojnë banimin varfanjak të dëshmorëve, që ranë fli për Atë që gjallën. Kjo iu drejtua varrit të burrit të saj dhe me lot ndër sy i ra përsipër duke thënë këto fjalë: 1)

— Flij i qetë, se ti detyrën tënde e bëre... e bëre siç duhej, se ngjalle Atë që këndoje e ëndëroje, po unë e zeza, unë e mjera... ku më le mua, ku i le djemtë... Oh, djemtë e mi ku janë! — dhe fluturoi për në mal.

Errësira kish mbuluar gjithësinë. Kasollja ishte larg. Nga mos ngrënja, këmbët i pritëshin. Nuk ishte më në vete. Mejtohej për djemtë. Dolli në mal e këputur. Me mundim dallonte kasollen e saj.

— Sulooooo, Sulo...

Asgjë s'ndihej. Qeni i stanit të saj që i njohu zërin, iu afrua dhe, duke lëvizur e tundur bishtin, i binte në gjunjë.

— Sulooo,.. Shegoooo... ku më jini?

Fishkëllente era dhe nata mbretëronte me qetësi. U hutua. Ju afrua kasolles.

— Sulo, Shego, o Sulo!

Vështron e nuk sheh gjë! Ndezi një copë pishë.

— Më muarrë dunjanë për bukë kanë ikur!

Futet në kasolle. Shikon të dy djemt e saj të dashur që ishin përqaftuar si dy ëngjëj. E marrosur i shtrëngon, i pushton, u flet, bën që t'i ndaj, qan... por ata s'dëgjonin, nuk ndaheshin...

«ORA» janar 1932

1) = dëshmorët e luftës së Vlorës, 1920.

SHËNJTORJA E VOGËL

— Ah, o varfëri... — psherëtiti i këputur. Fytyra iu ndryshua, sytë iu mbytën në lotë dhe, duke ndenjtur majë një harceje, vështronte prej së largu katundin e bukur të Dhërmiut që po e linte. Errësira mbulonte gjithësinë. Vështronte me mallëngjim në shtëpi të tij, një dritë, e cila dalngadalë po humbiste. Për pak shkëlqeu para Çikës së lartë hëna që me shpejti derdhëte mbi dhe rrezet e saj magjistare. Foti nuk lëviste nga vendi, po, si i ngurruar, çmallej duke parë vendin e tij lindor. Ktheu sytë përtej dhe pa brigjet ku kishte kaluar kohën duke kullotur dhënt e tij. Lotët i rridhnin si burim, se largohej për në mërgim; psherëtinte se mëmën e la plakë, të sëmurë, dhe kush e di nëse do ta gjente. gufonte se gruan e la shumë të re dhe pa fëmi, la të vëllanë shumë të vogël dhe gjën në duart e botës.

Qetësi. Hëna vazhdonte mërgimin e saj të përhershëm në hapsirën e heshtur dhe pakufi; deti dëgjohej atje poshtë që pa mëshirë rrihte zallin zëmërbardhë. Hëna mriji në mes të qiellit dhe Foti edhe s'përmëndej. Lotët nuk i mbante.

— Eh, o male, pse s'më flisni, pse kështu, ju më vështroni! Më thoni udhembarë, se po largohem prej jush, iki për dhera të largëta. Oh Çikë, o Çikë,

folmë... Ekoja e një shkëmbi të afërmë i përsëriti fjalët!...

Dhe duke shkuar përmes pyllit të dëndur të Llogarait, humbi i trishtuar e i këputur në ankim.

* * *


Koha rrokullisej në hapësirën e kalimit dhe familja e Fotit asqë mirrte ndonjë lajm prej tij. Kalluan muaj, shkuan vjete, dhe trishtimi shtohet në këtë familje varfanjake. Mëma e tij plakë, e kërrusur, me një fytyrë të zbetë që pasqyronte një mijë të zeza, e qante djalin e dashur, të cilin ja rrëmbeu varfëria prej gjirit të saj. I vdekur, i gjallë, s'dihej gjë! Nuk dinte njeri ku gjindej.

Qante dhe Thina e bukur, qante pa ngushëllim për burrin e saj, për Fotin e dashur që e la të vetme. Një fatkeqësi për atë çupë ëngjëllore që me bukurinë e saj bënte shoqet ziliqare. Sytë i kish të zes sa dhe errësira, leshrat të gjata bojë-ari dhe trupi i saj i hollë e i gjatë bëheshin hyjnor prej fjalës dhe sjelljes së ëmbël. Mirëpo, simbas zakonit, shpifjet e shoqeve të saj ishin të zjarra dhe të poshtra. Kjo, krenare, po e shtypur prej varfërisë, priste ndonjë lajm prej të shoqit, po më kot...

Dita i bëhej shekull. Jeta iu mërzit, shtëpia i dukej burg. Priste më kot. Qante pa pushim.

— Jetë, o jetë... e deri kur do tiranizohem prej fatit tim të zi! — mërmeriste dhe shpresa i fikej në pellgun e zi të zemrës së saj.

Bota lëvizte, punonte, qeshte, loste. Shtëpia e Fotit e veshur në zi. Asnjëri nuk mirrte rrugën për atë ndërtesë fatkeqe. Vetëm një djalë i hieshëm, i veshur mirë, kalonte përhersë poshtë anitareve du-



ke kënduar. Koha kalonte, po i riu nuk lodhej së kënduari:

Prite, prite më të kot,
Prite, o dallëndysh'e lehtë,
Prite, o zer' biskar' e mshehtë,
Prite burrin që s'vjen dot!
Frite burrin më të kot
Dhe për të mbytu në lot!...

Këndonte e këndonte pa u lodhur e bredhërinte rreth e përqark dritareve, ku, e mbytur në mallëngjim, rrinte vajza e bukur, nusja e djalit mërgimtar.

— Ah! O Thinë, — i briti mengadalë përposh dritares së ulët, — pse mejton, pse tretesh duke qarë! Mos u mundo kaq dhe mos prit së koti, por hidh në kokën tënde ëngjëllore, hidh cipën e zezë, ose hidh për së dyti cipën e bardhë me mua që të adhurroj, se Foti yt u mbyt në Oqeanin e thellë...

Vajza pa bërë fjalë, u zverdh dhe si pashpirt ra përdhe. Dhe plaka jetëshkurtër, pa ndjerë gjë, ishte shtrirë në një mur të oborrit, ku dielli, fryma e të pavdekurvet, lëshonte rrezet e tij të arta në trupin e saj e krusur.

Fluturonte mendja e vajzës së bukur...

Përqafile kishte prej Fotit të saj. Në gëzim, qeshte e mallosur, fjaloste me të shoqin, të cilin dukej se e pushtonte me mall. Dhe ja, për pak u rërmënd. E hidhëruar solli syt për anë dhe pa me habi rroben e zezë që i mbulonte trupin rrëzor dhe si qyqja në shkreti, ja nisi vajtimit të përmallshëm...

Një mëngjes të ëmbël, kur kënga trumbetore e kokoshëve kishte lajmuar gjithësinë për mbritjen e ditës së re, Thina e bukur, e vetme si gjithmonë,

ndodhej larg katundit, ku kishte vajtur për dru. E lodhur, duke vajtuar kthehej e ngarkuar në shtëpinë e vet, po për çudi pa prej së largu një gjë që e habiti: gjithë oborri i shtëpisë së saj, vetmimtare që mbushur me njerëz!

— Pse, vallë, fshati i gjithë është më këmbë dhe pse, të gjithë i drejtohen kasolles sime? — E zhytur në këtë mister, kalonte brigjet e ngarkuar dhe shpejtonte të shikonte gjithë atë farë njerëzi që kurrë s'ishte mbledhur në atë shtëpi, veçse në kohën e nusërisë së saj...

— Pse, o Zot! — thoshte, — mos ka ardhur Foti im? Po ç'them, ai s'gjendet më, është mbytur larg meje, larg!...

Me padurim arrijti. Para derës pa një arkivol, rreth të cilit disa plaka molloisnin! E pikëlluar, vajza rrëzore ra mbi plakën, ra mbi vjehrën e saj të gjorë që ndroi jetë me ankim, e mbyllur në një dhomë të vetme pa njeri!...

Porsi një bilbil i vetëm, i mbyllur në një kafaz të hekurt pa shpresë shpëtimi, kështu vajza besnike ndodhej për një kohë të gjatë në shtëpinë e saj të pafat. Po i riu, si student që ishte, shkonte pa pra përposh dritareve të saj. Kënga e tij në atë vend ishte si zëri në shkreti.

Mbete, e zeza kallogre,
Mbete qyqe në shkreti!
Oh, se ç'mbete pa njeri:
Dhe as eja si rrufe,
Bashkoju me shpirtin tim
Të vdiq burri në mërgim...

Këto fjalë coptonin zëmrën e lënduar të vajzës biskare. «As eja, eja e eja, o Thinë... eja të bashkoj-

më shpirtrat tona, dhe mos kalo atë jetë të pasur, mos e kalo në të zi. Mos prit më të kot, se burrë s'ke më, s'gjendet më!»

Përpiquej dhe mundohej studenti qytetar ta bindte, po vajza i përgjigjej që të ikte dhe ta linte të qetë me ushqimin e rritjen e trishtimit dhe të melankolisë së saj...

Filluan gratë e liga, filluan shtrigat e katundit të shpifin mijra fjalë të turpëshme për vejushën e re. Kudo që shkonin, nuk kishin gjë tjetër në gojë përveç se vajzën ëngjëllore. Të gjitha i shkuan në vesh të kunatit të ri, i cili e shkonte jetën në male si çoban me ato pak dhën që kishin mbetur nga të Fotit. Ky, i hidhëruar për humbjen e vëllait të dashur, çmallej me fyellin ligjëronjës. Nuk i bënte zëmra të mirrte rrugën e shtëpisë. Ky i egërsuar për fjalët e poshtra që ishin përhapur, posi një luan i tërbuar zbriti në fshat dhe me mundime poqi studentin qytetar, të cilit i tha që të hiqte dorë dhe të largohej nga shtëpia e tij, se do ta paguante me kokë.

Studenti ishte gozhduar prej bukurisë së jashtëzakonëshme të Thinës, dhe jo vetëm që s'hoqi dorë, po një ditë e teproi. Kur ëngjëllushja kallogre kishte dalë e vetme për dru në pyllin e fshatit, studentin ëndëronjës e kishte marrë pas. Kjo, si një zërrë legjendare në mes të një pylli gjelbëronjës, vajtonte, dhe e pa prej së largu që i vinte drejt si i tërbuar. E frikësuar u ngarkua me ato pak dru që kishte bërë dhe mori rrugën për t'u fshehur në ndonjë vend. Malet, pyjet dhe gërxhet, që më parë argëtoheshin prej fyellit dhe këngëve trumbetore të Fotit, tashiti s'mundnin t'ja shpërblenin ndryshe mirësinë, veçse duke i dhënë shpella e pemë gruas së tij për

t'u fshehur. I riu rahu katër anët e pyllit, kërkonte fatin e tij, po qe gënjyer e munduar kot, se vajza e bukur ndodhej pranë banesës së saj vetmimtare.

Si rrufe u hap lajmi që e bukura vetmimtare qe turpëruar keq në pyll prej të riut. Kjo duke qarë u mbyll brënda dhe e sëmure s'përmëndeje.

Për herën e dytë, çobani trim, vëllai i Fotit, i hidhëruar prej turpit poshtarak që i ndodhi, lajmëroi të riun që të ruhej, ato ditë se ja ky ja ai do të rronin të gjallë...

Si e marrë Thina e bukur, qe marë prej disa fqinjve dhe qe shpurë në oborrin e shtëpisë së saj, ku ndodhej një shumicë e madhe katundarësh të heshtur.

Përpak u gjend para një trupi të mbytur në gjak!... Me habi e shkalluar e vështronte të kunatin që ra viktimë për nderin e saj. Fytyra iu ndryshua, gjuha i humbi, drita iu pre dhe, duke zënë leshrat e saj të gjata me fuqi ra si e vdekur ëngjëllushja mbi trupin e coptuar të kunatit të saj, i cili qe vrrarë me të pabesë prej fisit pasanik të studentit.

Përtej fshatit, në buzë të detit, majë një bregoreje të lartë dhe piktoreske, gjendet një monastir shumë i bukur, që nuk ndryshon nga akropojt e grekëve të vjetër: është Shën Theodhori.

Atje natyra qesh e shkëlqen, po vetëm një zëmër ëngjëllore vuan. Nën kambanën e madhe, gjendet një var i ri dhe bukur i stolisur. Për hera shihet një ëngjëllushe, e veshur më të zi, që gjunjëzohet para varrit, duke lëshuar lule të përcjellura prej lotësh të hidhura. Ajo është Thina e bukur që e kushtoi jetën e vet tek i madhi Zot. E mbyllur në atë manastir të largët shkon një jetë krejt të veçuar. Asgjë s'i bën as më të voglën përshtypje. Pret me padurim vdek-

jen. Nuk është më ajo që ishte. E tretur, e dobësuar s'do të dijë gjë nga bota. Është bërë e Zotit: — Jam shërbëtorja jote, o. At i qiellit, — thoshte dhe gjunjëzohej përpara altarit të kishës. Ndizte përhera kandilat dhe lutej për dy shpirtra. Nuk ndryshonte nga ëngjëjt e parajsit...

Me kohë, fshati kishte pushuar nga trillimet poshtanike. Të gjithë e njohën pafajsinë e Thinës. E njohën zemrën e bardhë dhe shpirtin e madh të vajzës ëngjëllore. Tashti e quanin shënjtore të vogël.

Shumë herë katundarët e vizitonin manastirin e bukur, po shenjtorja e vogël nuk i fliste njeriu. S'përmendej më. Shpirtrat e padukshëm ishin shokët e saj. Me ata fliste dhe për ta falej. Gjahtarët, vizitonjësit, i flisnin, po ajo me duart kryq, pa vështruar njeri bëhej si e shurdhër dhe s'përgjigjej askujt.

Si një qengj i butë, i vetëm në një stan, që vjen rrotull duke blegëritur e diçka duke kërkuar, kështu edhe shënjtoria e vogël blegërinte në katër anët e manastirit, dhe kur i afrohej varrit të ri, gjunjëzohej para tij, derdhte dy pika loti dhe buzët e saj lëviznin për pak kohë duke u lutur për dy shpirtra: për një të humbur larg... dhe për atë, para të cilit ajo ishte gjunjëzuar. Kështu e kalonte kohën e saj vajza e pafajshme dhe fatkeqe. Ishte tretur dhe bërë si qiri. Shkrihej përditë.

Heshtën bilbilat, natyra u egërsua. Zunë të binin gjethet e pemëve, qielli gjendej i mbushur me re... Dimër. Manastiri të hante. Vetmi. Shi. Erë. Dëti i egërsuar përposh gjëmonte. Shënjtoria, e vetme në atë manastir, qe indiferente tek natyra. Priste vdekjen me padurim. Fikej si kandili... Janari qe shumë i rreptë, si kurrë ndonjëherë.

Një mesnatë të tmeruar, kur bora kish mbuluar

gjithësinë dhe hëna ndriçonte në mes të qiellit si një disk i madh magjik, atje përtej dukej një udhëtar që i drejtohej manastirit. Dheu zbardhëllonte. Qetësi e madhe.

Udhëtari ecte si i tërbuar. Për çudi, asnjë rrugë s'dukej, se qenë të mbuluara prej dëborës, por udhëtari i dinte vendet me pëllëmbë! Dukej se do të ishte një katundar i atij vendi.

Me padurim hapi portën e madhe të manastirit që i ngjante një kështjelle të madhe mesjetare, mban vesh të dëgjojë gjë, po kot. Qetësia vdiste manastirin. Vetëm përposh dëgjohej deti që përplaste dallgët e tij të egra në shkëmbenjtë e thepisur. Për pak u gjënd në ndërtesën e vogël të kallogresë. Troket te dera dhe bërtet:

— Hape portën, o Thina ime! Hape se s'duroj... Jam unë... hape, o fryma ime!... — dhe s'mbahej nga mallëngjimi. Si në shkreti! Gjë s'përgjigjej.

— Thina ime, shpirti im, hape portën se për ty u treta dhe shetita botën»...

Shenjtorja e vogël s'përgjigjej. Nuk kishte më fuqi. Ajo që ora e fundit e jetës së saj. Përpiquej... jipte shpirt...

Udhëtari, i mallëngjyer, i coptuar dhe gjysmë i vdekur, dëgjoi brënda ca psherëtima. I tërbuar, çepëtoi derën dhe u fut brënda në dhomë që ndriçohej prej një kandili, i cili sapo fikej. Shikon më një kënd një grua të shtrirë përdhe, pa rroba, pa gjë, në atë të ftohtë që priste hekurat. I çuditur, shikon Thinen e tij që ipte shpirt, sytë i kishte drejtuar në tavan... jipte e mirrte...

— Ngreu, o drita ime, çohu se erdha nga mërgimi. Jam unë Foti yt. I mësova të gjitha... Po eja të rrojmë bashkë se vuajtjet mbaruan...

«ORA» Nëndor 1931

VDEKJA E SHOKUT

Shokut tim të klasës, SULEJMAN
KALAS, që mbaruam bashkë shkollën
dhe që vdiq nga vuajtjet pa zënë punë.

I këputur prej lodhjes, gjunjëprerë nga fuqia dhe i verbuar nga uria, shetitja i trullosur rrugët e gjata të kryeqytetit. Të hollat më ishin mbaruar, shpresat më kishin humbur. Njeri nuk njihja... Shihja me çudi atë farë popullsie që lëvizte. Mendja më fluturonte në vendin tim lindor, ku kisha trilluar planet më të bukura, ku kisha krijuar ëndrat më të ëmbla. Përfytyroja gëzimin fluturak të shkollës ku mbarova mësimet dhe ku bota më ishte dukur e ngjyer plot me ar, e margaritar.

... Dhe si një dallandyshe që nga të ftohtit ikën për dhera të nxehta dhe e uritur e gati për të ngordhur në mes të një oqeani të paanshëm mundahe-sha të gjeja shpëtim! I shikoja më kujdes dhe syrrëmbushur vargjet e hekurta të mundimit që do të më shtrydhnin dhe plot ankim murmurisja:

— E shkreta jetë! Për t'u munduar ke lindur..
Ah! o mundim, o dëshpërim, o thyerje e zemrës, o zi e shpirtit që verbon rrëmetin! E bën të mjeruar, të kotë e gënjeshtare botën!

Kokëulur, isha zhytur në thellësirat e lëngimit të shpirtit tim të shumëvojtur dhe duke mos ditur se ku gjendesha e ku shkoja, vazhdoja duke thënë:

— Kjo është njerëzia? Po ku është drejtësia? Turp! Mbretëroi në të katër anët djallëzia, bija e përtacisë.

— Gori! — një zë më thirri.

— Eh çudi, — përnjëherësh thashë me vete, — dikush më përmëndi emrin tim. — Zëri tingëllonte edhe në veshët e mi.

— Gori! — prapë më briti.

Mezi ngrita kokën, se e mbaja drejt tokës së shtrënjtë, ktheva sytë rreth e përçark dhe pashë se gjendesha në rrugën e Durrësit. Nuk dallova njeri të njohur dhe i çuditur akoma po ndija në veshët e mi, ku edhe tingëllonte ajo thirrje misterioze.

— Pse s'më flet, o Gori i dashur! — dhe m'u hodh në grykë, më shtrëngoi dhe filloi të më fliste.

— Si je, si shkon, që kur je këtu, folmë, nuk je ti shoku im! Qysh më harrove!

— Ehu! Ti je, o Sulejman i dhëmshur, ti je! Po qysh këtu, kur erdhe? — dhe e përqafova me mall të zjarrtë shokun tim të shtrenjtë, që bashkë me të u rrita në një internat, në një klasë, në një dhomë dhe në një tryezë. M'u duk sikur shpëtova, sikur gjeta atë që kërkoja. Me lot ndër sy nuk munda më t'i flisja, nuk munda t'i përgjigjesha. Dhe ai, lotoi i heshtur kur më pa në atë gjëndje: të palarë, të reckosur, të tharë e gjysmë të vdekur.

— Mos u dëshpëro, o Gori im! Lindëm me nundimin, lindëm me vuajtjen. Jeta është shumë faqezash e lajkatare. Kush e di, mund të shpëtojmë, mund ta kuptojmë edhe ne pakëz shijen dhe qëllimin e kësaj bote që tashti na duket e errët...

Që të dy, me fjalë ngushëllonjëse për njeri tjetrin, i ramë Tiranës fund e krye. I thoshja se, për neve, kurrën e kurrës s'do të kishte shpëtim. Kisha shkuar në të gjitha zyrat e shtetit, në të gjitha kisha shkuar dhe kudo me fjalë shpirtëdmuese, më ndiqnin si qen, nuk donin të më shihnin as edhe me sy... Edhe ai më thosh prapë po ato. Eh, pra, qysh do të gjenim ngushëllim? Qysh do të shihnim ndonjë yll shpëtimi, ndonjë shteg kapërcimi të asaj ngatrese hekurash munduese të zemrave tona varfanjake? Ishim shumë të varfër që nga shkolla. Dhe shokët tanë kishin zënë punë, se ishin të pasur e nuk na flisnin. Nuk e bënin kabull të na flisnin se nuk meritonim për shokë, jo, po se edhe shërbëtorë, se ishim të varfër. I shikonim që me këngë e gëzim na shkonin përpara syve e nuk na kthenin sytë fare se ishim të varfër.

— Sulejman, nuk të thoshja unë që s'bën kurrë shkolla për të varfërit. Kështu nuk është? Përveç që me mundime të panumurta mbaruam shkollën, por ja tashti, kush e di se si do të vdesim! Kush e di se si do të ngordhim! Jo, jo, s'kemi përkrahje, s'kemi shpëtim, e ta dinim kështu, nuk do ta merrnim fare rrugën për në Tiranë.

Vera e vjeshta kishin kaluar. Me këpucë të coptuara dhe rrobat e tretura edhe s'mbaruam dukë ecur mbi fillin e pmbuarur të fatit tonë të zi. Filloi të ftohtit dhe njeri s'na fliste, s'na shikon-te e s'na pyeste se sa mundoheshim prej jetës. Çudi, o njerzi. E pse rron me zëmër të ngurtë!

Akulli na thante trupin dhe dimri i fortë na thoshte që të iknim. E ku të shkonim! Kishim dalë në mërgim, kishim dalë për të punuar, për të

shpëtuar familjet tona. Por deh, ne do të ngor-dhnim rrugëve. Çdo punë kishim kërkuar, po ku-do dyert na ishin të mbyllura, se fati i keq e ndjek njerinë e varfër deri në buzë të varrit. Dridheshim nga të ftohtit dhe, janari pa mëshirë, na mbylli në dhomën e errët dhe të pashtroje që rrinim.

— Gori, Gori, vëlla! Unë jam keq! — dhe me kokë të unjur rrënkonte.

— Ç'pësove, o Sulejman, — i thashë porsa e pashë që ishte bërë dyll i verdhë dhe kolla i mirr-te shpirtin.

— Ah Tiranë, më more në qafë! — psherëtit. — More në qafë mëmën e shkretë dhe motrat fat-keqe!..

Oh fat i zi. U shtri në sheshin e ftohtë, duke patur për nënkresë gjunjët e mia dhe filloi të qante. Qaja edhe unë hallemadhi, qaja me shokun tim. Të dy, të mbyllur në një dhomë të lëshuar gratis, jashtë qytetit, larg, në mes të atij dimri lëkurërrjepës, dy djelmossa, dy të varfër, vajtonim fatin tonë.

— Jam keq, o vëlla... — dhe kolla i nxirrte shpirtin dhe i zinte frymën. — Mëmë e shkretë ku të kam? Nënë... nëno... Motra të mia ku më jini? Unë s'do t'ju shoh më, jo, dhe as ju, o të gjo-ra, mua.

Mallëgjimi më pushtoi kur dëgjova ato fjalë plot trishtim të cilat i përsëriste edhe shpirti im i djegur.

Dielli ishte fshehur prapa bregoreve dhe muz-gu filloi të lëshonte krahët e tij të kadifenjta. Atë ditë ne s'duallëm jashtë. Ishim pa ngrënë fare. Të dërmuar prej mundimit, të shtrirë përdhe pa asnjë rrobe, prisnim të na zinte gjumi.

— Natë! Kurrë mos mbarofshë... dhe ti o agim, mos rafsh më në tokë!

E dëgjoja Sulejmanin që fliste me vete, që nuk gjente qetësi. I zura dorën. Oh sa digjej në atë ftohtësirë zëmrake, në atë ftohtësirë që ngrinte e përmblihte hekurat! Në mes të dhomës së errët, të shkatruar e pa derë e dritare, hynin dhe përshkonin rrezet e hënës së plotë të janarit. E pashë shokun që, me sytë nga tavani, jepte e merrte, dhe me lot mundohej të më fliste, po... nuk mundej. Si i shkalluar e mora e përqafova Sulejmanin dhe e mbajta fort në gjirin tim të pafuqishëm...

— ...Vëlla... po vdes!... ehu, o mëmë... derëzeza ti, kur të mësosh se...

— Sulejman, të gjitha do të shkojnë. Mos u dëshpro, mos e cingris, mos e lëndo plagën tonë. Për të vdekur, jo, s'kemi për të vdekur, para se të tretemi prej mundimit. Po flij, o vëlla, flij!

E pashë që hiqte me mundim, e pashë që ishte në mbarim, dhe kur më tha «tashti do... të fle përjetë», m'u ngjath mishi dhe humba tragen. Dhe kur më shtrëngoi dorën e m'i ktheu një herë ato sy që shkëlqyen në hënën e dimrit, venita kokën dhe e lëshova burimin e lotëve. Po kur më tha «Lamtumirë... përjetë» ay shok, shok i dashur, shok i jetës, m'u drodh shpirti. Nata ishte e qetë, veç se era fishkëllente pa ndalim. Një zhurmë, një përpjekje dëgjova pranë. Hëna kishte humbur dhe errësira më verbonte. Dhe me kokë të ulur, me shpirt të dërmuar, me ndjesit e humbura, qava vetëm! Lotoja me trishtim shokun tim, vëllanë tim, Sulejmanin e shtrënjtë. që ish bërë më i ftohtë se akulli...

«ORA» gusht 1932

SHPRESA

Shokut tim BARI BALA, që mbaroi shkollën bashkë me mua dhe që vdiq nga vuajtjet pa zënë akoma punë

— Le të shpresojmë!

— Mirë, o vëlla, po gjer kur do të shpresojmë? Gjersa të vdesim? Nuk e sheh si mbetëm?.. Shikoji këmbët e mia si janë katandisur. Oh, kushedi se sa ditë kemi që jemi nisur... dhe Perëndia e di nëse do të arrijmë gjallë!..

Ecnin dhe akoma po ecnin. Kryeqytetin e uruar e kishin lënë pas. Ditë të tëra pa bukë, muaj nëpër rrugë. Dimri u thante trupat e tyre të veshura me ato petka verore, që u ishin bërë zhele. Dhe me të vërtetë, po t'i vinte re njeriu, do ta kuptonte lehtë se ata të dy ishin studentë. Por jo... se atë vit e kishin lënë atë emër të bukur, e kishin mbaruar shkollën dhe me armë të ndryshkura luftonin jetën. Koli i mbante mend fjalët e urta të një profesori që thoshte gjithnjë se shkolla të armatos kundër jetës shtrigë, po, më në fund, e pa se armët e shkollës ishin të ndryshkura dhe s'kishin vlerë. Çoç deshën që të përdoreshin... Më në fund e kuptoi se shkolla e mjeri, se ajo me mjeshhtëri i kish treguar me anën e letrave të

shkreta lumturinë e vërtetë... po, ah, e mori në qafë: të gjithë ato që kish dëgjuar brënda katër mureve të klasës nga profesori orator, i cili fushën e bënte mal dhe malin fushë, të gjitha i dualllen të kundërta...

— Nuk e pe, o Bahri, asnjë s'na i ktheu sytë, asnjë s'na tha një fjalë të mirë. Deh, more dreq, si u katandis kjo botë! Për Zotin e vërtetë, më vjen të ha veten me dhëmbë! E pastaj thonë se sot jemi në kulmin e qytetërimit! O, ky qenka qytetërimi? Po ne në shkollë nuk mësuam se qytetërim do të thotë djallëzi! Nuk e pe se sa të mënçëm poqëm! Save u trokitëm në derë... dhe të gjithë na përcuallën me gënjeshtër... dhe disa patën nderin të na ndynin dhe me sharje! Po pse, nuk kanë parë kurrë shkollë ata? Atëhere profesori ynë qënkish budalla, na shiste kot mend! Na tregonte rrugën e vërtetë — siç thosh ai — rrugën e njerëzimit. Po koka që i plasi, pse na mori në qafë duke na përkundur me ëndra? Pse s'na foli ndonjëherë, sidomos në klasën e fundit, pse s'na e zuri në gojë gjëndjen e soçme! Pse s'na tha të rrinim si prindërit tanë! Ajo jetë ishte e qetë. Ata, vërtet, nuk e turbulluan fare mendjen me libra, po u rritën si njerëz të botës: të lirë, të ndershëm e të shëndoshë. Pa shiko se si u katandisëm ne? U trazuam me qytetërimin e mësonjësit tonë që na mori në qafë. Të shikojmë e të mendojmë mirë se në ç'gjëndje jemi e pastaj ta takojmë ndonjë ditë atë profet të gënjeshtërve, atë mësonjës që na çeli këtë rrugë dhe pastaj na la në mes të një fushe të madhe, ku vetëm qielli shihet. E nga t'ja mbajmë? Kështu do ta shikojmë këtë jetë, me vuajtje?... Apo do të gjejmë ndonjë rrugë shpëtimi?

— Le të shpresojmë!...

— Oh edhe ti! Gjer kur do të shpresojmë? Më duket se mbemë rrugëve... Do të shtrihemi, do të vdesim... Pastaj na rroftë shpresa!

Retë si kope të tërbuara, të vëna përpara nga ujku, — era zmërake e dimrit bridhnin në të katër anët e qiellit të mvrejtur. Natyra e xhveshur, ish mbuluar me borë. Dy të rinj udhëtarë gjunjëprerë, kalonin fusha dhe male. Ecnin dhe akoma po ecnin dhe rruga s'kish të sosur. Dielli e kish mbaruar udhëtimin e tij të ngahershëm dhe errësira me nxitim nisi të mbulojë dheun e shkretuar.

— Bari! Mirë që ditët e kaluara i kapërcyem, po sonte çdo të bëhemi? Ku do të gdhiehemi?

— Le të shpresojmë! — dhe ecnin.

— Po gjer kur do të shpresojmë? Nuk e sheh se nuk shohim më? Ç'do të bëhemi?

— Le të shpresojmë!...

Ishin futur brënda një pylli të dëndur. U lodhën dhe u kapitën. Nuk mund të bënin më asnjë çap. Shikuan andej-këndej gjersa gjetën një guvë në trungun e një lisi plak, ku u futën për t'u çlodhur e për të fjetur.

— Bahri, këtu do të gdhiehemi? Vallë a do na zërë mëngjezi, vallë a do shpëtojmë? Vallë a do të kthehemi ndonjëherë pranë vatrës, pranë nënës së shkretë, që nuk e di se ku gjendemi? A thua, o Bari i dashur, do të futemi përsëri në udhën e njerëzisë, apo do të lëmë kockat këtu?

— Le të shpresojmë!...

— E de, folmë! Ç'më plase me këto dy jalë! E ç'shpresë ke akoma, o lumëmadh! Hapi sytë e

shiko ku gjëndemi, mblidhe rup dhe mendo pakëz...

Era rrihte pa mëshirë degët e pafajshme të pemëve të xhveshura. Ja që edhe ato vuanin, po kishin një shpresë. Vajtojnë tashti, po do të qeshin përsëri, në pranverë do të lulëzojnë të lumtura... Ah, njerëzit e shkretë, njerëzit e dënuar nga fati, si këta të dy, kurdoherë vajtojnë... Parëverën e kalojnë në dimër të pamëshirshëm! Mëkatë! Po s'ke se ç'bën kur gjëndesh në kohën e monopolizimevet. Kështu e pësoi edhe lumturia e shkretë! Hodhi spirancën te pak njerëz, të cilët nuk e lëshojnë me asnjë mënyrë...

— Vallë a do të shpëtojme kësaj nate të tmerrshme, o Bahriu im? — dhe ia pësttet në prehërin e tij.

—Le të shpresojmë!

— O ç'më çave kokën! Folmë! Pse rri kështu i heshtur? Thuamë gjëkafshë! Çile gojën të ngushëllohem. Ç'më dërdëlis «le të shpresojmë!» Akoma të rrojmë me shpresa?... por gjer tashti m'i shurdhove veshët me «shpresën...» Këtu ne po vdesim dhe ti akoma shpreson. Çudi! Nuk e di se ç'pësove gjatë këtij udhëtimi!...

— Kol, ti pandeh se u çmënda? Jo... po, ja që s'jam në vete. S'më bën zemra të çel gojën se mjaft m'u ngjir zëri në kryeqytet duke mburrur njerin, duke lavdëruar tjetrin; njerin duke e lutur, e tjetrin duke e mërëzitur... për të na dhënë dorën... dhe jo duart! E pashë se asnjëri s'na e vari torbën. E po tani ç'të bëj? Të pëlças nga inati? Të vras veten? E de, thuamë, ç'të bëj?... Kot të flasësh e kot të bërtasësh. Po s'pate gjë në dorë, s'fitohet asgjë me fjalë. Jam i këtij parimi. Po... shpresën s'e

humbas kurrë. Ajo më mban gjallë. Dhe a dëshiron të ta tregoj historinë e shpresës?

— Mirë do të bësh... që të na shkojë dhe ora... Ashtu të dua, të më flasësh, se plasa...

— Që thua ti, o Kol i dashur, njerëzia ishte e lumtur, tepër e lumtur... vetëm zjarri i mungonte.

Foli pak. pastaj mblodhi veten.

— Vazhdoje këtë tregim, o vëlla, se mos na zërë edhe gjumi... Po të mundesh zbukuroje... megjithëse ti flet pak dhe s'di të trillosh gënjeshtër. Shkon pas këshillave të profesorit...

— Të thashë se në botë nuk kishte zjarr. Vetëm ai mungonte. Po këtë e vodhi në qiell Prometheu i famshëm dhe ja dha njeriut, po pa dëshirën e Zotit... Oh, sa u nxeh i Pushtetëshmi nga kjo vepër e Prometheut... U nxeh aq shumë, sa Prometheun, dashamirësin e njerëzisë, e dënoi rëndë duke e lidhur me zinxhira të rënda e të forta majë një shkëmbi të maleve të Kaukasit... ku përdita shkonte një shqype dhe i dërmonte mëlçitë. Ai mundohej, po ishte i lumtur se e dinte që i kishte sjellë dobi të madhe njerëzimit.

— Vërtet ashtu... Bën të mirë, të gjesh të keq!

— Pa dëgjo, pra, se ç'ngjau më pastaj... Zoti vendosi t'i jepte një tjetër drejtim njerëzisë nga inati që pat kundër Prometheut. Dërgoi Pandorën tek Epimetheu, vëllai i Prometheut të dënuar. Kjo mbante në dorë një kuti me dhurata. Mirëpo Epimetheu ishte porositur nga i vëllai i lidhur që të mos pranonte asnjë kanisq hyjnor... Po... një mëngjezi të bukur, kur tërë bota lulëzonte nga veshja pranverore, dhe jo si tashti, u duk Pandora që

mbante në duar një kuti të ndriçuar nga gurët e çmuar, e cila shkonte drejt e tek i vëllai i Prometheut. Trupin e kishte hyjnor. Bukuria e saj e paparë e verboi djaloshin e gjorë, i cili, i habitur shikonte leshrat e arta që i derdheshin mbi supe dhe sytë e saj rrezorë që verbonin çdo sy njeriu.

— Mirëmëngjes! — i tha Pandora. Ky i shastisur, ndjeu një drithëtirë kur dëgjoi zërin e saj.

— Mere këtë kuti, o njeri. Brënda në të do të gjesh dhuratat që meriton.

Ky, papritur, zgjati duart dhe e mori atë kuti që llamburiste prej bukurisë.

Ah i ziu njeri sa gënjehet nga bukuria! Sa lakmitar që është! Nejse... ky, me një dehje të patreguar, me një tërheqje magjike, çeli kutinë... po menjëherë duallën dhe fluturuan jashtë saj gjithë ligësitë dhe djallëzitë e dheut... Të gjitha fluturuan, ndërsa ky shpejtoi ta mbyllte kutinë... po tepër vonë, se të këqiat kishin marrë dhe në. Vetëm një dhuratë mbeti e kyçur brënda: Shpresa! Ajo s'arriti të fluturonte, se kutinë e mbylli me të shpejtë ai që harroi porosinë e të vëllait, ai që u qorrua nga bukuria hyjnore e Pandorës... Kështu, pra, o shok, në këtë botë vetëm shpresa ka mbetur brënda, shpresa që na mban e na shtyn të kapërcejmë çdo pengim, që na jep lumrim të rrojmë, sidoqoftë...

Koli dëgjonte i heshtur, pastaj sikur të zgjohet nga gjumi, tha:

— Ti mirë e tregove! Mirë ta ka mbushur mëndjen profesori i shkretë, po, nëse e takojmë ndonjëherë e t'i themi se kutia mund të jetë shpuar nga qytetërimi dhe shpresa na e ka marrë të keqen, ka dalë edhe ajo jashtë e na është bërë një

me dhuratat e tjera të cilat kanë marrë dhenë dhe përditë shtohen!... Ah o jetë! Ah, o Perëndi, nëqoftëse je siç thonë, bën që të shpëtojme dhe këtë natë të tmerëshme!...

— Le të shpresojmë!...

Pylli fishkëllente dhe dëbora binte me ngadalë.. Të dy shokët të përqaftuar, aty në zgavrën e trungut, prisnin t'i zinte gjumi. Bahriu që shpresonte, gërhiste, ndërsa Koli ish zgjuar, po me sytë e mbyllura. Dëgjonte një turfullimë që po afrohej. Nuk lëviste dhe as shokun s'guxonte ta zgjonte. Iu kujtuan fjalët e Bahriut dhe murmuriti: «Le të shpresojmë!... Zhurma u afrua. Gjaku iu pre fare! Sytë nuk i hapte. Nata ishte pus. Nga tmeri, mijra mendime të çuditëshme i turbullojnë kokën. Dësh ta zgjonte shokun... po ndjeu një furri që ja rrëmbeu shokun... Si i shkalluar, çëi sytë nga ajo potere ferri... Shikon rreth e rrotull mijëra syshkëndi që xixëllonin në atë errësirë të vdekjes. E humbi dhe si vetëtimë iu ngjiti lisit...»

— O Kol o Kol i dashur, shpëtomë... më coptuan ujqit.. Koli... shpëtomë!

— Vëlla Bahri!... le të shpresojmë!

— Shpët... Kool! — dhe ujqit e tërbuar e të pamëshirëshëm coptonin trupin e pafajshëm, atë trup të cfilitur e të munduar të Bahriut fatkeq, i cili gjer atë çast ëndëronte me shpresë se do të gdhijej i gjallë. Ndërsa Koli, që ishte çmëndur, bërtiste me lot ndër sy:

— Le të shpresojmë!...

«DEMOKRATIA» (Gjirokastër) 1933

DERËSHUARI

E kisha njohur qëkur Vasilin, prandaj, kur m'u dha rasti, u ktheva në shtëpi të tij. Katundi ku banonte është një nga më bukurit e V... dhe më pëlqen tepër.

Në mbrëmje duallëm bashkë me të jashtë për të shetitur. Dielli i korrikut kishte humbur fuqinë e tij dhe i skuqur, në vend që të verdhej vdishte me qetësi dhe humbiste në ujrat e thella të Jonit. Po majave të maleve të larta si edhe pemëve të shumta e të gjata, që çoheshin pak më poshtë në fushën e gjërë, nuk mbeti pa mos u falur dhuratën më të çmueshme: dritën e artë që i bënte hyjnore, për lamtumirën e fundit.

! Ishim larguar nga katundi. Bisedonim, thoshnim historira të tëra, kujtime të paharruara, kurse befas unë mbeta në vend, se sytë e mi ndeshën përpara një vend të trishtuar, plot me qiparisa të gjatë, që lëshonin një hije të zezë e plot mjërim, rrethuar me një mur të gjatë dhe, më një kënd, gjendej një portë e madhe, shumë e madhe. Dëshja të dija ç'vend ishte ai që lëshonte ato hije të vdekjes dhe që aq shpejt mua më shastisi. U bëra gati të pyesja shokun, po e kuptova prej hekurave

të derës, nga munda të dalloj kryqe të bardhë të shumtë.

Vazhdova hapat e mia të ngadalëshme, po eh, prapë ndala të ecurit, se dera u hap dhe dolli jashtë prej vorrezave një burrë i madh, i trashë e i gjatë, i veshur krejt më të zeza, fund e krye, me leshrat e gjata e të pakrehura, me mjekrën sterrë të zezë, mbylli prapë portën, ndenji pa lëvizur, unji kokën dhe, duke tundur me fuqi krahët, briti:

— Qysh, o Teli im, të lash vetëm! — dhe i ra kokës me grushte...

— Fantazmë! — thashë me vete, — Vdekja! Mbreti i skëterrës, Karonti, djali i zisë, tmeri të gjallëve, trim i hijeve... ç'është ky, o Zot!

— Eja, ec, o Llukë, pse u ndale, — më tha shoku që ishte larguar shumë prej meje, ndërsa unë, i llahtarisur, po e shikoja edhe burrin e tmer-shëm. Pandeja se Vasili nuk e kishte parë, por ai sytë i mbante drejt portës së madhe.

— Ah! i shkreti, ka hak të bëjë kështu! — E shikova një herë shokun dhe, duke vazhduar udhëtimin që të dy i thashë:

— Njeri ishte apo hije, a e pe apo jo? Dhe pse thua që ka hak të bëjë ashtu? Ç'është, o Vasil? Njeri është ai? Çudi!

— Nuk e di, o Llukë, se ç'ka pësuar ky derëshuar? Kujtoja se e kishe marrë vesh ngjarjen fatkeqe e shkatërrimtare të Kiços. Ah, se ç'ka pësuar derëshuari Kiço! Dëgjo se po ta tregoj pak a shumë si të mundem...

* * *

Kaluan tani pesëmbëdhjetë vjet që djali i tij iku për në Amerikë. E kishte të vetëm, e deshte

shumë, më tepër se dritën e syve. Harrova të të them, o i dashur, se këtë e martoi me më të bukurën e fshatit: me Urani ëngjëllushen. I hapi dhe një dyqan në fshat, se derëshuari Kiço ishte tepër i pasur. Mirëpo djali i tij i vetëm, Teli i shtrënjtë, deshi të ikte për në mërgim. U mundua ta ndalte, po më kot, se ky nxori kartat dhe iku për në Amerikë. Qante nusja, po kishte një farë ngushëllimi, se, për fat, ishte shtatëzënë kur i iku burri. Eh, e di ti, o i dashur, se këtu kemi një drejtozakon, martohemi dhe ikim për në mërgim. Gruan e lëmë të shterret zëmërthyer...

Që thua ti, në Amerikë ky nuk rrinte si gjithë bota të punonte në një vend, po një muaj në Uashington, dy muaj në New York, një javë në Filadelfi, në Shën Frangjiskun, në Detroit, në Los Angelos, në New Orleans... e po thua në gjithë qytetet e mëdhej të Shteteve të Bashkuara bredhërinte si i pamend. Shtëpisë nuk i shkruante kurrë. Me atdhetarët mërgimtarë kurrë nuk takohej. Kishte hak, se qysh në vogëli ishte rritur me pekule, i vetëm, bënte ç'të donte njeri s'e ndalonte.

Qante derëshuari Kiço, vajtonte ëngjëllushja Urani, po Antigoni, vajza e saj, nuk qante dhe as që ndjente pikën e mallit për tatën, se, si të thashë, kur iku ai për në mërgim, e la në barkun e s'emës.

Ra mbas argëtimeve, ra mbas qejfeve të pakufishme. Kishte harruar shtëpi, babë, grua... Atje gratë i ndronte përditë, se bukuria e madhe dhe trupi i tij levend mirrte në qafë zonjat e zonjushat amerikane. E vërteta është se ato e ndaluan pesëmbëdhjetë vjet në mërgim...

Kaloi gjithë ajo kohë e gjatë e njeri s'dinte

më në ishte i vdekur apo i gjallë. Po një ditë dimri, kur derëshuari ati i tij rrinte i menduar pranë vatrës e me sytë mbushur me lot kujtonte Telin e tij të dashur, menjëherë hyri brënda postjeri dhe i dorëzoi një telegram. Ky fshiu lotët dhe me padurim lexoi:

I dashturi At,
Pritmëni për së shpejti...

Oh, se ç'gëzim! Krejt farefisi u mblodh dhe kushdo, sidomos gratë, mirrnin telegrafin e puthnin dhe një çelje gazmore filloi të rritej pamasë në atë shtëpi, e cila, megjithëqë ishte pasanike, qe kredhur në zi e në helm për levendin, për mburrjen dhe krenarinë e saj, për Telin e vetëm e të paçmuar.

Dhe katundarët mbushnin shtëpinë duke i uruar Kiços për lajmin gazmor që kish marrë. Nuk kishte lumturi më të madhe për Uraninë ëngjëllushë, për Antigonin e bërë grua, e cila çuditej që do t'i vinte tata nga Amerika i mbushur me të holla dhe që do t'i binte baulle plot me rroba e gjëra të çmuashme. Filluan të lanin shtëpinë, ta pastrojnë e ta zbardhonin.

Dhe ja, një muaj pas lajmit gazmor, u duk përtej fshatit një automobil, brënda të cilit ishte Teli. Krejt katundarët u mblodhën për rreth tij... po i shkreti Teli nuk fliste dot. Ishte tharë petë dhe fytyra e tij pasqyronte sëmundjen më të keqe. As fliste, as lëvizte dot. Vetëm kur pa prindit, fëminë dhe farefisin, u ngashërye dhe lotët s'i mbaheshin.

Për tre vjet rresht Teli, i shtrirë në një dhomë të vetme të ndarë prej doktorëve, mendonte

dhe përfytyronte gjithë ato argëtime të Amerikës, të cilat tani i ishin kthyer në helm e në mundime më të trishtuarshme. Me mëmën e varfër pranë, me babën e me gruan afër, përditë shkrihej e dobësohej....

E ndali pak tregimin e tij dhe më shikoi një herë në se e dëgjoja. Unë mbaja vesh dhe prisja me padurim përfundimin.

— Pastaj, Vasil, ç'ngjajti?

— Që thua ti, gjithë pasurinë e shiti derëshuari Kiço për shërimin e Teli të tij, Mbeti keq, mbeti rrugëve, po djali keqësohej.

Dhe një ditë pranvere, kur gjithë punëtorët shkonin në punën e tyre, një kuje u bë, një ulurimë u lëshua dhe u pa populli katundar i heshtur. Që po e shpinte Teli për në banimin e përjetshëm. U shua dera e Kiços, mbeti kallogre Urania dhe rrugëve Antigoni.

Nuk kishte më ngushëllim derëshuari Kiço. Kujtonte se Teli i tij gjendej në Amerikë. Po pardje kur prindët e Uranisë shkuan dhe e nxuarrë përjetë nga dera e shuar, Kiçua i gjorë sa i pa, ra i papërmendur. Qe një vdekje e dytë, një kuje më e madhe kur Urania, me leshrat e prera, me faqet copë të çjerra e me atë shumicë të madhe njerzish që po lotonin, kthehej tek dera e babës së saj. Iku përgjithmonë!

Dhe derëshuari Kiço kthehet duke vajtur në dhomën ku ishte shtrirë Teli. Shkon në shtrat e nuk e sheh. Bërtet për Uraninë, thërret, po njeri s'ka. Çirret së vajtuar, flet me veten e tij, u shastis, bie i harruar dhe i papërmendur... A e more vesh pak a shumë ngjarjen e atij njeriu fatkeq!

Unë isha mallëngjyer tepër dhe thoshja me mendjen time:

— Ah, ky mërgim i shkretë, shuan dyer e dërmon zemra. Nuk bën jo, — thoshja, — nuk bën një mërgim i tillë!

— Po dëgjo se harrova të të thoshja dhe këtë. Kur Teli po jipte shpirt, i tha t'et «Nëqoftëse Urania mbas vdekjes sime ikën prej teje, o tatë, atëhere, të lutem, mbi varrin tim të shkelësh dy herë!» Prandaj duket se derëshuari ka ardhur të plotësojë dëshirën e të vdekurit.

Ishim kthyer e afruar derës së vorrezave, dhe unë me habi pashë derëshuarin Kiço me atë pamje frikonjëse që ishte shtrirë. Vrapuam që të dy dhe u munduam ta ngremë.

Ishte rënduar. S'përmëndej. Fytyra i ishte zverdhur. zemra, brënda së cilës ishte futur një thikë e gjatë, nuk punonte më.

Mezi i dëgjua fjalët e fundit që lëshoi:

— Më... kallni... përbri... Telit tim...

«ORA» gusht 1932

KËRKONTE VDEKJEN...

Kërkonte të vdiste se tetë muaj kish pa punë, Tetë muaj të tërë me vuajtje dhe brënga të pathëna. Kishte një javë që mungonte nga shtëpia. Kish dalë për të gjetur ndonjë mënyrë shpëtimi.

Bredhërinte i këputur nëpër rrugët e qytetit të heshtur. Këmbët i merreshin dhe kokën e mbante të ulur drejt tokës, mbi të cilën ecte pa ditur drejtimin. Rrallë herë kalonte ndonjë auto duke i rënë borisë që të bënte mënjanë nga mesi i rrugës, por Sokrat Fatkeqi nuk dëgjonte gjë. Dukej se mëndja i vinte vërdallë prej problemeve të jetës; dukej se kamxhiku i varfërisë e kishte vënë përpara, prandaj kërkonte vdekjen!

Dhe me të vërtetë kishte të drejtë, se, që atëhere që u mbiemërua «Fatkeq», ishte kredhur në mundimet më të tmerëshme të jetës. Nuni e kish pagëzuar Sokrat Bardhi, po prej popullit zuri ta thërriste «Fatkeqi», nga që ai hiqte shaminë e valles së varfërisë, megjithëqë me djersën e ballit mundohej të shpëtonte... por ishte e kotë, se fati i zi e ndiqte pas. Prandaj kërkonte vdekjen!

Dhe ja sepse kish vendosur të vdiste!

Nuk i vinte keq se vuante, por nuk ish me-suar të mundohej. Nuk lindi i varfër, po u mund

prej jetës. Kish qenë nga dera e parë e atij qyteti. I jati mbante gjithë lëvizjen e tregëtis. Shtëpia ishte bërë hotel. Me mijra njerëz, të mirë e të liq. hynin e dilnin. Ishte dera më fisnike, më bujare e qarkut. Pra, ky ish rritur me pëkule dhe nuk ja kishte ndier emrin varfërisë. Po ç't'i bësh rrotës së fatit që kthehet simbas thënjes dhe dëshirës së saj. Ç't'i bësh jetës që na lot në gishtërinjt e saj lajkatarë...

Krisi lufta botrore. Filloi të hajë njeriu njerinë! Ushtëri të huaja pushtuan qytetin dhe filluan të plaçkitnin, të vidhnin e të prisnin. Nuk lanë gjë të gjallë. Prandaj kush më parë të ikte e të shpëtonte... Kur mori fund lufta, gjaqet u ftohën. Ata që kishin shpëtuar u kthyen prapë në shtëpit e tyre. Po ç'të gjenin: banesat të djegura, dyqanet të plaçkitura. Një shkatërrim, një rrëmuje që dridhej dhe foshnja në barkun e s'ëmës. Me një fjalë, nuk njihete qëni të zotin.

Edhe Sokrat Fatkeqi me gjashtë vëllezërit e vegjël dhe me mëmën e tij nuk gjetën as dyqan as shtëpi. Nuk gjetën as babën e tyre. Dukej se e kishin vrrarë! E ç'të bënte, pra? Kujt t'i drejtohej! Mbeti rrugëve, pa shtëpi, pa përkrahje.

Njerëzia ra në heshtje, në paqe. Filloi rindërtimi, ringjallja e lëvizjes njerëzore. Shumë të pasur kishin mbetur rrugëve, dhe shumë të varfër ishin bërë kapitalistë. Ç't'i bësh fatit. Kështu e ka kjo botë. Kështu e kanë përfundimet e luftrave!

I mjeri Fatkeq, bëri ç'ish e mundur për ta rregulluar jetën, po më kot, se asnjë nuk i kthente sytë. Të gjithë i dukeshin armiq. Nuk mbahej, prandaj kërkonte vdekjen. Por, para se të ikte për mbretërinë e qetësisë deshij të ndihmonte me ndo-

një mënyrë vëllezërit e vegjël. Kërkonte ndonjë punë sa t'u tregonte ndonjë udhë shpëtimi e pastaj të plotësonte vendimin që kishte dhënë: vetvrasjen...

* * *

Kësula e tij pis e zezë nuk i mbulonte dot leshërat e gjata e të pakrehura, që i vareshin fytyrës së tij të shumëvuajtur. Me duart pas, me ecje të ngadalëshme, vështronte gjishtrinjtë e këmbëve të coptuara dhe, duke pëshpëritur disa fjalë të pazëta, u unj te dera e madhe e një dyqani të mbyllur.

Agimi argjëndar mbuloi dheun me cipën e tij bojë hiri, ndërsa vallja e këndezave lajmëronte gjithësinë të fillonte punën e saj të pa prerë për të mundur të pushtohej mbretëria e pa mundur e jetës lajkatare. Dielli edhe s'kish lëshuar asnjë rreze, kurse rrugët e qytetit të heshtur zunë të përshkoheshin prej ushtarëvet të punës, që me djersën e tyre luftonin të dilnin nga kori i varfëris... Dëgjohej zëri i dyerve të dyqaneve që hapeshin, zhurma e automobilave që kalonin, bisedat e paprera të njerëzve. Dhe për pak filloi të dëgjohej monotonia e rrahjeve të hekurave, të teneqeve e të çekiçeve. Nisi lufta e ditës kundra mundimit, kundra valles së varfërisë. Njerëzia në lëvizje. Venin e vinin. Kush duke qeshur, kush duke qarë, kush me ngadalë, kush me nxitim, kush me të drejtë, kush me gënjeshtër.

Vetëm në një derë të një dyqani të mbyllur ishte ulur Fatkeqi. Kish zënë të dy faqet me të dy duart dhe po mendohej, kur përnjëherësh u

afrua një burrë i shkurtër, me bark të madh, me syza rreth ari dhe që mbante një bastun të trashë në dorë. Porsa e pa Fatkeqi, e njohu që ish miku i babait, u ngre më këmbë dhe e nderoi. Zotnia që hapi derën me një çelës të madh, as që i dha ndonjë vështrim. U fut brënda dhe ky pas tij me zemër të thyer filloi:

— Mirëmëngjes, zotni!

Fatkeqi me duar të lidhura rrokulliste në majë të gjishtrijve kësulën e zezë dhe sytë e tij të errëta i mbante drejt tregëtarit të heshtur.

— Mos më merr në qafë, zotni! Ti e di çështjen time. Njiheshe me të ndyerin babë. Ndihamo-më, pra. Të thashë dje: kam mbetur rrugëve. Një javë që nuk i kam parë njerëzit e mi. Nuk shkoj, se më kërkojnë bukë... Nuk duroj dot, se më lypin bukë, bukë, Zotni. Vdesin për bukë. Unë bëj ç'do punë. S'të kërkoj lëmoshë. Më ndihmo, më jep një punë sa të nxjerr vetëm ushqimin e familjes. Kam gjashtë vëllezër të vegjël që nga këto dy duart e mia presin shpëtim. Mos i merr në qafë. Shpëtoji. Ki mëshirë në je njeri. S'dua gjë, zotni: një punë sa për bukë, për bukë.

Tregëtari shfletonte libra e dëfterë. Bënte sikur s'dëgjonte. I hidhte nga një sy mallit të tij dhe, duke thithur duhan, fërkonte duart.

— Jam shërbëtor i yt, të dhuroj gjithë fuqinë time. Më fal një punë. Beso perëndi, në ke, o zotni... Ah, i mjeri unë. Ja, edhe tashti që ndodhem këtu, zëri i përmallshëm i vëllezërve të mi të pafajshëm bërtet, thërret për bukë... Ah, me atë zë të humbur kërkojnë shpëtim. Ja, zëri i tyre kërkon ndihmë se i mbyti uria. Mëshirohu, zotni. Kujto mirësitë që të ka bërë babai im. Mejto gjën-

djen tonë. Unë s'kërkoj gjë... Pse kështu? Pse s'më ndihmon njeri! Pse të gjithë m'u bëtë... ar-miq.

Thoshte këto fjalë dhe zëri i tij humbiste. Nuk mundi të vazhdonte. Unji kokën. Heshti.

Tregëtari u ngre në këmbë se disa zonja me fëmijë e tyre buzëqeshëse u futën brënda. Filluan të zgjedhnin lodra të bukura dhe zbavitëse, ndërsa Fatkeqi nuk lëvizte. Rrinte i nguruar dhe nuk do të shkulej kurrë andej, po të mos e kishte rrëmbyer prej krahu tregëtari dhe duke e vërvitur përjashta derës me fuqi, i foli:

— Shporu këtej se më fëlliqe dyqanin!

* * *

Gjithë ditën ecte. Rugët kishin mbetur të shkreta. Era freskatore e mbrëmjes hirëplotë lëmonte leshrat e pakrehura të njeriut pa fat, i cili, me kësulën në dorë, edhe ecënte. Me shpirt të arratisur, me ndjesi të humbura, me shpresa të prera, nuk dinte në rronte mbi dhe. Kish vendosur t'i jepte fund jetës... po, po... nuk e dinte se kur. Mbase s'guxonte, por kërkonte vdekjen. Her' i binte kokës, herë këmbës, herë qeshte, herë qante. Rronte në një jetë tjetër dhe do të bënte mirë të ikte sa më parë nga kjo botë, meqenëse nuk ishte i vlefshëm as dhe për veten e tij. Kjo u duk. U duk që kur kthehej nga e shpinte fati; hidhte me shami të vdekjes vallen e varfërisë. Prandaj kërkonte vdekjen.

Kur mendohej, gjunjët i dridheshin sa mezi qëndronte më këmbë. Gjuha i humbiste dhe sytë i mbyteshin në lotë. Po prapë ecte pa ditur për ku, ndalej pa ditur për se. Kërkonte vdekjen.

Nuk i bënte zëmra të shkonte në shtëpi. E ç'do të bënte? A do kish vallë durim të dëgjonte klithmat e fëmijve të pafajshëm? A do të mundte t'i gënjente përsëri duke i mbajtur me shpresa të kota? E kë do të pushonte më parë me lotët e tij të hidhura? E kishte vendosur që nuk do të kthehej tek ata, sa të gjente një farë shërbimi. Dhe i kish thënë s'emës kur iku: «Ja do të gjej punë për të shpëtuar vëllezërit e mi, ja do të vritem për të shpëtuar veten time.» Këto fjalë vetëm mbante mend. Këto fjalë i tingëllonin në veshët e tij. Kërkonte vdekjen!

Muzgu, që kishte lëshuar cipën e kadifenjtë, ja kish lënë vëndin natës, e cila sundonte pa frikë gjithësinë! Qetësi. Askush nuk ndihej, dergjej jeta gënjeshtare. E kish pushtuar gjumi ëndëronjës dhe pëlhura e zezë e natës. S'fërfëllinte gjë, veç atje poshtë, në anë të qytetit, në një rrugë të shkretë, ndiheshin të rrahurat e këmbëve të arratisura të Fatkeqit që ëdhe ecte.

Kërkonte të vdiste. E kish vendosur, por meditë të pacaktuar. E shtynte shpëtimin... Duket se po mësohej të vuante, po e kish vendosur të vdiste. Ishte në kulm. Nuk dinte ku shkonte. Ecte. Pa dashur, u gjet në derën e shtëpisë së tij! Ndalet. Mban vesh. Nuk digjon gjë. Mendohet për shumë kohë. Flet me vete: «Vëllezërit e mi nuk i shpëtova, do të shpëtoj veten time. Kjo është nata e fundit. S'duroj më.»

Zëmëra s'i mbahet. Kërkon vdekjen. Hap derën mengadalë që të mos zgjojë të vëllezërit, se do t'i kërkojnë bukë. Futet brënda, në dhomën tjetër. Errësirë, pasqyrë e së ardhmes, fat-thëna e së nesërmes. Ndes shkrepën dhe kandilin. Rri në

këmbë. Nuk lëviz. Brënda mbretëron vdekja. Qesia e frikson. Sytë i mban drejt derës për shumë kohë. Pret t'i vijë njeri, t'i vijë mortja. Kokën e shtrëngonte me të dy duart. Nuk tundet. Egërsohet. Bën të bërtas, por mbledh veten. Nduk gishtërinjt e dorës dhe pa dashur thërret:

— Dua shpëtim!

Iu afrua në majë të këmbëve një arke, mori një send të mbështjellur dhe e vuri në tryezë. Dhe ai nga nervozitet i madh, bie në qetsi shpirtërore.

Me lot ndër sy kujton të shkuarën. Kujton pasurinë që kishte, miqësinë me gjithë botën, argëtimet dhe nderin e derës së tij. Mendon se në ç'gjëndje është, prandaj e vendosi të shpëtojë. Kërkon vdekjen.

— Ah, — thotë. — Me të vërtetë që bota është e pabesë. Ku janë miqt? Pse tashti s'më ndihmon asnjë? Pse s'më hedh njeri sytë? Ah, po, po... s'qasën më, s'duan të më shohën, se jam në këtë gjëndje. Ah, botë! Ehu, o jetë e pabesë! Të provova unë. Kur qeshë i pasur dhe gurët më deshën e më ndigjonin. Fjalët e mia ishin ligj. Tashti dhe vëndi m'u bë armik... Tashti — s'rroj më... dua qetësi. Ah, o botë! Nuk e dua më rrojtjen, se nuk mund të shikoj ata që kam ushqyer me krodha. Jo, s'e dua jetën, se kur shkova t'u kërkoja ndihmë, në vënd të përkrahjes më dhanë shkelme. E ç'pres më nga kjo jetë? I vetmi shpëtim është... është vdekja, vdekja. Ah, çudi, çudi, për Zotin. Nuk mund të shikoj mëkatet djallëzore që u shpërndanë në të katër anët e dheut. Mbretëroi mundimi. Humbi besimi, humbi ndërgjegja.

Flet me vete dhe ërrësira ja përpin mendimet.

Qan si i vogël: kërkon vdekjen. Ulet pranë tryezës, rrëm'ben penën dhe fillon të shkruaj:

«Unë shpëtoj. I jap fund jetës. Vdes, se kërkoj qetësi. Mjaft vuajta, mjaft u tall me mua fati. Durova sa munda, durova pa kufi rrahjet e pamëshirëshme të kamxhikut të varfërisë. E bëra zëmrën gur sa m'u bë copë copë. I jap fund jetës, se u linda për të vuajtur. Vdekja është shpëtimi i vetëm i shpirtit tim të shqetësuar, vdekja është lirimi nga skllavëria e mbretërisë së gënjeshtreve. I jap fund jetës sime, se kot rojta, kot u mundova, kot ëndërova, kot u përpoqa të shpëtoja nga thonjtë e fatit. Vdekja është shpëtim, vdekja është fundi fitimtar i luftës së paprerë kundra jetës së pamëshirëshme. Vdes i lumtur, se shpëtoj... dhe do të vdisja më i lumtur po të mos lija në mëshirën e fatit gjashtë të vegjël, por, ehu, është shkruar që në djep jeta e tyre».

I dridhet dora e nuk mund të shkruajë më; sytë iu mbytën prej lotëve. Shtrin duart mbi tryezën dhe s'guxon të kryejë vendimin e shpëtimit. Mendohet e dridhet. Merr nagantin e mbështjellur, e shikon nga të gjitha anët për shumë kohë. E vë mengadalë në tryezë. Dridhet. Merr penën dhe, si i tërbuar, vazhdon të shkruaj:

«Nuk e dua jetën. Do vdes, do vritem, do shpëtoj. Nuk mund të duroj pabesitë dhe poshtërsitë e botës. Isha më i pasuri, u bëra më i varfëri i botës. Kështu e ka kjo jetë. Ehu, si kthehet rrota e fatit. Po s'kam se ç'bëj. Mejtova të bëj ç'do gjë, po s'qe e mundur të bëja gjë, dhe as që do bëja gjë, se i varfëri, sado që të përpiqet që të iki nga vallja që ka zënë, pa mos patur asnjë përkrahje, varfërohet më tepër. Unë arrija pikën e fundit.

Prandaj kërkoi vdekjen. Iki nga kjo botë, nga gënjeshtrat, nga mundimet. Shkoj në qetësi. U lë shëndetin, o vëllezërit e mi. Mos paçi fatin tim. Dhe ti, o mëmë, bën durim, se Zoti, — në pastë, — do të mëshirohet. Unë shpëtoj, vdes. Dua të vi t'ju puth, por s'guxoj se... ju zgjoj dhe do të më kërkoni bukë. Më ç'do derë trokëllita, kudo shkelme piva. Pra, ju lë shëndetin... Vdes, vdes. Shpëtoj. Një botë e qetë më pret, mbretëria e lumturisë».

Dridhet e s'mund të shkruajë më. Iu ngjeth mishtë e filloi të qante pa pushim. Hedh penën poshtë dhe si i pamënd gjëndet më këmbë. Kandili falet. Dridhet i tëri. Shtrëngon nagantin me fuqi, tytën e të cilit e ngjit në sisën e majtë. Hedh vështrimin e fundit për qark: errësirë! Nuk sheh gjë, nuk dëgjon gjë. Rri palëvizur. S'mbahet më. Kërkon vdekjen, humbet ndiesitë e bërtet.

— Vëllezër... shpëtooj!... — E në mes të atyre fjalëve të forta e të dredhura, u dëgjuan krismat shurdhonyëse të nagantit që mbante në dorë. Dhoma ushtoi. Fatkeqësi. Një shtyllë u përmbys përdhé pashpirt. Atë që kërkonte, e gjeti. Asgjë s'u ndie më. As dhe fëmijët që flinin në dhomën tjetër... Duket se uria i kish nanuritur për në gjumin e përjetshëm.

«ILLYRIA» Nr. 2 — mars — 1934

KUR TALLET DHE FATI...

«Dashuri në mjerim!»

Ashtu psherëtimi me një shqetësim të thellë Lekë Nushi, i cili kishte tërë ditën që sillej vërdallë për të gjetur ndonjë strehë të qetë, ku të prehej nga lodhja e trullosur. Ishte hera e parë që ndjeu një tronditje dhimbjesh në brëndësirën e tij.

«Pse më bëre të vuaj?»... Këto ishin dhe fjalët e fundit që i tha «ajo» atë ditë të çuditëme për të. Se porsa kaloi andej — pa ditur se për ku shkonte, pasi s'dinte se kujt t'i kërkonte ndonjë «hua» për t'i dhënë diçka të zotit të shtëpisë ku flinte — i hutuar dhe i mërzhitur siç ishte, u ndal tek dera e «asaj» që shpesh herë e shikonte me një buzëqeshje kuptimplote. Pa pandehur «ajo» hapi derën dhe me një zë të dredhur i tha:

— Zoti Lekë.. Urdhëroni pakëz?

Pa i folur fare, si i tërhequr nga një magnet, u fut brënda dhe u gjënd në një sallon të shkëlqyer.

Dhe pasi i shkuan mijra mendime, për një çast u ul në një «kulltuk» shumë të butë dhe madhështor.

— Si je, zonjushe?

«Ajo», kokëulur, i ndënji përkundruall, i hodhi një shikim me ata sytë e saj të mëdhenj e të zes, pastaj... duke zënë fytyrën me të dy duart, murmurisi:

— Pse më bëre të vuaj?

Leka, pa dashur qeshi i habitur. Ishte ky guximi i një vajze shqipëtare. Po, e kuptonte apo nuk e kuptonte?... E vërente me kërshëri. Deshi t'i thoshte fjalë.. fjalë... t'i fliste. T'i humbiste gjurmët e shqetësimit.. Po.. heshti...

— Fol, o Lekë. Pse më bëre të vuaj? Apo buzëqeshjet e tua janë të zakonëshme dhe tallen me çdo femër? Thuama copë, më do apo s'më do? Dhe pse më solle në këtë gjëndje, sa s'di se ç'bëj, s'di se ç'them! Folmë.. folmë...

Dhe ja shkrepiti të qarit.

Lekë Nushi e humbi fare toruan. Harroi fare dhe hallet e tij. Heshti. Dhe pasi nuk dinte ç'ti thoshte, u mat të ikte. Po pasi ajo përsëriste:

— Unë të dua.. Pa ty nuk mund të rrojë.. Po ti, a më do mua, apo tallesh?

...u ul më mirë. Nënëqeshja e syve të tij të zes humbi përnjëherësh. Mblodhi veten. Fërkoj një herë faqet e tij të parruara dhe tha me vete: «Dashuri në mjerim a vete?»

Pastaj me një ton serioz, duke pështetur duart në anët e kulltukut, i foli kështu:

— Si të quajnë?

— Angjeliqë...

— Angjeliqë? Eh, dëgjomë pra, moj Angjeliqë.. A më njeh mua se cili jam?

Dhe këtë ja tha që t'i tregonte gjëndjen e tij të mjeruar.

— Nuk më duhet të di më tepër se sa di unë

për ty.. Unë të dua.. Këto ditë na erdhi në shtëpi një shkelës.. Më kërkoi për një gjykatës.. Për Lipë Gjokën.. E njeh ti? Mirëpo unë nuk martohem me asnjeri.. përveç.. teje. Besomë se vuaj.. Më ke çmëndur.. më ke çmëndur...

Dhe i shtoi më shumë dënesat.

— Angjeli! Tani nuk jemi më të vegjël. — Ç't'i thoshte? E zuri një hall i madh, një hall i papritur. Dhe e vërteta ish se ai e donte dhe e donte me zëmër.. Prandaj shkonte andej shpesh herë dhe e përshëndeste.. për t'u ngushlluar nga sytë e saj për gjëndjen e keqe të tij.. E përshëndeste me një ëmbëlsi të sigurtë. Dhe e respektonte se ishte e motra e një shoku të tij të ngushtë. Ishte një vajzë e rritur me pekule, nga një familje fisnike dhe mjaftë pasanike. Kishte dhe një prikë të mirë. Dhe ajo ja tha copë Lekës, se asnjeri nga familja e saj nuk mund ta pengonte në zgjedhjen e bashkëshortit të saj.

Mirëpo ky ç'të bënte? Ç't'i thoshte? Ky i ri i varfër i këputur porsa kish mbaruar studimet. Gjëndeje në pellgun e mizerjes, familjarisht. Ndohej në qytet prej kohe dhe mudohej të vendosej më ndonjë punë... Po, mjerisht, ishte e pamundur, pasi ky nuk mund t'i përshtatej shoqërisë ndërkohëse... Dhe vuante shumë. Po gjithëmonë qëndronte i lartë në karakter. Vuante me dhimbje e shqetësim jetën e kohës dhe shqetësohej më shumë. Dhe tani, ja, pa prituri i doli një bela tjetër, një bela midis andrrallave të shumta që e mundonin...

— Angjeli! Ti duhet të më njohësh më parë e pastaj të flasësh ashtu.. Unë.. nuk dua të bëjë njeri të vuaj.. për mua.. mjafton që vuaj vetë..

Jam i këputur dhe më duken si tallje këto fjalë që më thua...

Ajo ja preu:

— Të gjitha i di... si... Besomë se të dua. Bukë e kripë të kem, veç dua të rrojë pranë teje... Lekë, të dua.. Do të të bëjë të lumtur... Vendose, vendose, Lekë... të.. martohemi bashkë...

Me të dëgjuar këto fjalë të ngatërruara, atij iu turbullua gjaku. E shikon me përmallim. I afrohet. Ja fshin lotët që rrëke i rrokulliseshin në faqëzat e saj të njoma, i hedh duart në sup dhe, pa i thënë «rruga ime është e gjatë», i foli, ashtu pa menduar:

— Angjeli! Unë jam.. i lig... Unë.. ashtu i buzëqesh çdo femre... Ndjenjat e mia i kam cop-tuar me kohë.. me kohë.. ha-ha-ha.. Unë të qesha. të talla... ose.. ose... të përshëndeta si motrën e shokut tim.. po.. Të desha e të dua si motër.. Ti je e çmëndur që më dashuron mua, një njeri të humbur nëpër rrugë.. të ndjekur... Ti merre, martoj me Lipe Gjokën, se është një djalë i mirë, shumë i mirë.. E njoh. Është fisnik. Me atë do të kalosh një jetë të lumtur.. Dëgjo.. Unë s'të dua.. Angjeli!.. Tungjatjeta!

Dhe si i shkalluar iku. Iku me të shpejtë, i rënduar, i lënduar, i dehur...

Kur dolli përjashta, fërkoi njëherë sy e vetulla dhe u mendua:

— Përse i vija vërdallë? Përse? Hë-hë! Për të gjetur ndonjë «hua» sa të paguaja qiranë e shtëpisë.. Ndryshe, sonte jam përjashta..

Ktheu kokën pas dhe pa se dera e Angjeli ishte e hapur. Jeta e qytetit vazhdonte ritmin e saj, ndërsa Leka 'bredhërinte i shqetësuar, se në

veshët e tij akoma tingëllonin fjalët e fundit të Angjelicës, e cila, kush e di, mbase akoma vazhdonte të qante e dëshpëruar: «...Mos ik. Eja prapë.. Pse më bëre të vuaj?..»

— O jetë! — fliste me vete Leka që ecte pa drejtim — as më thuaj, a ka dashuri në mjerim?

Dhe duke ecur e folur këto fjalë, u ndal i trëmbur nga një zë i njohur që i ra si bombë:

— Lekë, sot pa tjetër dua qiranë e shtëpisë.. Përndryshe e ke keq punën...

Sa ndryshim kishin këto fjalë, ky ton, nga fjalët, toni dhe lotët e dhimbëshme të Angjelicës!

(revista «JAVA», prill 1937)

VAJZA E VALAVE

Valët e tërbuara të detit që pëllicisnin të shkumëzuara mbi shkëmbinjtë e thepisur të bregut, bënin që të humbiste kënga e zakonëshme e djemëve të lagjes, që ja kishin shtruar rrëzë Shën-Mitrit. Melodia, megjithatë, arrinte gjer te veshët e Lolës, e cila pëlliciste nga marazi dhe, fshehurazi, qante e qante me dënese, që të këpusnin shpirtin. Atje poshtë, në fund të horizontit, mbi det, disa re të kuqe silleshin vërdallë nga fryma e fundit e tramundanës. Këtej lartë manaret blegërinin. Ktheheshin nga mali. Mu në mes të fshatit kënga lëvonte, kurse fshatarët, që gjithë ditën kishin punuar, tani të lodhur i drejtoheshin vatrës së tyre. Dita po perëndonte..

— Bijo, mos qa më. Bën durim, se Neçua do të kthehet! — kështu i pëshpëriste gjithnjë Lolës vjehrra e saj. — Ta dije se sa vjet më iku edhe mua, ndjesë pastë, plaku im! Iku, more, iku dhe anë kur të kthehej! Ti do të thuash se mua më la Neçon në bark, dhe shpresoja! Eh, mirë! Ka perëndia edhe për ty. Po bëhu trime dhe duro të durojmë...

Nga njëra anë këto fjalë dhe nga ana tjetër kënga e mallkuar që oshëtinte në sheshin e Shën

Mitrit, ja coptonin zëmrën nuses së gjorë, e cila kishte humbur çdo shpresë. Se kishin kaluar tetë vjet dhe Neçua nuk dukej. Neçua levend, këngë-tari i fshatit, që me këngën e tij e kishte çmëndur fare Lolën e ëmbël, kishte marrë gjurmët e mërgimit. Kishte ikur për të fituar para. Kishte vajtur shumë larg, atje ku perëndon dielli, në Argentinën e pasur.

— Do të kthehet plot flori dhe i ngarkuar me peshqeshe. Ai thoshte se do të binte pesë baulle të mbushura.. Tërë lagjen do ta kënaqë...

— Po pse nuk na shkruan, moj nënë? Gjithë bota thotë se ai humbi. S'e ke vënë re se si ma hedhin shoqet e mia?

— Duro të durojmë, bijo! Ka Perëndia dhe për neve. Mos u merakos, se Neçua s'është nga ata që humbet kollaj në mërgim... Vetëm lutu gjithnjë e mos ua vërë veshin shoqeve. Ashtu e ka ky kurbet i zi...

Dhe, duke mbaruar fjalët me një psherëtimë të thellë, plaka e regjur nga vuajtjet, lidhte duart ulte kokën dhe largohej në majë të këmbëve. Ajo e gjora e dinte se ç'i ziente në brëndësirën e saj. Neçon e shtrënjtë, djalin e vetëm të saj, e martoi të vogël vetëm e vetëm që të zinte gojët e këqia. Se që ditën, kur Neçua këndoi këngën «Vajzë e Valave» nën dritaret e Lolës së ëmbël tërë fshati nisi të pëshpëriste. Dhe kështu, një ditë vendos dhe e martoi, se i vinte keq edhe për vashën që i duallën fjalë... Dhe bëri një dasmë të madhe, ku u dehën që të gjithë me verën që kishte mbledhur për të pritur burrëzinë, që s'kthehej kurrë. Në dasmë u këndua pa pushim dhe kënga e të mar-

tuave «Vajzë e Valave», kënga që Neçua kish ngri-
tur për Lolën.

Djemt e lagjes, të mahnitur dhe gati të shka-
lluar nga bukuria që dita ditës i shtohet Lolës, e
kishin ndryshuar këngën në disa vargje dhe përsë-
risnin:

...Gjithë bota ven' e vinë,
po ai nuk vjen, a e mjera,
po ai nuk vjen...

Dhe me gjithë këto nxitje e shkrepse për të
ndezur ndjenjat e saj, Lola duronte e duronte. Pri-
ste me besim Neçon e saj. Shpresonte në fjalët e
tij të fundit që i tha kur iku: «Sado që të vonoj,
do të kthehem një ditë.. Edhe i vdekur, unë do të
kthehem...»

Atje poshtë, te shkëmbi i madh, shikonte var-
kat që lundronin. Vërente vëndin ku punonte ba-
shkë me Neçon dhe qante. Dhe matanë djemt, që
kurrë nuk e linin të qetë, këndonin:

Vajz' e Valave,
je një vajz' e re,
un martohem n'atë jetë,
ti martuju atje, a e mjera,
ti martuju atje...

Sa e sa djem të pasur dhe levendë e kishin
kërkuar Lolën ëngjëllore. Po kjo, besnike gjer në
vdekje, asnjëriut s'i kthente sytë. Priste Neçon e
saj.

Dhe vitet kalonin.

Asnjë lajm. Asnjë të re nga Neçua. Shtatëmbë-
dhjet vjeçe u martua Lola. Vetëm dy muaj ndënji

me Neçon e saj. Dhe pastaj ai i iku. Tani, grua, tridhjet vjeçe, duket më e bukur dhe më e re se ditën që u martua. E shkreta! Qante e qante dhe hera herës mërztëj aq shumë, sa mendonte të mbytej atje poshtë, te ai shkëmbi i madh, ku valët e shqetësuara pëllcisinin, duke humbur këngën që dita ditës dëgjohej në mes të fshatit. Ishte kënga që e çmëndi, që e bëri të dashuronte gjer në vdekje Neçon e humbur. Ishte kënga e saj që mbante gjallë në zëmër kohën e parë, kur shtrihej me Neçon atje poshtë nën portokallet dhe qitrot, ku Neçua i thoshte se ajo ishte «Vajza e Valave» dhe ah, atje, të pandarë, të përçafuar, kujtuan se vetëm në Argjentinë ka shumë flori për të ngritur një pallat mu në mes të fshatit, sa të pataksej bota... Ajo ishte kënga që i sillte ndër mënd çastet më të lumtura dhe prapë ajo ishte kënga që i coponte zëmërën, që e dëshpëronte dhe që nuk e linte të qetë... Po ajo shpresonte. Priste Neçon e saj...

* * *

Dhe një mbrëmje vjeshte, kur Lola kthehej e lodhur nga puna, u ndalua mu në hyrje të fshatit nga një vajzë e vogël.

— Sihariq! Sihariq!

— Ç'është? Ndonjë lajm... a ndonjë letër?

— Erdhi!

— Erdhi? Rron.. apo nuk rron?

Dhe me shpirt të ndezur e me gjunjë të pre-ra desh të vraponte, po nuk mundi.. Përqafoi vashëzën «Do të të japë... do të të japë...» po nuk fliste dot.. Lotët nuk i mbajti dot.. I rridhnin çurkë në faqet e saj të djegura nga dielli i Himarës.

Si në furtunë, kokëulur, çante njerëzinë që kishte mbuluar oborrin e shtëpisë së saj. As dëgjonte se ç'i thoshin dhe asnjeri nuk njohu... Për çudi dhe as vuri re heshtjen që kish pllakosur tërë ata fshatarë që e shikonin Lolën me dhimbje, sikur i qanin hallin. Shkarkoi barrën, dhe gjithnjë, si nëpër gjëmba, kokëulur, u hypi shkallëve. I dolli plaka. E përqafoi dhe me lot ndër sy i tha:

— Erdhi bijo... Erdhi.. po...

— Po.... si?

Dhe si e shkalluar, si e zgjuar nga një gjumë i trubullt, hyri brënda. Dhe e pa Neçon e saj të shtrirë në shtrat. Me sy të përlotura, pa e dalluar mirë fytyrën e zverdhur dhe sytë e thelluara të burrit të saj, u gjunjëzua për ta përqaftuar....

— Mos.. mos më puth o «Vajzë e Valave» — i tha, dhe ktheu kokën matanë, pa i përmbajtur lotët...

E mjera! E kuptoi se Neçua i saj ishte verem! Heshti. Pastaj iu bë sikur dëgjoi këngën e saj të këndohej përjashta, në sheshin e Shën Mitrit, nga djemt e lagjes... U trondit aq thellë, sa i ra në prehër Neços së saj duke i thënë:

— Misedhe! — dhe e puthi fortë mu në buzë...

(Revista JAVA — prill 1937)

« K E S M E T »

Mu në mes të fshatit, pleqtë bisedojnë: «Duhet marrë fund kjo çështje... duhet marrë fund sipas kanunit tonë, pa ndërhyrjen e ligjeve të reja...»

Fjalën e ka xha Foti, njeriu më i urtë dhe më i gjezdisur. Plaku i thinjur nga hallet dhe rrugët shumta të jetës, lloisej. Burri më i nderçëm dhe më besniku i zakoneve të mira arbnore. Flet duke i drejtuar sytë e tij të mëdhenj, herë tek njeri dhe herë tek tjetri. Dhe shokët e dëgjonin me një vëmëndje të thellë:

— Pse i iku e fejuara? Pse e gënjeu duke i thënë se e donte dhe se do të thoshte «po» në komune? Është turp për të dhe bile turp i madh.. Dhe pastaj, më e keqja është se ai tani ndodhet në burg, andaj ne duhet të përpiqemi që ta shpëtojmë, pa vendosur akoma drejtësia e re për dënimin e tij.. se do të mirret në qafë.. E ç'kemi në dorë? Flisni!

Asnjë nuk përgjigjej. E ç'të thoshin? Ishte kjo një punë dreqi, që nuk i gjëndeje ana. Tasi Dhorin e kishte shtënë në dorë drejtësia, se kur shkoi ky në komune për të bërë celebrimin e martesës, e fejuara i iku me të shpejtë si flutur, se ajo ishte tetëmbëdhjet vjeçare, kurse ky i gjori vrapoi ta

zinte — bile e qëlloi dhe me kobure që ta vriste — po s'mundi, se mosha e tij dyzet e pesë vjeçe nuk e lejonte, nuk i jipte krahë të fluturonte dhe ta kapte Fotinën e re, e cila, si thëllëzë mali, i fluturoi përjetë...

Kjo ngjarje, nuk shqetësoi vetëm fshatin, po gjithë krahinën. Ishte një ndodhi e jashtëzakonshme, e cila do të bënej shkak gjaku. Prandaj pleqtë bisedonin me orë të tëra, të kërrusur, të thelluar në mendime, për t'i dhënë një zgjidhje të mirë, sipas kanunit, këtij skandali...

— Flisni, pra, si do të vejë halli?

— «Kësmet!» — tha padashur i jati i vashës, i cili u ngrit më këmbë dhe bëri që të ikte.. se u bë tërkuzë u bë, ky kuvëndim.. Mirëpo, me të parë Fotinën e tij të vinte drejt kuvëndit të pleqëve, u ndal i hutuar. E humbi fare torruan dhe vërente me kureshtje bijën e tij, e cila iu afrua kokëulur dhe me sy të përlotur pyeti:

— Baba si vendosët?

— «Kësmet!» bijo...

Dhe Fotina, e cila kush e di se sa mijra herë e kishte dëgjuar këtë fjalë të mallkuar, mbloodhi veten dhe, duke mos vënë re asnjeri, nisi të fliste, të çfrynte, të thoshte atë që kurrë s'kish guxuar ta shprehte:

— «Kësmet!», «kësmet!» Gjithë jetën time e kam dëgjuar këtë fjalë të mallkuar. Kam kujtuar se ishte diçka e mirë... e shënjtë.. Po «kësmeti» më morri në qafë. Jo ti, jo, jo ti, po «kësmeti» yt, që kurrë nuk e hoqe nga goja të shkretin... Kurrë nuk më pyete, kurrë nuk më the një fjalë tjetër. Po vetë ti dhe ky «kësmet» më fejuat me një njeri të mirë. të pasur dhe të dëgjuar.. Oh, pun' e madhe... Nuk e

sheh...! Plasa unë për pasurin e tij! Ashtu, ë? Jo! Nuk e dua! Dhe as që dua ta shohë kurrë... kurrë.. Dhe ti ma caktove si bashkëshort, ë? Ai është më i madh se ti! Ai le të gjejë shoqen që i takon.. Dëgjon apo jo?

Të gjithë mbetën gojëhapur. Po asnjeri nuk ja preu fjalën.. Ishte një punë e madhe, një punë e re dhe shumë e ngatërruar për ta zgjidhur. Për ta zgjidhur me kanunin e vjetër e me kanunin e ri.. Fotina i hodhi një shikim kuvëndit dhe, duke zënë fytyrën me të dy duart, u pështet në prehërin e të jatit..

— E dëgjuat, apo jo? — tha xha Foti — Ka të drejtë.. Flet me të drejtën e saj. Po, me të drejtën e saj.. Dëgjoni, apo jo? Dhe këtë të drejtë Fotinës ja mbron dhe kanuni i ri. Po kanuni i ri i kohës së re, që thotë se një vajzë nuk mund të martohet me një burrë që nuk e do. Prandaj, më duket një mundim i kotë për t'i pajtuar.. Nuk do të veprojmë drejt.. Ne, që të mos mallkohemi nga gjeneratat që vijnë, nuk duhet të lëmë njolla në vendimet e kuvendeve tona..

Që të gjithë shikuan njeri-jatrin.

— Domethënë Fotina nuk është më e Tasi Dhorit? — tha plaku më i mocëm i palës së dhëndërit.

— Jo! Është e lirë.. e lirë..

Ashtu vendosi kuvëndi me urtësi. Dhe kur Fotina dëgjoji këtë vendim, iu hodh babait, e përqafoi, e puthi me mall dhe që të dy u nisën për në vartrën e tyre varfanjake.

— Mirë, moj bijë! Po tani? Ti do të mbetesh brënda! Ku do të gjesh ti burrë nikoqir dhe të dëgjuar? Apo «kësmet?»

— Mos e dëgjofsha më këtë fjalë që mori në qafë gjithë jetën tuaj si dhe timen për pakëz... Tani asnjëri nuk e beson, nuk shpreson më në të.. Tani cilido varet nga fuqitë e veta... Sidomos në të rejat...

Dhe dielli perëndonte i kuqërruar matanë maleve të Memuçit, atje ku deti është gjithnjë i shqetësuar. Dhe bashkë me të perëndoi përgjithënjë «kësmeti» i Fotinës, e cila, me sytë përdhe, me fjalë nëpër dhëmbë, i thoshte t'et:

— Dhe sa për mua, ti mos u bëj merak baba.. se të djelën do të vijë të më kërkojë Ndreu rrobapësi, të cilin aqë shumë e dua.. baba!

Ky deshi t'i përsërište «kësmet!», po nuk mundi, se e kishte pushtuar dhe përqaftuar Fotina e tij.

revista JAVA, prill 1937

II

Gjurmët e Kohës - Vezhgime

(Me pseudonimin **DEMO—KOTI**)

Jam apo s'jam
e dija!

Po një mik
fshat, në një nd
gra për vijën e u
të rinjtë jini me
ju!»

Të them të
fare ndër mënd l

Tani që «ka
nxjerrë në mejda
edhe unë pranë t
nin si esnaf të t
lem! Po... leqet e
i madh më shtroi

— Është zakon
që të marrësh një
provimi! Dhe duk

— Çfarë? —

— E parë e p
lem! Në daç të tr
mo, ulu dhe na s
se ngacmon pleqtë

URMËT E KOHËS

PROVIM

m njeri me kalem?! — Këtë nuk

xhandar ma kishte thënë që në
rhyrje që bëra, kur ziresin dy
jit. Dhe ma kish thënë copë: «Ju
kalem, andaj s'flet dot njeriu me

drejtën, mua s'më kishte shkuar
y mendim!

emxhinjtë» u mbloodhën për të
n një «ZEMAN TË RI», u qasa
yre, duke iu lutur të më prano-
yre, pasi qenkësha njeri me ka-
këmbëve m'u drodhën kur ustai
në provim!

n i ri, o i ri, — më tha. — Sot,
punë, duhet t'i shtrohesh një
et të kesh disa «cilësira!»

e pyeta unë.

unës duhet të jesh njeri me ka-
ashë e në daç të hollë. Pra, De-
hkruaj një artikull. Po... sakën
As të rinjtë mos i nga, se i ha

me sy! Ki mëndjen e mos thuaj se populli vuan për bukë! Dëgjon? Këtë kije parasysh! Pastaj mos shkruaj se parlamenti ynë merret me cikërrima... Me pak fjalë, or vëlla, mendo mirë e mate mirë kalemën, se këtu i thonë Tiranë e kuqe!

RAMAZANI!

— U, të shpërllaftë murtaja!

— E ç'pate, o lumëmadh! I pari ikën darkë për darkë nga zyra! Një herë na thua se të dhëmb barku, një herë të dhëmb koka... Një herë thua se ke vjehrrën sëmurë... një herë të kërkon kasapi... të kërkojnë në tombola... ose ku di unë!

— Aaa! U betova për kokën e kasafortës! Nuk të lejoj më, jo! Sot, s'më ikën dot! Mjaftë na talle! E pse s'na e thoshe troç që agjëron?!... Agjëron, ë? Ti, ti agjëron dhe je një neqes i tmershëm... aq sa i kërkon cigare njerit e tjetrit dhe vetë kurrë nuk blen një paqetë? Pastaj sillesh dhe shumë keq me miletin, dhe agjëron, ë? Dhe je qatip beledije... kështu, ë? Hem mban ramazan, hem je mistrec ndaj kuranit...

Dhe ndërsa shefi i zyrës i fliste kështu qatipit, ra topi! Barqet e zbrazura nisën të mbusheshin.... Njerëzit vraponin për në vatrat e tyre për të ngrënë yftarin, kurse zorrët e qatipit neqes e dhelpër, qatipit fanatik, kishin filluar të lëviznin e të grindeshin... Derën ja kishin mbyllur dhe do t'ja çelnin kur të mbaronte orari zyrtar... E pa ngusht qatipi i shkretë, dhe, me gjithë kritikën e shefit nuk i harroi zakonet:

— Amani, një duhan sa ta çel!

PAZARI I MBARË!

Nuk arrijti dot t'i thoshte as «pazar' i mbarë!» se i shkanë opingat e mezi e ngritën! Po ai as që foli, as që vuri re tërë atë baltë që kish marrë me vete, po si pula gërryente llucën për të gjetur katër lekët që i kishin rënë!

— Të falem nerës, o Sul! A s'e pae, bre! Ene katër lekët që fitova tuj shit dy pulat e strenit, m'ranë në baltë, bre! Asht bedvaja e plakës... se ajo m'tha mos me i shit.. po halli, bre!

I tha këto dhe u ul mbi rrogzin e shokut të tij.. Edhe këtij i kishin mbetur pa shitur drutë! Di-ta e pazarit po mbyllej, se afrohej mbrëmja. E ënj-tja ishte më të sosur, ndërsa katundarët po shpej-tonin për t'u kthyer në kasollet e tyre...

— E pse i shite katër lekë, a? Dy pula streni katër lekë?

— Æ, or Sul! Erdh një efendi ne më shikonte me inat. Ene pulat i shikonte me inat! Erdh një qatër e një qatër... Të gjithë me inat po m'shikojshin, ene mue, ene pulat! Ne m'thojshin se pulat janë t'smuuta.. e s'bajnë një pare, se janë ene të moçme.. Ene unë, ma n'fund, ja shita një t'moçmi që m'tha se ish *mebuth* (deputet)... se ky m'tha se ai asht babë i kombit dhe shpejt kanë me na çue kallamboq n'katund, kallamboq badjava, nëse unë i shitja atij dy pula streni katër lekë! Më dha ene një duhan, bre! Me vërtet ai ish i moçëm, po sheqer.. sheqer.. M'tha e m'tha e m'tha, derisà më morri pulat e strenit ne iku...

Do të vazhdonte të fliste akoma për deputetin «sheqer», po të mos kishte ardhur një zonjë që kërkonte dru! Zonja drutë i bleu sa deshi, se afro-

nte nata. Pazari mbyllej. Vetëm këta të dy ishin akoma atje dhe vëndi s'i mbante. U ngritën. Blenë dhe dy simite të ftohta, ua hypën gomarve dhe ikën..

Ishin larguar shumë nga Kryeqyteti, kur Sula i tha shokut:

— T'paska rejt ai plak *mebuth* që t'tha se kanë me na çue n'katun kollomoq badjava!... Aaa.. ia lagu, 'bre! T'morri pulat e strenit badjava... se kjo asht puna e *mebuthëve!*

UDHËTIM

Nga BALLKANI, në LLONDON, BERLIN dhe...

Sa vjet rri njeriu në një vënd dhe atë vënd nuk e njeh fare!

Janë shumë nga ata që s'dinë se ku gjenden, ndonse kanë dëgjuar, se rrojnë në kryeqytet! Mbase, edhe unë do të jem një prej tyre... se jam shqipo! Dhe... mjerisht shqiptar do të thotë sot një njeri që s'di se ku rron!.. Atë meraku e ha për botën!.. Edhe ai ëndëron, shpreson... po sot ideali i vetëm i tij është KULLTUKU! Sa mjerim!

Unë sot e shkela benë! Ndaj nisa të udhëtoj mospërmes vëndeve të panjohura të Tiranës! U hodha në BALLKAN! Ç'të shohë! Shoferë, udhëtarë, hallexhinj... kolcinë, xing...

— Një kaaafe me shumë! — me zi u shqua ky zë i fortë, se në BALLKAN nuk njeh qëni të zonë! Zhandarë, ushtarë, lebër e malësorë! Çorba e miletit tonë! Jeta që ndizet nga ëndrat dhe nga shpresat.. Tamam BALLKAN! Fuçi baruti! Dhe do të largohesha sa më parë, se me të vërtetë binte

erë baruti dhe erë... hafië, po të mos më kishte tërhequr vërejtjen pamja e dy xhandarëve të mjerrë.. Bisedonin shtruar:

— Unë e kam mik tetar Veselin. Më ka dhanë një pusull për komandantin. Kush e di.. mun që allahu na ndihmon ne më heq prej Zadrime, se anej u mbytëm në lum bre!.. Pastaj, atje robi asht gati me vra vedin!..

— Hej, or mik! Sakën se ikën nga Zadrima! — i thoshte xhandari tjetër. — Aty je mirë, se këtu ne jemi mbytur në borxhe... Mos pyet se si jemi!

Disa më hidhnin ca sy sikur deshën të më hanin! «Ik, o Demo!» — thash me vete. Xhandarët qanin hallet e tyre. Aty binte erë baruti... Ika, po nuk do t'i harroj fjalët e fundit të xhandarit:

— Më mirë të mbytesh në lumë se sa të mbytesh në borxhe!

* * *

E humba fare kur pashë atë birko rrugë të gjatë, ku njeriu duket si mizë! Lumë ato këmbë që shkelin mbi këtë rrugë të bukur! Lumë ata që dëgjojnë bisedën e heshtur të njerëzve pa halle.. Dhe, më në fund, lumë ato pllaka të vogëla që kushtojnë një frang ari njera, që s'kanë parë këpucë të grisura dhe baltë kryeqyteti!

Hyra në LLONDON!

Tym e lëvizje! Xhol e poker! Qindra zotërinj të veshur alla-inglizi, të heshtur, të menduar, të ftohtë... si inglizi!

— Aaa! — thashë me vete — Ja se ç'do të thotë të jesh në Llondon! Vënd tregëtar, me shumë lëvizje!

Hynin e dilnin. Biseda të heshtura. Po çoku shquheshin fjalët «deputet», «ministër», «shëf», «fajdexhi», «bejlerë»... «rekomandime» e «kartëvizita»...

Desha të ulesha edhe unë e të pija ndonjë gotë birre, po me të dëgjuar «emërime» për në «kolonitë e ndryshme «të imperos»... «dekorime», «dekretime», «buxhete», «rroga»... se, helbete, kam dëgjuar që «miku s'pi më ujë», pasi barku i është bërë akull! Kush e di! Për «këta», ndoshta... Është jeta e Lndonit që rrjedh e matur në shoqërinë e soçme... jeta që sundon, sidomos që dominon «kolonitë» e largme e të harruara të Atdheut tonë...

* * *

...Më tërhoqi BERLINI! Sidomos zëri i fortë që thërriste:

— Gjaaaaashtë! Tridhjet e gjaaaashtë! Dyzeeeeet e dyyyysi!

— Obobobo! BERLINI e bëri forra! Aman o zot! Gjithë ky farë mileti që, i kërrusur, rri duke patur përpara disa pusulla me numra... Kush e di mbase numërojnë ditët e plasjes së...

Tellalli bërtiti: — Më tridhjet e do të kër-casë dyzet e dyyyysi!

M'u pre gjaku!

Po befaz, një zotni me qylaf të zi u ngrit më këmbë dhe thirri:

— Atyyy! Tooombolla!

Era e perëndimit më shtyri me pahirë në një vënd ku shkëlqen qytetërimi. Ç'të shohë? Bukuri-ra... këрма të shitura, të pakallura, po të gjalla... frymë me vullnet të fortë e me dorë të çelniktë.. Hedh sytë mirë e shoh se gjëndem në BELLA VENEZIA.. Shumë i bukur Venediku! Po ç'fatkeqësi! Dallgët e fustaneve e kishin humbur «romantiçizmin», siç e kishin humbur dhe pastat që nuk vinin një e nga një, sipas rithmit të barkut të matur! Po silleshin pesë e pesë...

Me të gëlltitur një kremë, një kope ëndrash m'u zhyt në pellgun e plëndësit! Hëngra edhe një! Edhe një! Dhe sa ndryshova! Më thithi ambienti i qytetërimin! U bëra qytetar, po, mbi të gjitha, u bëra.. atdhetar! Ngrita pakëz veshët e etura për të dëgjuar biseda perëndimore.. Më rrodhën jargët kur dëgjova fjalët «shije», «zonjë», «modë», «zonjushë»... dhe sa e sa emra gjellësh me kripë e pa kripë! U hutova!

— Mori zonjushë! — i thashë pastës së fundit që me shikonte e vetmuar në pjato — as më thuaj, ku jam këtu?

— Ah, — m'u përgjegj duke më shkelur syrin, — këtu je në varrin tim dhe në vatrën e një «epo-ke të re»... që do të sjellë këtu tek ne, erën e perparimit... erë, e cila me fuqi do të çkulë gjithë vjetërsirat dhe ka për të çelur një rrugë të re jete dhe kohe....

Pashë se s'kishte ndër mënd të pushonte fare, andaj e rrëmbeva dhe, i zëmëruar, e gëlltita... Sa larg isha unë nga ato që më dërdëliste zonjusha pas-

të! Dhe ika! Shyqyr Zotit që në derë takova gështënjapjekësin...

— Mor po për ku je nisur? — e pyeta.

— Këtu s'është për ne! Unë po shkoj në KAFEN E CENIT, se u mërzita!

— Merrmë edhe mua me vete, pashë Zotin, se këto pasta që hëngra dhe kjo erë që fryn këtu, më bën allo-njeri!

— Kafja e CENIT është shumë larg për ju... — më tha me tallje — Ju nuk e njihni dhe as që kini për ta njohur jetën që jeton në zëmren e kryeqytetit... Oh, sa larg është për ju..!

* * *

Sa ndalesa, sa fjalë, sa telashe... për të arritur në KAFENË E CENIT? Sa larg që ishte!

— Qe KAFJA E CENIT, qe llukanda e Xanit, qe hani i Fajës, qe terzia, terzia prej Stambolli, qe furxhia që bën parure, qe remtari, qe qeleshe-xhia... qe... qe... Nji kjo asht dynjaja e fukarait, dynjaja jonë! Eh, a ta kanda këtë dynjallëk?

Sa larg m'u duk mua Kafja e Cenit dhe kjo botë e këtushme! Sikur ndodhesha më ndonjë kënd të Arabisë! E humba. Me gjithë këtë, kjo është Tirana. Pak çapa nga sheshi i Ministrive, po shumë shekuj larg jetës së mehmurëve, të cilët, siç duket, këtë pazar e kanë lënë për muzeum kombëtar të brëkësheve, qelesheve, jorganëve, rrogozëve, matrapazëve...

Hyra brënda. Mbi rrogoz lëvonte bixhozi! Tym! Dhe një tridhiet fytvra të djegur. Porsa më panë, u ngritën më këmbë. Unë isha i huaj aty...

— Urdhëno, zotni kryetar, urdhëno, kryetar

efendi! — Dhe pastaj mbretëroi një heshtje. Sytë e të gjithëve ishin ngulur në lëvizjet e mia. M'u afrua CENI e më tha me zë të shuar:

— Zotni kryetar! Vallahi e bilahi, sone s'kom me t'i pague! Ene myshterinjt që pinë ka një kafe, borxh e pinë! Ene t'lutem, kryetar efeni, me t'pague pas Bajramit, se s'kemi asnjë pare, vallahi e bilahi...

Siç e pashë, më muarrnë për kryetarin e Komunes ose për tagrambledhësin! U shtrova edhe unë në rrogos dhe ja nisa bixhës! M'u afruan e më rrethuan të gjithë e më shikonin me kureshtje të madhe.

— Aaa! Zotni kryetari e din mirë bixhën, se asht njeri me kalem bre!

Ata nisën të flisnin fjalë lëvdate për mua, po unë mendoja se si do të vihej në lëvizje ky pellg uji që binte erë...

(«Koha e Re», nëndor 1935)

«BALLKANI», «LLONDONI», «BERLINI», «BELLA-
VENEZIA» emri kafenes ku mblidheshin njerëzit e katego-
rive të ndryshme. Në Bella Venezia mblidheshin universi-
tarët, sidomos ata që kishin marrë kulturë gjermane...

VËRTET U NGJALL ?

Këtë mrekulli nuk e besoi as edhe apostull Thomai. Pa le t'u mbushej koka deputetëve tanë që thoshin:

— Si mundet, xhanëm, që Krishti të ngjallet vit për vit! Kjo s'besohet, se vetëm ne e kemi këtë privilegj. Tërë vitin vdesim e në vjeshtë ngjallemi. Sidomos në u ngjallshim prapë këtë vjeshtë, do të besojnë afetarët se ne jemi profitë. Kemi kaq vjet që vdesim e ngjallemi dhe akoma s'duan të besojnë.

Këtë muhabet e bënin mu në kishë, në mes të natës, afër priftit, i cili, duke fërkuar mjekrën biblike u hidhte nga një sy të egër. Po këta s'heshnin. Bile Kasua e tepëroi, se i ra një herë fort dhogës që kishte pranë, duke bërtitur:

— Zoti Kryetar!

Kotta, që rrinte i heshur si një fetar fisnik, e pa një herë me zëmërim, pastaj, duke vënë gjish-tin në hundë, i briti: — «Shuuut!» Shyqyr që s'e dëgjoi prifti, se do t'i kishte nxjerrë përjashta duke u thyer ndonjë qiri të trashë pas shpinës.

Kambana nisi të binte dhe një zë briti:

— Krishti u ngjaaall!

— Vërtet u ngjaaall? — thirri Karecua që e

kište humbur, se ishte bërë qull në djerrisë. Kujtoi se thoshin për barkun e tij që ish ngjallur më tepër. Sheh rreth e përçark, kur për çudi, pa më anë tjetër të kishës, afër priftit, Dr. Simonidhin dhe Vasil Avraminkën që gati po qanin, se e kishin marrë vesh qysh të premtën që Krishti u kryqëzua, prandaj kishin ardhur të ngushllonin priftin. Kishin rënë në një heshtje të thellë. S'dëgjonin gjë. Po kur kisha ushtoi prej më tepër se një mijë zërave «Krishti u ngjall!», atëhere deputetët tanë thirrën:

— Vërtet u ngjall?

— Po ku është, — i thirri me zë të lartë Simonidhi Xoxës.

— Nuk e di unë! Pyet zotin Kryetar, se unë s'e pashë!

— Zoti kryetar, bjerri ziles, duam qetësi këtu brënda. Na shurdhuan, bre! — i foli me inat Avrami Kottës.

— Mirë ne, po ti! Ç'kërkon këtu brënda, — i thanë Mirashit që ishte mbështetur pas bangos.

— Erdha të marrë pjesë në bisedimet rreth ngjalljes. Unë votoj në favor se e pashë dhe vetë me sytë e mi që u ngjall. E pashë dje në cinema që fluturoi në qiell. Prandaj dhe ju votoni.

— Vërtet u ngjall? — thirri prapë Simonidhi.

— Po s'e pashë vetë me sytë e mi, s'a jap votën time, — tha Poga. — Se unë jam përfaqësonjës i popullit dhe nesër s'mundem ta marrë në qafë dhe t'i them se u ngjall, u ngjall! — Thosh këto dhe fshinte kokën që i shndriste si një pasqyrë.

— Krishti u ngjall së vdekuri! — foli prapë

me fuqi prifti, duke u hedhur një vështrim të eger deputetëve.

— Vërtet u ngjall?

— Ore, ore, thoni po! se do të na turpërojë ky! Pa shikoni si na vështron! Obobo! Do të na nxjerrë përjashta, se këtu i thonë kishë. Nuk jemi në Parlament të kundërshtojmë me zjarr çdo ligjë. Këtu duhet të kemi frikë nga Zoti. Se në vjeshtë nuk na ngjall më.

Atëhere që të gjithë ngrehin gishtin dhe, duke shikuar herë Kottën, herë priftin, bërtasin:

— Pranohet, po, pranohet që u ngjall!

(«Vatra» 12 prill 1936 — faqe 2)

TRE ME ZERO

Kush e mban mend se ç'buje të madhe kishte bërë këtu e disa vjet sporti! Mbushej Shallvarja e shkretë me djem e burra, me gra e vajza. «Qëlloje Adem, merre Dake, përpara Mark!» bërtisnin që të gjithë dhe «hurra!» fusha ushtonte me mijra zëra që trumbetonin... në veshët e ministrit të arësimit që punonte dhe të dielave, nga puna e tepërt që kishte.

Po tani? Tani *ave* sport si gjithë punërat tona. «Bravo djalëri, bravo djalëri dinamike, se mirë e ke». «Të lumtë dhe ty, o publik, se e kuptove, prandaj nuk merr mundimin fare të shkosh deri në fushë dhe të shohësh se kush loz, ç'lodër luhet. Ke të drejtë! E ç'të shohësh kur lojtarët s'janë që të gjithë, kur ata më të zotët, studentët, mungojnë? Pastaj, pse koha ka faj? Ç'të bësh!»

Katër a pesë djem të vegjël bërtisnin pardje: «E hëngri Elbasani tre me zero. E fituam ne shamjonatin!» dhe kënga ushtonte përpara Parlamentit: «Do t'na jap porsi na dha, Hip, hip, hurra!» Dhe shyqyr që mbetën ata të venë dhe të bërtasin në fushë të paktën e t'u japin kurajë lojtarëve të shkretë që lodhen e vdesin për të nderuar Krye-

qytetin dhe qytetin e tyre. Po pa lere mos e nga për shpenzimet!

— Si venë punët, mor Stërmasi?

— Shyqyr, shyqyr, mblodhëm nja pesëmbëdhjetë franga për t'i dhënë skuadrës së ardhur. Ja, siç e shihni edhe ju, mor zotni, sporti përparon!! Praparon desha të thoshja. Bereqaversën se këtu ndodhet dhe xha Rexha i shkretë! Akoma i ka mbetur krimbi i sportit dhe vjen kurdoherë. Vjen për të parë ndeshjet. I prish dy lekët.

Dhe midis një turme kalamajsh që kishin hipur nga drasat, shquhej një plak i kuq që bërtiste; «Jepi Adem! Mbushja se na turpëruen, pasha Zotin».

Lodra mbaroi dhe djemt akoma këndonin përpara Parlamentit më me fuqi: «Do t'na jap porsi na dha, hip, hip, hurra! veç rrofshim vetëm na».

Por i trëmbi xha Poga që i ndoqi duke u bërtitur:

— Shporuni lanetër këtej, se lodra edhe s'ka mbaruar. Duhet dhe disa ditë akoma! Nuk e shihni që akoma s'kemi ikur këtej?

Dhe djemt ja pritën «Hip, hip, hurra, tre me zero në favor tonë! Ne e fituam! Ju e humbët!»

(«Vatra» — 15 prill 1936 — faqe 3)

KUR NDERON USHTARI

Merr drejtqendrimin dhe nderon. E sheh të verdhë, e sheh të gjallë. Qesh shumë rrallë. Flet tepër mengadalë, vetëm nderon tërë ditën.

— Pse s'del sot, or Sulçe, në pazar! Është e dielë. Eja, bre, mos shohim ndonjë jevgë ose të paktën Fajën e Dules e ta pyesim se ç'ka nga katundi.

— Kam ndalim kazerme, bre!

— E pse?

— Pse tash dy javë nuk e nderova një tetar. Harrova ose nuk e pashë, të them të drejtën. Më dënoi me burg e me ndalim në kazermë.

Dhe s'dolli fare. Ndërsa tjetri, që kurse doli nga kazerma e deri sa vajti në Bashki, për hera dorën e mbante në strehë të kapeles.

— Pse e mban atje dorën? — i briti një rreshter.

— Nderoj, zotni.

— Po mjaft deh! Ule dorën e mos e mba të ngjitur në ballë, se të dënoj!

— E mbaj, zotni oficer, se mbase harroj të nderoj ndonjë ose, Zoti mos e dhëntë, nuk shoh ndonjë nga ju, nuk e nderoj e pastaj? Se ne, kur dalim në qytet, nuk dalim t'ju shohim vetëm juve,

juve ju shohëm tërë ditën e tërë natën. Kemi hall mos shohim ndonjë tjetër surrat, prandaj më mirë ta mbaj dorën të ngjitur në strehë dhe pastaj ta kem mendjen të fjetur nga ju.

— Jo! Merr drejtqëndrimin, se fjalosesh me një superior këtu. Ç'janë këto maskarallëke, mor jahu. Akoma s'kini vënë mend!! Nuk e dini që ushtria ka disiplinë të madhe, ushtria po, ka disiplinë...

— Siurdhëron!

— Dhjetë ditë ndalim kazerme.

— Siurdhëron!

Iku ky. E gjeti shokun të shtrirë afër çezmës që lante gavetën me disa gjethe.

Shyqyr që çelën gjethet, se në dimër asgjë nuk gjen për të larë atë këllirë.

— Po pse erdhe shpejt? Ç'pate? A e pe Fajën e Dules? Ç'të tha? A na prure ndonjë «Kashar»?

— Po, po! Pashë reshterin. Më dënoi dhe mua, se e mbajta shumë dorën në strehë. Është bela. Kur nderon ushtari, asnjë s'ja vë veshin. Asnjë s'e nderon. Nga t'ja mbush, mor shok?

— Ë deh, ë! Ç'bëre mirë që u ktheve! Eja dhe inë ndihmo t'ja marrim pakëz për hatrin e asaj syzeze... Veç këput ca gjethe të njoma për të larë gavetën...

Kudo, në çdo vend të botës, kështu jeton ushtari.

Korçë, 20 prill

(«Vatra», 23 prill 1936 — f. 2)

ABUZIME DHE SKANDALE

Më parë, kur ngjante ndonjë vjedhje ose zënxe midis kryeplakut dhe mësonjësit, ose hoxhës dhe xhandarit, bota bërtiste: «Obobo! Ngjau një hata...» Thoshnin kështu, se mungonin fjalët shkencore. Ishte shumë i varfër fjalori. Ndërsa sot, kur vjedh ndonjë mehmur, nuk thonë «vodhi», por bëri «abuzime». Dhe kur nxjerr në parlament ndonjë deputet koburen, nuk thonë «ja bëri fora», por bëri «skandal». Këto dhe të tjera, janë fjalë që u importuan pa doganë mbasi na mungonin dhe nuk mund të shpreheshin kollaj veprimet tona. Prandaj sot kudo dëgjon: abuzime, skandale, skandale mbi skandale. Veç shumë herë në popull, ku nuk dihet mirë etimologjia e këtyre fjalëve të shkurta, bëhen gabime trashënikë aq sa në vend të «skandalëve» përdoren «abuzimet».

Duhet, pra, një dallim. Marrim pak raste.

Kur një kryeplak, tagrambledhës, ose nëpunës, bën shaka me të hollat e arkës dhe qesh duke i vënë këto në xhepin e mëngjert, atëhere mos thoni se vodhi. Jo! Se sot s'vjedh kollaj, po bëri abuzime.

Kur një kryetar komune taksat e celebrimeve harron t'i regjistrojë, bën abuzime. Dhe kur një

koleg i tij thotë: «kam tetë muaj pa marrë rrogë. Po shyqyr Zotit, lere që s'kam asnjë dhjetsh borxh, po kam dërguar në shtëpi brënda një viti, afro njëmijë franga. Kam bërë tri palë rroba. Kam bërë këtë, kam bërë atë. E po të marrë dhe rrogat, do të ngreh dhe një palë shtëpi mu mbi një bregore». E dëgjuat? Ç'ka bërë ky? Abuzime apo skandale? Kuptonie vet. Kur dëgjoni që një deputet brënda shumë vjetve s'ka folur asnjë fjalë në Parlament, ky s'ka bërë as abuzime në detyrë as skandale në fjalor. Vetëm s'ka abuzuar gjumin. Po kur një tjetër ka ngritur njëmijë herë dorën duke thirrur vetëm «po!» Atëhere ky ka abuzuar, se ankohet fjala e palindur «jo»!

Kur dëgjoni që një... shpërdoron mbi tabelat, pasaportat dhe nuk hidhet në gjyq, atëhere ky s'ka bërë asnjë abuzim.

Po kur dëgjoni se disa, si mehmurë biçimi, si në kohërat e vjetra, mbledhin natën nëpër dhoma vajza të bukura dhe të varfëra, me qëllim që t'i mësojnë me ushtrime fjalët abuzime dhe skandale, këto s'janë gjë tjetër veçse skandale mbi skandale. Dhe kur t'i këndojnë këto rreshta ata q'u ha koka, do të bërtasin me zëmërim, po hështur: «Këto maskarallëke të gazetarve janë me të vërtetë skandale».

(«Vatra», 28 prill 1936 — f. 2)

SI DO TË PRITEN DEPUTETËT.

Më falni dhe mos e merrni për ters, mor jahu... Se deputetët tanë s'priten kollaj... Fjalën e kam këtu se qysh tani bëhen përgatitje të mëdha kudo për të pritur «baballarët» triumfonjës, se e plotësuan mirë detyrën e tyre.

— Nga t'ja mbajmë? — I thosh pardje një deputet sivëllaut të afërm. — Them t'u bëj një telegram që të dalin dhe të më presin, se unë e di që ushqej një simpati të madhe në popullin bujar të qytetit tim.

— Po, po, e kam marrë vesh.. Unë mendoj se ku do ta shkoj verën, se që të vete në fshat, nuk guxoj, vallahi të them. Dikush më shkroi se janë bërë gati të më presin me saze e gërneta. Unë s'vete se e di që do të më futin në valle... Unë mezi lëviz dhe jo të kërcej. Dhe u mbetet hatri kur s'kërcen me ta. Atëhere thonë, «ky s'pranon» dhe hajde në vjeshtë t'u marrish ndonjë votë. Mehazalla se ta japin më. Se tani janë zgjuar dreqërit... Po s'të panë t'u bësh qejfin, he, he, të lanë fare... Prandaj do preferoj të shkoj jashtë dhe të mos piqem fare me asnjë... Se dije, që të çmohesh shumë, mos para eja në kontakt me ta, se të njohin. Se më duket na dolli kripa më, mor katran.

— Kam marrë vesh, — shtoi një tjetër, që kudo bëhen pritje të mëdha. Gjithë atdheu është në lëvizje.

— Mor mirë thua ti, — ja priti tjetri, — unë kam kohë që lloisem se ç'këmbë do të hedhin të fundit atë ditë të zezë që do të dalin për gjithmonë nga kjo vatra jonë e shenjtë. E vras mendjen, mor jahu...

— Jo, mor të vraftë. Për këtë lloisesh ti! Po të hedhish të djathtën. atëhere, mot ishallah, do të jesh i partisë së djathtë, e po të hedhish të mëngjërën, do të jesh i së mëngjërës.

— Ç'janë këto që më thua. Kalama jam unë, apo rezervist që të më bësh mua talim! Unë them që po të hedhish këmbën e djathtë do të të presin mirë mileti. E po të hedhish të mëngjërën do të të nxjerrin havaze. Këtë e kam kënduar në «Kujtimet e Nastradinit».

Ndërsa në Tiranë bëhen këto bisedime, ndër katunde dhe qytete pregatisin pritje të mëdha... Ndër disa vënde thonë se do të bëjnë «arco di trionfo» nga do të kalojnë baballarët e kombit, të cilët, në zgjedhjet e ardhëshme, do të emërohen jo gjyshërit, po stërgjyshërit e kombit.

(«Vatra», 30 prill 1936, f. 2)

UDHË E MBARË!

Ora e madhe qëllon din! dan! Automobilat me borit e tyre thërrasin: booo! booo! Një zhurmë e një potere mu në kryeqytet. E sidomos shquan zëri i shoferave: «Për Durrës, për Berat! Për Shkooödër, zotni deputet!» Dhe janë të kënaqur shumë, se këto ditë kanë punë. Largohen nga kryeqyteti «Stërgjyshërit e kombit».

— Udhë e mbarë! — U bërtet heshtur pallati i vogël i Parlamentit, ndërsa këtyre u tingëllon edhe në vesh melodia e ëmbël e orës së «Dhomës», e cila me tingujt e saj harmonikë, u shtonte gjumin.

— Udh' e mbarë! -- thërrasin shërbëtorët e Parlamentit me lot ndër sy, se kush e di në i pafshin më. Kanë të drejtë të qajnë, se kanë një varg vjetësh që hëngrën bashkë me ta bukë e kripë... Dhe prapë me fuqi bërtasin: «Udhë e mbarë, o bejlerë. Kini qënë shumë të urtë... Kaptofshi një mal me gjethe... Ishallan ardhçi pa ethe!...».

Automobili nisët — kambanat, zilet, orët, zërrat heshtin...

Vetëm një zë i hollë prishi qetësinë e shpirtit të deputetëve. U bërtet:

— Udhë e mbarë, udhë e mbarë. Veç mirrni

nga një qofte që ta hani rrugës, se jini ngopur të-rë vitin me simite... Mos bëni ekonomi deh! se mjaft i mbushët xhepat e shkretë. Mirrni, o mirrni dhe nga një qofte... të gjatë ose të rrumbullaktë. Si e doni?

PO TË BËHEM

Po ta sjell rasti dhe të bëhem diktator, do t'u kënaq që të gjithëve me qofte. Nuk mund të kemi vetëm simite të thata, se atëhere do të thoni që prandaj kërkohet diktatoria, të ketë parime simitiane. Jo, mor jahu! Nuk e lëmë vetëm kështu... Do t'ju japim dhe qofte. Kështu që plotësohet doktrina e tërë në dy parimet e ndryshme. Domethënë pajtohen dy palët dhe formojnë gjellën e plotësuar. Atëhere del në shesh diktatoria e ndritur. Po të mos besoni, bëni një provë... Blini një grosh simite dhe një grosh qofte dhe i hani... Për një çast do të bëheni diktator... i barkut, se aslla që të gjitha për barkun bëhen.

ME FRIKË TË MADHE

Ama! Me shumë frikë u prit prej të varfërve dita 1 Maj. Se kishin marrë vesh që bejlerët, tregëtarët e mëdhenj dhe mehmurët e majmë, kishin organizuar një demonstratë me shumë rëndësi kundra punëtorëve dhe hallexhinjve të këputur, me qëllim që të çlirohej pakëz kallamboqi, mielli dhe buka. Mirëpo këta kishin besim në gjindarmërinë, prandaj fjetën rehat. Në anë tjetër, fajdexhinjt s'i

kishte zënë gjumi fare dhe mendonin tërë natën
se ku do t'i fshihnin senetet, në rast se «proto Mai»
bënte ndonjë çudi...

(«Vatra», 3 maj 1936 — faqe 3)

NË KRUA... TË QYTETIT

Ndërsa në kronjt e fshatit, me gjithë varfëri-në, dashuria përvëlton zëmrat e parrahura prej kohës të vajzave ëndertare, dhe i bën që të flasin dhe të flasin me orë të tëra fjalë të ëmbëla afër ujit që burron si shpresat e tyre, në qytet, në çesmat e mëhallës, mbliidhen «kopilet», shërbëtoret e vogla, dhe, mengadalë, fjalosen për hallet e tyre.

— Sa të jep beu tynë, moj shoqe?

— S'më ka dhënë gjë akoma, moj qyqe. Veç më tha se do të më paguaj shumë mirë. Do të më japë një frënk në muaj dhe fustanet e vjetra të Lules, dhe këpucët e mëdha të tij, dhe kapellon e zezë të zonjës, dhe pallton e vogël të gjyshes. Kështu më tha. Po ty ç'të paguan? Ç'hylefe të jep beu yt?

Kjo e tha më mirë, Ç'hylefe të jep!» E keni dëgjuar ndonjë herë këtë frazë?... Dhe kujt i them unë i ziu. Sot, dje dhe nesër këdo që takon, në daç ministër ose ish-deputet ose drejtor, shërbëtor e «kopile», herën e parë do t'i thuash: «Si je!» Dhe pastaj: «Ç'hylefe ke?»

Mirëpo kjo s'foli. Se nxitohet mbasi beu i kish thënë të vinte shpejt në shtëpi se ai ishte vetëm.. dhe kishte punë.

— E pse nxitohesh, moj qyqe? Rri dhe pakëz sa të themi nja dy fjalë të zeza.

— Jo, jo, do shkoj se më pret në shtëpi. Është vetëm dhe do të bëjmë me të atë punë që të thashë dje. Oh sa më do mua «zoti im». Ç'thotë për mua! Veç fshehurazi nga zonja, se, me hazallah, po të dëgjojë fjalë ajo, e rreh. Dhe mua më ndjek. Kështu më thotë. Kur jemi vet do të bëjmë ç'të dojë «ai».

— Mirë, moj qyqe, dhe «ai» i imi kështu më thotë. Pastaj dje më tha dhe një sihariq. Do të më fejojë me një burrë që «ai» e ka njohur dhe do t'i japë një punë të mirë. Veç me kusht që, po s'u martua me mua, s'i jep asnjë punë. Ç'do të bëjë ai! Po s'më mori mua për grua, do të vuajë. Nuk do të ketë punë. Prandaj shpresoj se do të largohem ca kohë prej këtej... Mjaftë u ngopa me beun dhe me këtë krua.

— Eh, eh, dhe mua kështu më tha dje i imi. U, u sa mirë që janë «të zotët» tanë. Kërkojnë dhe të na martojnë deh! Dhe me çë pa! Me burra që do të bëhen «mehmura» dhe ne do të bëhemi zonjat e tyre... Sa mirë! Dhe prandaj na përdorin kështu moj qyqe, kur u ikën zonja. Helbete! Na mësojnë si të sillemi me burrat tanë. Që të na thonë ata nesër se ne s'dimë nga ato punëra.

— Unë shkoj, moj! Iki se më pret në shtëpi, më ka prurë ëmbëlsira si çdo darkë që dërgon zonjën gjetkë.

(«Vatra», 5 maj 1936 — f. 3)

SHTËPIA IME

Dhe kjo kurrë nuk më shkonte ndër mend! Ke parë ti? M'u mërzit shtëpia? Dhe kam një shtëpi të mirë, të qetë, të rrethuar me ullinj të mëdhenj. Përdhese, pa dysHEME dhe pa tavan. Mirëpo është e mirë, se është shtëpia ku kam lerë. E desha shumë. Dhe ajo më adhuronte. S'më bënte zëmra të largohesha prej saj. Dhe u madhova, u bëra burrë. Ajo vjetërohej dhe përdita po nxihej, derisa më në fund m'u duk gërmadhë e vjetëruar, brënda së cilës mbretëronte varfëria, mizerja dhe mundimi. Më dukej skëterrë e vërtetë... Dhe kush: kështu? Shtëpia ime, foleja ime, prehja ime, e vetmja pasuria ime.

Dhe ajo e kuptonte tmerin tim, prandaj, kur ndodhesha brënda saj, më dukej sikur pëshpërinte:

— Shporru këtej, se do të të zë brënda ndonjë ditë!

Dhe hodha torbën në krah dhe, duke i dhuruar për kujtim vetëm dy lotë, lotët e fundit, ika... Ku të shkoja? Ç'shtëpi tjetër më pranonte mua, përveç shtëpisë sime, kasolles sime?...

Një trumbetë e largme më tërhoqi. Ishin tingujt e heshtura të jetës që më drejtonin për në qytet. Dhe erdha këtu në kryeqytet. Shtëpira të më-

dha, pallate përrallore, rrugë të gjata dhe të gjëra. Salltanete! Parajsa e vërtetë! E humba toruan. Qeshja nga gëzimi, Kërceja se shpëtova nga gurët e mëdhenj të gërmadhës sime.

Por një natë e pësova. Dhe e pësova sa qava tërë natën. Qaja se ndodhesha në fshat. I shtrirë në një kënd të kasolles sime, dëgjoja klithmën e djemëve të mi që diçka kërkonin. Dëgjoja gruan time që më bërtiste duke qarë: «Pse më morre në qafë! Si do të vejë halli ynë!» Dëgjoja plakën që rrënkonte duke thënë: «Pse s'më merr, o vdekje!» Dëgjoja babën që më qërtonte: «Pse kështu, or bir!». Dëgjoja pulat, qenin, macen, dhe prapë, përmbi të gjitha, klithmën e fëmijve që më therte më tepër. Dhe nga dëshpërimi qaja.

Po kur hapa sytë, pashë se ndodhesha në një dhomë me mure të bardha. Pashë se isha shtrirë në një shtrat të butë. Isha në qytet. Sa mirë!

— Shyqyr o zot, — thashë me vete, — që s'ndodhem në shtëpinë time!

Ke parë ti? Dhe këtë s'e ëndëroja. Hoj! Të më duket vatra ime skëterrë... Çudi!

(«Vatra», 6 shtator 1936, f. 2)

KURSALI PA... BURRA!

Çdo gjë këtu tek ne kalon pa u vëzhguar. Çdo lëvizje, në daç mendore, në daç shoqërore, politike ose zëre si ta duash, ndjek gjurmat e heshtjes kë-shtu që asgjë s'merret vesh ç'bëhet. Dhe kjo vjen se ne nuk çajmë kokën fare se ç'ngjet jashtë vetes sonë. Kufizohemi në veprimet «individuale», duke mos dashur me asnjë mënyrë që të shohim pakëz më larg... Të gjitha rrjedhin e shkojnë në heshtje, siç shkon në heshtje dhe jeta jonë.

Të paktën nuk dëgjon as ndonjë bisedë që të ketë të bëjë drejt përsë drejti me shoqërinë tonë.

Veç një shok pardje më së fundi çeli gojën dhe siç ishte i dërsitur nga puna, më tha:

— Ore! As më thua, atje në «Kursal» çfarë njerëz rrinë?

— Ajo dihet. Ja janë që-të gjithë nëpunsa të shtetit, ja kandidatë për mehmurë.

— Vetëm ata? Nuk ka njerëz të tjerë?

— Jo deh! se atje po të mos jesh nëpunës nuk pranohesh..

— Eh, mirë, po, as më thua, çfarë bisedohet atje tërë ditën e ditës prej turmës mehmure? Unë i kam parë të heshtur, të kërrusur që rrethojnë tryezat e rrumbullakta dhe duket se nuk pëshpë-

risin fare. Mos nuk kanë ç'të thonë apo... Zoti na ruajtë, mos ka ndonjë taksë të rëndë bisedimi!

Dhe që të dy u nisëm për në «Kursal» për të parë e për të vëzhguar se ç'bëhet atje. Me të shkuar afër Bashkisë, shoku u ndal. Kish të drejtë të llahtarisej dhe të ngurrohej duke shikuar kopshtin e Kursalit të mbushur me... gra!

— Mor s'ka asnjë burrë, më duket. Mos gënjehem, mos më bëjnë sytë! Pa shiko mirë. Asnjë burrë nuk ka!

Gjithë tryezat të mbushura me femra shkëlqenin prej hijeshisë dhe vlonin prej bisedës. Që të shkonim dhe ne, kishim frikë se nuk dinim ç'kishte ngjarë. Mengadalë u avitëm në mur dhe duke thirrur «Stavro, Dhionis, Roza!» pamë që nuk na u arrua asnjë, se kishin mëndjen te gratë që shkriheshin gazit duke biseduar.

Deshëm s'deshëm u ulëm në një kënd të kopshtit. T'i shikoje se si kapardiseshin femrat lanete! Bërtisnin fort pa frikë, qeshnin dhe, të mbështetura nëpër fronet e burrave, çonin kryet përpjetë, duke lëshuar tymin e duhanit.

— Merre dre, merre këtë punë! Si ore të mos ketë asnjë burrë sonte këtu!

— Kush e di se ç'punojnë gratë. Dashtë dreqi dhe ngrihen nesër duke kërkuar me këmbëngulje të marrin kulltuqet. Dhe mund ta bëjnë, s'është çudi. Pa i shiko dhe i dëgjo se ç'bisedojnë! Gjithë punët e shtetit i ndreqën! Gjithë punët e shoqërisë i rregulluan!

Po na e preu bisedën Dhionisi që, me buzë të varrura, na pyeti.

— Ç'urdhëroni, zonjushë!

Shikua m njeri tjetrin në sy, pastaj me ngadalë hodhëm vështrimin nëpër pantallonat tona.

— Mos jemi femra? — i tha me fjalët nëpër dhëmbë Dhionisit shoku im që e kish humbur toruan.

— Nuk e di, — iu përgjegj ai — Veç këtu jini në Kursal.

U ngritëm dhe ikëm të heshtur, siç kalon dhe jeta jonë e heshtur, duke lënë femrat të bisedojnë.

(«Vatra» 10 shtator 1936 — f. 2)

PËRKTHIMET E REJA

Unë e them shqip dhe në mos e pres me sëpatën e dardharit, e them pa frikë se tek ne të gjitha janë përkthyer... S'mbeti gjë siç ishte! Dhe jeta e përkthyer dhe ne... po përkthehem. Çdo gjë u ndryshua. S'mbeti gjë origjinale. Vetëm toka, vetëm trualli s'përkthehet dot. Se është i rëndë, është i shtrënjtë.

Libra, fletore, të përkohëshme: të gjitha të përkthyer. E po ligjet?! Asgjë s'u përkthye nga jeta e vërtetë e popullit, se gjuha e saj është e zorshme dhe asnjë prej nesh s'e merr vesh. Prandaj përkthejmë çdo gjë nga të huajtë...

Përkthen njeri romanca... dashurie, nuk i shiten! Bërtet i lodhur nga puna:

« Kështu nuk vete dot përpara. Asnjë s'i blen, se nuk i kuptojnë... Do të përkthej më mirë romanca policore. Ato shkojnë! Tani e mora vesh! — thërret tjetri me zëmërim:

— Më plasën sytë duke përkthyer «Njerëzit në... Dasmë!» Asnjë s'e këndon. He! Tani do të përkthej librat e shenjta. E si! Ato shkojnë?

Hiçgjë s'mbeti e jona. Të gjitha të përkthyer. Po s'mjaftuan librat! S'mjaftuan shkrimtarët, ligjet dhe kanunet... Tani u ka hipur një mani gj-

thë shqiptarëve që të jenë burra e gra përkthenjës.

Vajzat, që tërë verës pritnin me dhëmshuri rrezet e diellit nëpër plazhe, më së fundi, duke mos patur se ç'të bëjnë, përkthyen dhe... fytyrat e tyre. U bënë brune! Tamam spanjolle. po veç nga lëkura.

Dhe të rinjtë që s'kishin lënë gjë pa përkthyer, më së fundi, duke pënë se mbetën keq, shkuan dhe shkojnë tek rrobaqepësit dhe përkthejnë petkat e tyre të vjetëruara.

— Në ç'gjuhë janë shkruar këto tesha? — bërtet rrobaqepsi.

— I kam bërë në Paris! — thotë njeri.

— Të miat i kam qepur në Athinë kur isha student, — thotë tjetri.

— Mirë, mirë! — përsërit duke qeshur rrobaqepësi — Po as më thoni, në ç'dialekt i doni? Toskërisht apo...

— Në atë të gjashtë frangave!...

Dhe mbasi s'po mbetet gjë origjinale, pritet tani të përkthehet dhe «Shkolla e pleqve» afër Shallvares në «Akademi Rinie».

Të shohim!

(«Vatra», 15 shtator 1936, f. 3)

STREHA VARFËNORE

Nuk i kuni parë kurrë, besoj, nja njëqindëpesëdhjetë fëmijë që hera herës lëvrijnë andej nga njera anë e bulevardit të madh. Dhe jo se nuk kuni dashur t'i vëzhgoni, po është rruga e tillë, që kalonjësve të saj u heqin vrejten gjëra më tërheqëse...

Dhe kush do të kthejë sytë të shohë një turmë kalamajsh, kur përpara tij ka «cinema Glorian» ka shtëpinë e madhe të oficerëve, ka pallate pëllumbeshash, e tjera. Unë, tërë kohën që shkoj andej, i shoh që bredhërijnë, që lozin, që bërtasin. Mirëpo poterja e tyre humbet në zhurmën e madhe të asaj rruge.

Ata janë që të gjithë të varfër, mbetur jetimë. Gjetën «strehën» e tyre, shpëtimin e tyre, Hanë, pinë, flenë dhe rriten... Po si rriten? Si edukohen djemt e vatrave gati të shuara? Njeriu s'mund të thellohet dhe aq shumë, sa të hyjë dhe brënda mureve të tri ndërtesave të Kryqit të Kuq as edhe në klasën e mësimit të tyre, por po të vëzhgojë jetën e jashtme të tyre, do të thotë pa tjetër se fëmijë të vobegte madhohen midis zhurmës endëronjëse! Shikoni kur kaloni andej poshtë: nën hijen e një peme të madhe janë ulur «konviktorët e mje-

ruar». Shohin me kureshtje turmat e bukura që tërë ditën përshkojnë duke qeshur bulevardit. Dëgjojnë muzikë, muzikë, muzikë nga tërë anët. Dhe këta, të entuziazmuar, qeshin, bërtasin, lozin thërrasin: «Rroftë jeta!»

Dhe jo vetëm që tërë ditën s'ngopen duke adhuruar njerëzit e «lumtur», po edhe natën nuk qetësohen. Nxjerrin kryet e tyre të vegjël, po të mbushur me shpresa, dhe shikojnë kundruall «Botën» shumë «të lumtur», ku vlon gazi dhe muzika... Dhe i zë gjumi të nanuritur prej muzikës, prej gazit dhe lumturisë. Flenë dhe tërë natën ëndërat i shtojnë dhe, kush e di, mund që nxitohen të rriten dhe të dalin përnjëherësh në rrugët e jetës të shtruara me lumturi.

Unë shkoj çdo mbrëmje andej. Vëzhgoj me dhëmbje disa kokë të vogla që heshtin. Flenë të lumtura. Dergjen në djepin e rritjes ëndërtare. Është bota feminare e varfërisë që u hodh përnjëherësh në pellgun e fatbardhësisë. Është bota e gjeneratës së re plot shpresa që rritet midis këngëve dhe muzikave. Fle në njerën anë të bulevardit të madh një turmë e vogël prej njëqindpesëdhjetë vetave, dhe ç'kujtoj unë, duke shkuar andej pa? Ah, se ç'kujtoj!.. Kujtoj se edhe unë dikur flija kështu i lumtur plot ëndëra dhe shpresa... Po tani?

Tani lëre mos e nga! Tani, i futur thellë dallgëve të jetës, më pëlqen që të shkoj darkë për darkë nën dritare të asaj bote të lumtur, vetëm e vetëm që të kujtoj për një çast të vogël atë jetë... Dhe pastaj? Pastaj le të më rrëmbejë prapë dallga e Bulevardit të madh.

(«Vatra», 24 shtator 1936, f. 2)

URDHËRI I DITËS

— Ç'kemi sot?

— Hiç gjë? Rehatllëk!...

Këto janë fjalët që përsëriten çdo ditë. Dhe midis këtyre shtohet dhe fraza e modës: «Qesatllëk i madh. Krizë e tmershme».

— Ndonjë lajm? Kush u transferua? A ka më emrime?

Dhe mengadalë rrjedhin bisedimet e zakonshme midis atyre që nuk përtojnë dhe të flasin. Se ta themi pa frikë, shumica jonë sot ka zamet dhe të flasë?. Dhe ka të drejtë, se kur fle trupi, doemos fle dhe mendja. Pastaj ç'të thotë njeriu ditë për ditë! Është bela e madhe të lodhesh kot duke numëruar fjalë, që tingëllojnë keq në veshët e zëna të atyre që ke pranë. I flet tjetrit, i thua ndonjë të re (doemos ndonjë hall) të tund kokën dhe kush e di se ku i fluturon mendja. E njeh përnjëherësh që ai s'është në vete nga të qeshurat e zorshme që lëshon për të treguar se gjoja dëgjon. Po ku ndien ai, mor vëlla! Është ngopur me bisedat e përditshme, prandaj nuk dëgjon më. Është mërzitur se nuk tërhiqet më vrejti e tij me llafe. Kërkon ndonjë të re, ndonjë lajm... Ç'bëhet në botë, ç'bëhet në dvnja... Dhe e dëgjon me t'u takuar:

— Ç'kemi? Ndonjë të re?

Dhe ti, duke mos dashur, flet:

— Mirëpo, ç'kemi sot?

Pastaj, duke shikuar gjatë që të dy, lëshoni fjalën e rëndë:

— Hiçgjë! Rehatllëk! Qesatllëk!..

Këto janë fjalët e zakonëshme që të detyrojnë të heshtish. Dhe kanë bërë shumë mirë disa që heshtin. Dhe unë vendosa të hesht, të mos flas kurrë, veç të bëj me shenja nga një herë.

Mirëpo, çdo mengjes që vizitoj shokun tim në dhomë, ai porsa zgjohet, më bërtet:

— Eh, ç'kemi sot?

Unë ngreh duart përpjetë duke lëvizur vetullat. Dhe ai lëkund kokën, duke përsëritur me ironi fjalët; «Rehatllëk dhe sot?» Dhe rimë duke kënduar gazetën. Shikojmë anëj këndeje mos gjejmë ndonjë lajm me rëndësi, ndonjë temë, ndonjë artikull që ta bisedojmë, ta rrahim, ta shoshitim... të flasim... S'gjejmë gjë tërheqëse... Të gjitha të njëlojshme. Të gjitha të përsëritura. Ndonjë emërim, ndonjë internim, ndonjë... gremisje.. hiç gjë tjetër.. Është urdhëri i ditës sonë. Është ritmi i jetës sonë, është heshtja që mbretëron. Unë i qetë, ngrihem, e shikoj shokun në sy, më shikon.

Dhe dal i heshtur.

— Ku shkon? — më thotë.

— Nuk e di!

— Ç'do bësh sot?

— Hiçgjë! Ja, do të rrokullisem në kalimin e ditëve. Me pahir i ndjej gjurmat e së djeshmes. Ç'të bëj? Është urdhëri i ditës.

— Mirë, mirë! Shko! Veç mos folë më tepër, se më mërzite, — tha shoku duke gjurmuar nëpër fletore mos gjente ndonjë të re...

(«Vatra», 22 shtator 1936 — f. 2)

KËNGA E DIKTATURËS

Megjithëse kishte kaluar mezi i natës, kënga labërishte ushtonte në një kafe, që s'dua t'i them emrin se, me hazallah, do ta bastisin.

Borshi, Kuçi e Progonati (!)
Po na shpallin Diktaturë.
Mirë po Timo Dilua ç'pati
Që e bëri tevaturë...

— Ore Selo! Ç'domethënë Diktaturë? Aman, të keqen, thuamë ndonjë fjalë, se gazetat duket se e dinë vetë atë fjalë dhe s'kanë ndër mend fare të

Nga Borshi ishte Nebil Çika, nga Progonati ishte Ismet Toto dhe nga Kuçi ishte Ali Kuçi, e të tjerë. Këta dhe disa fashistë dhe nazistë, shkruanin për ditë për një «Diktaturë të Ndritur» (!) Kopjonin copa nga MAIN KAMPF i Hitlerit ose nga artikujt e Musolinit dhe predikonin një diktaturë në Shqipëri. Domethënë, një diktaturë më të përsosur se diktaturën halldupe të Zogollit, Krosit, Jukës e të tjerë... Për t'u tallur me këto «predikime», zgjodhën si «ideolog» një njeri si M.E. Libohovën që tallej me të gjithë. Për këta predikonjës të një diktature fashiste, ne nuk mund të përgjigjeshim drejtpërsëdrejti, **përveç me tallje dhe përbuzje...**
(P.M.)

na e shpiegojnë. Pa thuama ti, se merr vesh shumë nga këto.

Fliste dhe hopa nga një gotë raki.

— E ç'më thua, o lumë! Diktaturë kërkon ti prej meje? Pa pyet pakëz gotën tënde! Ajo e di mirë... Por që të mos më marrësh fare për budalla, do të them se ç'kuptoj unë për diktaturë. Do të jetë ndonjë fjalë që mungon nga fjalori ynë, siç thonë glosologët dhe kërkohet me këmbëngulje të importohet nga ndonjë leksik i madh i perëndimit.

Dhe hopa gotën tjetër. «Meze, meze se na përveloi uji i tërbuar. Qënka bërë dhe rakija diktaturë!»

— More, i tha më i shkuari kafexhiut, — nuk është e ndaluar që të fjalosemi për të tilla gjëra këtu në mes të natës? Shikoni mos pësojmë ndonjë gjë, se më duket merremi me politikë?

— Jo, jo. Këtu pijetorja ime është liberale sado që rakija e shkretë përpiqet të vendosë diktatorinë e ndritur.

Atëhere kënga u ndez: «... Mirëpo Timo Dilua ç'pati që e bëri tavaturë...

Biseda u ashpërua, se kërkonin me zëmërim që të gjithë prej kafexhiut që t'u spiegonte se ç'domethënë diktaturë. «Ja na e mbush kokën, ja s'të paguajmë asnjë dhjetsh».

E qau gërmadha të shkretin kafexhi. S'fliste dot se këta do ta rrihnin. Dëshën me doemos t'u shpiegonte se ç'djall qënka ajo diktatori që duan ta vendosin me pahir.

— E deh! Folna ti që je më i zgjuar dhe më kompetent. Ose do të na e mbushish këtë të thatë, ose do të ta mbushim ne.

Dhe kafexhiu e hapi gojën:

— Ja, mor zotni... Unë këtu në kafe kam vendosur diktatorinë e ndritur ndër të gjitha sendet. Ndër gotat, shishet, fronat, tavolinat, lugët, pirujt dhe pjatat. Domethënë unë atyre u bëj ç'të dua dhe s'më kundërshtojnë dot. Më muarrtë vesh? E kuptuat se ku e kam fjalën?

Këta heshtën, heshtën, pastaj, të zëmëruar, bërtitën.

— Pse, dhe neve na përdorke si gota të rakisë këtu, ti a?

— Jo, mor zotni! Ju jeni njerëz. Unë s'mundem t'ju trazoj as t'ju besdis. Ju më urdhëroni t'ju shërbej. Peqe! Dhe unë ju detyroj të më paguanin hesapin!

— Peqe! Peqe! Po do t'ja themi dhe njëherë. me gjithë që është mezi i natës:

— More bëni ç'të doni. se unë jam liberal, s'jam diktatorial...

«Borshi Kuçi e Progonati,
Po na shpallin Diktaturë.
Mirëpo Timo Dilua ç'pati
Që e bëri tevaturë!»

(«Vatra», 17 maj 1936 — faqe 2)

**DIKTATURA E NDRITUR SHPIEGOHET
NË PIKPAMJE SHKENCORE
PREJ MAZAR LIBHOVËS**

Ziente kafe Kristali prej zërit të hollë të Mazharit. Dikush i fliste për «Vatrën» dhe i kërkonte shpiegime gojarisht mbi sa deklaroi në *definisionin* që i dha diktaturës së ndritur.

— Shkoni, more jahu, te Nebil Çika të t'jua shpiegojë mirë, pse më bini në qafë mua të gjorit? — u thoshte dy djemvet të ri që e kishin ndaluar në të hyrë të kafenesë.

Zonjusha që po dilte jashtë i tha se dikush e kërkonte andej nga fundi dhe Mazari u drejtua nga një tryezë ku qëndronin pesë veta, miq të ngushtë të Mazarit.

— Morpo u bëre i famshëm, — i tha një nëpunës, dhe gjithë të tjerët shikonin me kureshtje se çdo të nxirrte nga goja Mazari. i cili, me një gjest familjariteti, ulet në karige dhe fillon muhabetin shtruar.

Rasi i vogël kish qëndruar mbi bufet dhe duke zbardhur dhëmbët, shikonte Mazarin që fërkonte duart — gjest i zakonshëm kur do të fillojë ndonjë shpiegim ose sqarim mbi politikën ndërkombëtare.

— Ç'mendoni mbi diktaturën në pikpamje

shkencore stratosferike? — i thashë dhe Mazari, mbasi u mendua një minutë, m'u përgjegj.

— Jua shpiegova një herë, po çuditem se sa kokëtrashë qënkeni që s'e paskeni kuptuar akoma. Mua më thanë se në gjithë qarket ndërkombëtare është pritur mirë definicioni mbi diktaturën dhe ministrat e jashtëm do të më dërgojnë falnderime! — tha Mazari me një seriozitet që të inspironte respekt.

— Këtë radhë, — i thashë, — «Vatra» dëshiron të ketë nga ty një mendim në pikpamje shkencore, se personeli i gazetës sonë u rrëfye i pazoti t'ja mbushi mendjen Nebilit shkencërisht mbi diktatorinë e ndritur. A do të kesh mirësinë, pra, të na e bësh këtë të mirë?

— Me gjithë gëzim dhe kryenaltësi, dhe pa e merr kalemin në dorë, shkruaj dhe të lutem, mos ndrysho asnjë presë, se këto gjëra kanë rëndësi të madhe. megjithëse diktatorialët e «Arbënisë» nuk e kanë kuptuar.

Këto tha Mazari dhe duke vënë duart rreth kokës, filloi:

— Diktatura e ndritur, në pikpamje shkencore-stratosferike, ka për qëllim që fuqia e përbashkët e cilitdo shtet të arrijë në shkallën e lartë në patriotizëm, kulturë e fizike. Kjo nëqoftëse diktatori i saj nuk do të marrë parasysh se ligji duhet të jetë më i fortë se ai dhe sigurimi financiar i palekmënisë të mjaftoie për realizimin dhe përballimin e kriterit që i kërcënohet popullit, dhe kjo, nëqoftëse do të arrihet me çdo mënyrë, ahëre diktatori do të rrijë nën hijen e kanunit dhe të bilancit ekonomik e cila nuk do të lejojë që të luhen intriga të çfardolloyit.

Kështu diktatori me fuqinë e ligjit dhe lirinë më të plotë, do të plotësojë misionin e shenjtë, duke mos marrë parasysh intrigat që denoncojnë në fatin e atij populli, por jo nën sundim e tij personal, por me fuqi e liri të plotë diktatoriale në 3/4 e misave të kuvendit kushtetones duhet të kenë këto parime:

a) të jenë nacionalistë të zjarrtë me shkollë, të paktën një gjysmë idadije (fillore) të jenë në moshën 35 vjeç, të mos jenë përlyer me asnjë njo llë të familjes dhe gjeneralitetit të tyre, kur se kusuri duhet të jetë nga elita aristokrate, sepse te cilido shtet do të ketë çdo person që mund të ekzistojë pak a shumë nga elita.

Mazari e ndalon bisedimin dhe merr në dorë kafënë që i solli garsoni, surbit nja dy herë dhe fillon:

«Sado që merret çdo masë represive, nuk është e mundur të ndalohet elita e zgjedhur në çdo shtet kombëtar. Prandaj fuqia diktatoriale e çantallive do ta kryejë misionin e saj në parimet e këtij definicioni, nëqoftëse i tërë populli u bjen nas diktatorialëve brënda dhe jashtë qytetit me flamurin e lirisë, pse fuqia diktatoriale i shërben për mbrojtje çdo kombi katundar e malësor dhe do t'i shërbejë lumturisë së palakmënisë kombëtare me disiplinën e fortë dhe moralin e fortë. Kur diktatori do të ketë fituar shpirtin e popullit, ahëre do të ketë lumturinë e varfërisë së përjetshme dhe shteti mbas mënyrës së pavarësisë konstituente diktatoriale, se vetëm me një diktator dinamik nuk fitohet shpirti i popullit, mbasi kanë marrë frikë nga Neroni e Atila.

Diktatorxhiu Mas'hari

(«Vatra», 31 maj 1936 — f. 2)

KËTU APO ATJE?

— Një zë i pandarë e mundon:

— Eja, lumëmadhë, këtu. Eh, ku je? Tani nisi fyelli i përmallshëm kudo. Çeli një jetë e re. Ndihet kënga e vjetër që deh çdo të lënë në mëshirën e fatit...

Eja këtu të shtrihesh i lirë nëpër lëndina. Të flësh i lirë mbi ndonjë gur të thepisur. Të brezhësh i lirë poshtë e përpjetë. Të jesh si një flutur e gjallë dhe e lirë që vërtitet gjethe mbi gjethe. Eja këtu ku linde, ku ke nder e prehje. Ku ke lumturi. Ku s'ke kufi, ku je i lirë! Eja, as eja, se të pret një vënd që të njeh. Vëndi që të rriti. Që të dha sisë me burimet e kulluara dhe me lakrat e egra. Eja të tretesh këtu. në këto vënde që të lehtësojnë dhe që bëjnë të fluturosh orë e çast i lirë në të katër anët e dheut tënd lindor...

Po në anë tjetër një zë i ngjirur dhe i rëndë i murmuriste:

— Eh! Për ku bëhesh gati? Për në varrin tënd? Rri këtu se këtu ka jetë, ka fitime, ka shpresa, ka përpjekje dhe mundime, gjallëri dhe hov për një të nesërme të ndritur. Rri këtu dhe shtroju me pahirë urdhërit tim. Atje ka mjerim! Këtu ka lumturi! Atje rron si qenie e lirë, po pa kuptim,

ndërsa këtu je Njeri. Je i vlefshëm për vete dhe për vëllezërit e tu të atjeshëm. Mos u gabo, mos u merr më qafë. Qëndro këtu se je i lumtur!...

Dhe tani ky, cilin zë të dëgjojë? Atë të fshatit, apo këtë të qytetit? Kush e tërheq me bindje?

— Le ta mendojë vetë!

(Gazeta «SHTYPI», nr. 2, dt. 22 Prill 1937).

Asokohe, kishte një papunësi të madhe. Kriza e bukës mundonte popullin. Shumë fshatarë iknin dhe zbrisnin në qytet për punë. Sorollateshin poshtë e lartë të uritur. Në këtë legjon të uriturish që vërtiteshin pa drejtim e pa shpresë, shtypja dhe korrupcioni bënin punën e tyre. Andaj, ne mendonim që fshatarët e mjerë të mos mërgoënin nga fshati, se do ta pësonin më keq. Nga mizerja materiale do të binin dhe në mizerjen morale... (P.M.)

EJA NË VETE!

— Ti!

— Pse shkruan vargje? Të duket kollaj të radhitësh fjalë njerën pas tjetrës? Ja, u mundove dhe i vure radhë e radhë, si ushtarë të disiplinuar! Dhe me këtë kujton ti se bërë poezi?

— Ke të drejtë, se ke parë njerin dhe tjetrin — shumë qindra të rinj — që mbushin fletët me vargje. Dhe ti thua:

«Sa pare vlen një poezi?»

— Hiç gjë! Radhit ca fjalë me *-uar*, ca me *im*, ca me *-hor* dhe ke për të parë se doli një poezi! Me të shpejtë dërgoje për botim dhe për pak ditë do ta shohësh të mbititulluar «Poetët e Rinj».

— Pastaj ti!...

— Kush të mban më! U bërë anëtar i batalionit të «poetëve» pa paguar as edhe një taksë.

— Je poet.

— Dhe qofshë me shëndet!

— Po ti ç'e do shëndetin! Do famë, do nderime, do... eh, ç'nuk do ti! Do kurora, do çmime, do adhurim...

— Merr, merr ç'të duash, se je poet.

— E pastaj?

— Pastaj, kushedi se kur, po shpejt a vonë, do

të rrokullisesh poshtë, shumë poshtë, picingul dhe atëherë ke për të parë se sa ulët gjëndesh dhe se sa vlerë ke.

— Po sot, pse ty nuk të pëlqen të kuptosh se s'vlen asnjë qindarkë lëkura poetike jote?

— Sepse sheh kopenë e poetëve të tjerë, të cilët dalin si këpurdha dhe që me tërbim përpiqen t'i hypin Parnasit?

— Sa janë nisur për atje dhe asnjë pothua nuk ka mundur të marrë erën e lirë dhe të merituar të asaj maje ku, përveç frymës, mendjes dhe punës, kërkohen cilësira të rralla njerëzore... Jo të jesh ti i ulët, shumë i ulët nga shpirti, nga zëmra dhe me pahirë kërkon të lartësohesh!...

— Rri në punën tënde, mor i uruar. Leri mënjane vargjet. Eja në vetel dhe në dëshiron të bësi diçka me vlerë, herën e parë shih, vëzhgo me dhëmbje, puno pa kursim dhe pastaj, merr penën dhe shkruaj ç'të mundesh.

— Tani mos dëgjo lajkat e njerit dhe të tjetrit. Ata të gënjejnë pa dashur se kurrë nuk janë mësuar të thonë të vërtetën.

Po, të Vërtetën e shkretël!...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 3, dt. 24 Prill 1937).

N E S Ë R . . .

— Nesër do të bëhem qytetar! Petkat i porosita. Kapellën e bleva, këpucët sot i marr. Kravatën mësova ta lidh bukur. Këmishë, çorape, bëhem gati të dalë në treg e t'i blej. Dhe nesër unë jam qytetar!...

— Do të thoni ju, se si do stërvitem të sillem si qytetarët! Shumë kollaj. Do të bëj ç'bëjnë të tjerët: nderò, ulu, ngrihu. Folë fjalë të mëdha, shumë të mëdha dhe të gjata sa tërkuza. Ditë për ditë te berberi, te llustrua, në kinema. Mbrëmjeve një shetitje të vogël. Të blej ndonjë gazetë të huaj dhe megjithëqë s'di as shqip të këndoje e të shkruaj, s'ka gjë! Mjafton të mbaj në dorë ndonjë fletore të huaj si qytetarët, për bukuri... Kur të më thonë ndonjë fjalë që s'e marr vesh, të bëhem i shurdhër. Kur të më tregojnë ndonjë send që s'e di, të bëhem qorr. Të bëj një lutje të mirë, të qendrisur, dhe ta shtyj me anën e ndonjë fuqie të shëndoshë në ndonjë zyrë, duke shkruar: «Û bëra qytetar, prandaj dua një nëpunësi të mirë...» Dhë pastaj, kështu i kapardisur, të nisem për në ndonjë krahinë. Dhe atje, si qytetar i ndritur që do të jem, do të përpiqem me mish e me shpirt t'u shpie dritë katundarëve që kanë mbetur prapa. T'u tre-

goj rrugën e qytetërimit. Kanë nevojë për mua dhe për shokët e mi.

— Nesër jam qytetar. Nesër i hedh poshtë, i djeg këto petkat e vjetëruara.

— Nesër bëhem njeri! Nesër shpëtoj...

Dhe unë pas 'tij le të shtoj:

— Që nesër ti fillon të bëhesh parazit.

— Merre o dreq, merre, këtë punën tonë!

(Gazeta «SHTYPI», nr. 4, dt. 26 Prill 1937).

JAVA E ZEZE

Këto ditë dielli shkëlqeu më tepër. Bie me ëmbëlsi në gjelbërimet e njoma. Puth përmallshëm jetën e re që lindi nga lufta e humbur e Dimrit.

Shpirti — në daç me pahirë — çel i rilindur.

Një frymë e re, një erë e re kundërmon. Dhe më i vdekuri ngjallet, merr veten, buzëqesh. Dhe sado që një shprehje gëzimi humbet përnjëherësh si perëndimi i kuqëruar i diellit, prapë tërësia e gjallërisë rrëmbehet nga vala e prandverës: nga shpresa!

Të gjitha u çelën. Dhe nata s'ka më errësirë. Kudo zbardhëllon një dritë jetëdhënëse.

Vetëm, ah, vetëm «Shpëtimtari i Njerëzisë», i kryqëzuar me gozha gjakatare në zëmër, nga pikon gjaku theror i tërë gjeneratave, i lutet t'etit Fuqplotë që të falij mëkatat e mëkatarëve..

Dhe gjyshja, e gjunjëzuar para ati kryqi, para atij trupi të coptuar, me lotë ndër sy, murmuris:

— Shpëtoje, o Zot, Birin tënd!

— Çliroju vetë, o Shpëtimtar! Mos u mundo më për neve gjynahqarët.

Por peronat janë ngulur thellë. Krishti i Kryqëzuar nuk lëviz.

Dhe gjyshja qan.

Lotët e saj rrukullisen rrëke. Sytë i janë lodhur. Dhe çdo gjë i duket e zezë. Nuk ha, nuk flet, nuk qesh. Nuk zëmërohet, nuk kursen gjë as për të varfërit që i trokasin derën, as për fëmijtë e shtëpisë që, porsa kthehen nga shkolla, thyejnë dollape e qilare. Asaj jeta i duket e nxirë. Rrëmeti për 'të, vajton të Madhin Theror. Qielli i mbuluar, dheu i veshur me të zi, kudo një vajtim prekës oshëtin nën hijen e atij kryqi që qëndron i patundur njëzet shekuj me radhë dhe toka është çarë nga dhëmbja e madhe e Shpirtit hyjnor që i tregoi Njerëzisë se Theroria sjell *Shpëtim...*

Kambanat e lidhura me litare, nuk tingëllojnë më. Vetëm lotët e fundit të gjyshes pikojnë dallgalë në dheun e rëndë ku — ah — u hap varri i saj. Se perëndoi Jeta për 'të.

Dhe qan, duarlidhur, kokëulur e gjunjëprerë.

Dita i duket shëkull. Dhe loti i fundit i duket lumë që e rrëmben, pëllg që e mbyt.

Është java e madhe! Java e Zezë. Gjysesh i kujtohet e shkuara dhe përpara i del si mur jeta e ardhëshme: vdekja.

Java e Zezë! Dhe ndërsa gjyshja mundohet të ngrihet së gjunjëzuari, nipi i saj, me këngë e brohori, sillat vërdallë dhe pret me padurim *Ngjalljen*: Pret me shpresa një *Jetë të Re...*

(Gazeta «SHTYPI», nr. 5, dt. 28 Prill 1937).

GRINDJE

Që të dy të mënçur. Që të dy të urtë e të matur. Kanë kohë që bisedojnë mbi të mirat dhe të këqijat e qytetit dhe të fshatit.

— Kush rron më mirë?

— Kush ka më tepër rëndësi?

— Kush ka më tepër detyra dhe të drejta?

— A mundet katundari të zbresë në qytet dhe të bëhet qytetar!

— A mundet qytetari të lozë me fatin e katundarit?

— Si mund të bëhet fshati më i ëmbël?

— Si mund të rritet gjëndja e ulët e katundarit?

— Pse e tërheq më tepër qyteti fsahtarin e këputur?

— A janë në gjëndje qytetarët të ndriçojnë katundarët?

— Cila është baza e Shtetit, — katundi apo qyteti?

— Kujt duhet t'i jepet më tepër rëndësi?

— Kush është i ngarkuar, kujt i përket, kush mund të verë turmat e vdekura në lëvizje për drejtime përparimtare?

— Vetëm qytetari të zhvillohet dhe pastaj katundari?

— Kush është burimi i pashterur i çdo pasurie, themeli i çdo zhvillimi?

— A duhet luftuar urbanizmi?...

Dhe, më së fundi, hem qytetari, hem katundari, nuk i dhanë asnjë përfundim bisedës së tyre. Akoma po bisedojnë. Puna ka marrë një erë grindëse...

Ti, këndonjës, a je në gjëndje t'u përgjigjesh këtyre pyetjeve të tyre, ose pjesërisht?

Nëse ti merr mundimin dhe e vret pakëz kokën për problemin katundi dhe qyteti, dërgona pikëpamjet e tua, të cilat do t'i botojmë me kënaqësi në këtë shtyllë, të shoqëruara dhe me kritikë tona.

(Gazeta «SHTYPI», nr. 5, dt. 28 Prill 1937).

NJË PËRGJIGJE

— Në gjakun tim diçka lëvon. Në zëmrën time diçka djeg. Në shpirtin tim diçka përvëlon: jam gjaknxehëtë, se jam rritur me misër që ka shumë shpërto. Jam i verbër, se me shekuj më ka munguar drita. Jam vuv, se nuk jam mësuar kurrë të flasë. Jam pa vlerë, se as unë nuk çmoj gjë. Jam i humbur, se s'di ku gjëndem. Nuk di se ç'thonë të tjerët. Nuk marr vesh gjë. Nuk dëgjoj. Nuk marr pjesë në jetë.

Dhe juve quajeni si të doni qënien time. Në daç të vdekur dhe të pakallur! Në daç të gjallë, në daç të marrë...

Megjithatë jam gjaknxehëtë. Kur më shkrepet, s'di se ç'bëj. Asgjë s'marr parasysht.

Nuk dua të dëgjoj njeri. Nuk më bind askush. Nuk dua të di se ç'bëhet.

E shikoj botën, jetën, siç më pëlqen mua: të lumtur? Të humbur? Si?

Ja, kështu siç jam unë, është dhe tërë bota. Ai që më kundërshton, s'është në vetë.

Jam unë i errët? Je ti i ndriçuar? S'vlen asnjë pare para meje! S'je gjë. Hiç gjë! Një zero me xhufka. Dhe kërkon të më përgjigjesh mua! Të më thuash pallavra për jetën e tjetrit!

E ku di ti, o lumëmadh, se ç'bëhet përjashta

teje! E ku di ti si rrokulliset bota! Dhe pastaj merr guximin të shesish mëndje! Po kujt?

Mua?

Mua që s'pranoj asnjë mendim, asnjë gjykim që nuk pajtohet me gjakun, me zëmrën, me shpirtin tim.

Je i zoti të më thuash gjithnjë «peqe»? Je i zoti të flasësh, të shkruash gjithnjë ç'më pëlqen mua? Atëhere ke vlerë, je i mirë.

Ndryshe s'je gjë. Je i dëmshëm. Je gënjeshtar Dhe meriton të zhdukesh nga faqja e dheut...

— Mirë ky që më foli kështu! Po unë ç't'i them? Ç't'i përgjigjem?...

T'i flas shumë, e di që s'më merr vesh! T'i them të drejtën, ai prapë do të më thotë «gënjeshtar».

— E ç't'i them?

Ja një përgjigje shumë e shkurtër:

— Ti, mor vëlla, me këto fjalë që më thua, me të vërtetë qënke shqiptar!...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 6, dt. 29 Prill 1937).

DJE...

Dje një katundar ndodhej në kryeqytet.

Dhe nuk dinte gjë nga Tirana, se erdhi par-
mbrëmë natën nga fshati.

Ishte hera e parë që zbriste.

Dhe dje e humbi toruan.

Nuk mjaftoi kallaballëku i madh, që shtyhej
andej-këtej, i grumbulluar nëpër rrugë.

Nuk mjaftoi zhurma e automobilave, zëri i
njerëzve, kënga e djemve dhe e vajzave, tingulli i
bandave, oshëtima e aeroplanëve dhe... dhe..., por
ja aty nga darka, krisma shurdhonyjëse e qorrfishe-
këve i prishën mëndjen fare dhe duke vëzhguar me
habi turmat e qeta që ecnin si gjithnjë të heshtu-
ra, u ndal para Bashkisë dhe, duke zënë për krahu
një qytetar, e pyeti me frikë:

— Zotni! Ç'ngjau? Plasi lufta?

Dhe qytetari, duke qeshur, u largua pa i thë-
në gjë.

Zuri një tjetër. E pyeti:

— Zotni! Ç'është kjo punë kështu?

As ai nuk i foli.

Zuri një plak. E pyeti:

— Fol, zotni! Pse bien këto krisma, këto zja-
rre? Ç'është?

Dhe plaku e vërejti. Tundi kokën dhe iku i heshtur.

Fshatari s'merr vesh gjë. Asnjë s'i përgjigjet. Asnjë s'i flet. Dhe ky më së fundi i zëmëruar zuri një të ri. E pyeti me zëmërim:

— Thuamë, or vëlla, ç'ngjet? Si qëndron kjo punë? Pse asnjëri s'më flet, s'më përgjigjet?

Dhe i riu, duke i shtrënguar dorën, i thotë:

— Ik, or vëlla, për në fshat. Ik! ore, unë të kam zilë që s'merr vesh gjë... Sa i lumtur që je...

Se po ta dije, do të zbrisje me pushkë në dorë...

{Gazeta «SHTYPI», nr. 6, dt. 29 Prill 1937}.

U shkruan me rastin e ardhjes së Konte Çanos në Tiranë. (P.M.)

SHOK I DASHUR!

Bëre mirë, o shok i dhëmsbur, që na dërgove «verë» për të pirë. Është dhurata më e mirë. Verë për të pirë, për t'u dehur me rastin e Pashkëve. Ti e di fort mirë shqetësimin tonë. Prandaj vendose të na dërgosh verë. Verë Leskoviku. Verë «V.T.».. Që të harrojmë mundimet. Që të harrojmë... Ah! Ç'të harrojmë më parë, or shok! Ti shpëtove. Ike për në fshat dhe më shkruan se atje mërzitësh.

Çudi!

Në Leskovik mërzitësh! Atje ku përveç bukuriqe që të ngjallin, ku përveç ujit dhe... ke dhe verën e famëshme që të shëron, të deh, të bën të lumtur.

Sa mëkatë e madhe për bashkëatdhetarët tanë, që me mijra mundime nxjerrin në shesh diçka, si p.sh. vera e Th.V.. e cila të shëron plagët, dhe sa e sa të tjera që nuk përfillen, nuk përmenden, nuk ziren me dorë, se janë mall i vëndit!

Ne duam verë të huaj. Verë që kushton shumë dhe që para verës sonë, ah, s'vlen aq sa duan ta lartësojnë reklamat e huaja! Ne të mjerët, as reklamë, as përkrahje, asgjë !

Veç, o shok, thuaji atij Th. V. se vera e tij është

të me të vërtetë një bar, një ilaç që shëron plagët e atyre që vuajnë...

Dhe ne pimë. Pimë pa ardhur «Ngjallja». U dehëm. U bëmë për pak kohë të lumtur se s'gjëndeshim më këtu, ku ditë për ditë mbushesh me vrer, po ndodheshim atje, afër teje, në Leskovikun e bukur, aty midis vreshtave të punuara mirë. Dhe këndonim dalngadalë këngën tonë të zakonëshme.

E mban mënd këngën?

Të kujtohet jeta plot mjerime e këtushme?

Po ti, a pi? A dehesh? A këndon bashkë me fshatarët, të cilët verën e bëjnë, e hedhin në voza, në shishe?

Mundohen ta shesin, po ne nuk e blejmë, se nuk mban vulën e huaj. Është malli i vëndit. I pavlefshëm, i pashijshëm...

Ah, po ne na shëroi! Sa e mirë që ishte! Dhe çdo gotë na largonte nga zhurma e përherëshme. Na binte afër teje. Atje ku çdo gjë lëviz e lirë. Atje ku ëndrat mbeten gjithnjë të gjalla! Në fshat, në kasolle, në parajsë. Sa i lumtur që je. Pi, dehu me erë të pastër se ne gëlltitëm me etje verën që na dërgove. Ajo na shëroi. Ajo na bëri hem të lumtur, për pak minuta, hem na futi në mendime.

— Sa pasurira që kemi dhe nuk ua dimë vlef-tën! Syrin tonë e mbajmë gjithnjë në vëndet e huaja, në sendet e huaja. Dhe gjersa ne nuk do të shikojmë me dhimbje vëndin tonë, prodhimet tona, jetën tonë, ne do të jemi pa vlerë... vagabonda të vërtetë!

Pi, o shok i dashur, pi erë të pastër se ne gëlltitim me etje verën që na dërgove..

(Gazeta «SHTYPI», nr. 8, dt. 3 Mai 1937).

DOKTORI

Kish vajzën sëmurë. Sëmurë për vdekje.

— Shko, bre, në qytet! Shko te doktori, se ai do të ta shërojë përnjëherësh!

Dhe plaku i gjorë, e ngarkoi mbi një gomar vajzën e vet gati të vdekur. Dhe rendëte i këputur. Kaloi male dhe fusha. Lumenj e moçale.

— Baba! Vdes! Ku është doktori?

Se e mjera e kishte dëgjuar shumë herë emrin doktor, po nuk dinte se ç'ishte ai. Perëndi, engjëll, shpëtimtar... Ç'ishte ky doktor?

— Doktor! Doktor!

Thërriste vajza, e cila gati po jipte shpirt.

— Dhe pak se arritëm, o bijë! Duro se «doktori» do të ta heqë atë dhëmbje, atë sëmundje që të treti! Unë ja po e nxitoj kuplën:

— Hush, hush!

Dhe ecnin duke përsëritur mijra herë emrin e «shënjtë» të doktorit.

— Arritëm!

Andej-këtej, me mundime, gjetën «zyrën» e «doktorit».

— Doktor! Doktor!

Thërriste e sëmura. Shpresonte se një fjalë e doktorit do ta shëronte. Kujtonte se një e parë e «doktorit» do ta bënte mirë.

— Doktor! Doktor!

Kështu murmuriste.

Dhe plaku i gjorë dolli nga «zyra» e «doktorit» i këputur, i vrarë dhe gati me sy të mbushur me lot.

Doktori i kishte thënë:

— Dua një dëshmi që je i varfër, pastaj të vizitoj vajzën tënde! Shko në fshat, te kryeplaku! Thuaji të shkruaj...

Dhe ky ç'të bënte?

Vajza gati e vdekur thërriste:

— Doktor! Doktor!

Dhe plaku i bërtiti kafshës:

— Hush! Hush!

Vdekja erdhi duke bërtitur!

— Bëhu gati, moj e mjerë!

Ndërsa kjo, duke dhënë shpirt, mezi psherëtimi:

— Doktor!

Dhe doktori që e pa duke vdekur rrugëve, kërkonte *dëshmi vobegtësie!*...

Doemos, zbatonte ligjin!...

(Gazeta SHTYPI», nr. 8, dt. 3 Maj 1937).

Në çdo qytet, në Bashki, kishte dhe nga një ambulancë me një doktor për të vizituar të varfërit. I sëmuri, që të vërtetonte se ishte i varfër, duhej të kishte edhe një certifikatë-vobeksie nga kryeplaku. Pa atë certifikatë, doktori nuk vizitonte... Po pasi e vizitonte të sëmurin i jipte edhe ndonjë recetë... po ilaçet që kushtonin shumë, si do t'i mirrte i gjori fshatar apo qytetar? (P.M.)

PIKAT E SHIUT

Shi!

Ditë e natë shi. Pika shiu të lehta dhe të dendura përcjellin Prillin. Dhe Maji u prit me re të përlotura.

Baltë! Mërzi!

Dhe megjithëse era përpiqet të shpërndajë kundërmimin e ëmbël të trëndafilëve, sidomos të atyre që mbajnë nëpër duar vajzat e shkollave, pikat e shiut ëdhe bien. Dhe bien pa pushim.

Me sot e me nesër, presim diellin.

Të dalim përjashta, nëpër rrugë, nëpër lëndina me petka të lehta, me shpirt të lehtë, me zëmër të çelur.

- Shiu na mërziti.
- Ombrellat u rënduan!
- Këpucët u rënduan!
- Shpirti u rëndua!
- Dheu u rëndua!

Shi! Ditë e natë shi! Dajti, i mbuluar me një mjegullë, që hera-herës vihet në arrati prej erës prandverore, vëzhgon që andej lart kryeqytetin e mbuluar me ujë e baltë, dhe qesh.

Vëren djemtë e vegjël që bredhërijnë pa frikë në mes të shiut; pleqtë që gënjehen prej rreze-

ve të para të diellit ose prej kundërmimit të trëndafilëve, dhe qesh.

Shi! Ditë e natë shi!...

Baltë! Mërzi!

Prandvera kalon! Oh, se ç'kalon e përlotur!
E dënuar si të ritë e ndonjë jetimi fatkeq, që mbeti rrugëve!

Janë lotët e fundit që bien pa dashur në tokën e porsalindur, në jetën e re, në frymën e gjallë, në trupin e njomë të Natyrës, e cila i pret me dhëmshuri këto lotë jetëdhënëse.

Shi!

Të gjallët vrapojnë nëpër rruga pa frikë. Bredhërijnë përmbi baltë duke qeshur.

Nuk shikojnë lart mjegullën, as qiellin e mbulluar. As lulet e trëndafilat që kanë sunduar botën. Vëzhgojnë përpara. Janë të gjallë. Ecin pa frikë...

Të tjerët! — Ata të tjerët, që preken edhe nga pika më e lehtë e shiut, janë ngulur rëndë nën strehën e vet dhe, me padurim presin orë e çast Diellin.

Eh, dhe Dielli ka për t'i mërzhitur, ka për t'i verbuar, për t'i djegur, për t'i trëmbur me rrezet e tij të forta...

Mjerë ata që frikohen, hem nga shiu, hem nga dielli...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 9. dt. 6 Maj 1937).

ANDREA

Sa zor është të njohësh një njeri!
Sidomos kur ke të bësh me tipa që s'njohin
vetveten...

Tetë vjet kam që e shoh *Andrean* dita ditës në «Kursal».

— Andrea! Eja këtu!

— Andréééa! Shpejt këtu!

— Andrea! Foli Dhionisit...

— Fshimi këpucët. — Shko atje, eja këtu...

— Peqe, peqe, bej! Siurdhëroni! Siurdhëroni!

Dhe të shikon me bishtin e syrit. Të flet kur e pyet. Ama, si të flet? Ta gjen zëmrën. Të shëron. Të përkëdhel. Të futet në zëmër. Të njuh...

Megjithatë, unë nuk e njoh. Ai ma di shpirtin. Dhe jo vetëm mua, po tërë ajkës tiranase. Tërë «Djelmëve të Kursalit». Çudi, si ka mundur të njohë njerëzinë nga këmba?

— S'ka njeri që të mos i dijë dhe dhëmbët. Ka këtu plot të mirë e të këqij. Turli-turli milet. Hu-vardenj e kurnacër. Llafazanë e kù di unë. Hu-hu, se ç'këmbë mban kjo kutia ime: të rënda, të lehta, xanaxare!

Flet dhe këpucët gjithnjë i përkëdhel, i bën të ra.

— Mirëpo, pa më thua, mor Andre, kush të bën naze më tepër?

— Hu-hu! Dhe ti ç'pyet! Të pëlqen të të them

se kush është burrë i mirë? — Ja, bie fjala, Xh....
beu, s'ka më i mirë. Kurrë nuk ta ha të drejtën.
Dhe A.... beu ,dhe A.... bej Kësuli, për zonë e vër-
tetë, janë aq të mirë, sa lekun s'e kursejnë, jo ve-
tëm për këpucët, po nuk ja kanë sevdanë parasë,
mor zot. Këmbët e tyre ndryshojnë shumë nga ato
të disa të tjerëve, që hera-herës, ndonse pa dashur
hedhin xanxe.

— Po, kur punon më tepër ti?

— I lutem Zotit të pushojë shiu. Dhe kur pu-
shon, dua që pas dy ditëve të fillojë prapë. Pastaj
më vjen mirë, ndonse është për të uluritur, kur
vdes ndonjë njeri i njohur, se, doemos, do ta për-
cjellin shumë nga rruga e Bamit, e cila është keq e
mos më keq. Dhe atëherë, është e ditur që këpu-
cët duan llustruar. Ama, prapë i lutem të Madhit
Zot, që të na vizitojë shpesh nga ndonjë njeri i
madh i huaj, se atëherë z. Kryetar i Bashkisë do të
shpejtojë të shtrojë rrugët me një lloj kumi, i cili,
me t'u lagur pakëz, të ngjitet përkëmbësh...

— Andrea! Eja këtu...

Dhe më iku. E thirrën të tjerët. Sa di ai! Është
i vogël. Llupro, mor zot. Po njuh tërë Tiranën.

Domethënë, nga këmbët mund të njihet fare
kollaj këtu njeriu!

Është dhe kjo një mënyrë e mirë.

Ah, sa mirë! Sa kënaqesh kur të vegjëlit të
njohin. Të futen në zemër. Të vëzhgojnë. Presin
diçka prej teje. Ndonjë fjalë të mirë. Ndonjë shpre-
së. Ndonjë premtim. Mor, vetëm ndonjë buzëqeq-
shje. Asgjë më tepër.

Dhe sa mjerim, sa keq, kur ata nuk i njuh
njeri.

(Gazeta «SHTYPI», nr. 10, dt. 8 Maj 1937).

PARA! PARA!

— Ke parà, ke derman!

— S'ke parà, s'ke derman!...

Dhe kush nuk e di këtë? Edhe foshnja në bar-
kun e s'ëmës shurdhohet nga britmat e shpeshta:
parà, paraaaa!

Pa parà, s'je gjë!

Pa parà, je i vdekur dhe i pakallur.

Të gjitha bëhen për paranë dhe paraja bën çdo
gjë!

L'argent fait la guerre! (1)

Sa pare vlen të kesh tru! Të kesh kokë! Të
jesh dijetar! Të jesh... Perëndi në tokë si Krishti
ose si Muhamedi! Po s'pate parà, nuk përfillësh
midis të gjallëve...

Dhe prandaj që të gjithë — përveç të marrëve
— hurra përpara për parà. Për fitim. Ndryshe mi-
zerja të rrëmben nga qafa dhe të vërvit atje ku
s'ta pret mëndja.

Kush më pak e kush më shumë, dita ditës zë
parà me dorë. Është mjeti i domosdoshëm për je-
tesë.

Kush me djersë, kush me fjalë, kush me çdo
mënyrë fiton.

1) Paraja sjell luftë; (fr.)

Mirëpo lakmia e madhe për Paranë — që duhet shkruar me «P» të madhe — njerëzit i mundon, i bën të gjejnë mënyra të ndryshme për të shfritë në dorë shuma të mëdha. Sa të jetë e mundur më tepër: Parà, Paraaa, Paraaaa!

Luftëra, vrasje, vdekje, vjedhje, armiqësira, poshtërsira, dhe... dhe... vetëm për Paranë!

— Ke parà, ke derman!

Prandaj dhe disa lakmimtarë dhe robër të parasë, pardje u gjetën duke fabrikuar... Parà. Sa keq! Sa mjerim! E çfarë nuk pjell kjo drej manì! E bën tjetrin të ngrehë fabrikë të mshehtë parash! Dhe ku, mor zot? — Këtu në mes të Tiranës, ku tjetri di fare mirë dhe ç'ke ngrënë mbrëmë në darkë! Ç'kujtuan ata vallë, se Tirana është ndonjë New-York? Jo, mor, jo! Këtu gabohen shumë disa «mëndjehetë», të ardhur kushedi nga ku, përpiqen të ushtojnë mjeshtërira ilegale për fitime! Oh, sa kanë rënë në kurthin e goditur të sigurimit! Dhe ç'sigurim, pa! Që s'guxon njeri të shkasë pak shtrëmbër nga rruga e drejtë ndërkohëse e ligjeve, se e piu e zeza. Pa jo të ngrehësh dhe fabrikë! Ku jemi këtu?

— Do parà?

— Puno, drej!

— S'ke punë?

— Kërko! Mundohu! Përpiqu! Asnjë s'humbet po lëvizi. po qe i drejtë dhe i besuar në vetveten.

Paraja nuk fitohet me djallëzira. Kërkon punë, djersë...

— More vesh!

(Gazeta «SHTYPI», nr. 11, dt. 10 Maj 1937).

NJËRA ANË...

I

Që thoni, jeta ka dy faqe:

E para: kur s'ke mëndje në kokë, ti thua se je i urtë, dijetar, filosof — Njeri. Kur s'ke miq, ti bërtet hera herës sikur tërë botën e njeh ose, fundi i fundit, s'të hyn në punë njohja me të tjerët. Kur s'ke shtëpi, ti kujton se ke pallate. Kur s'ke bukë, ti nuk çan kokën. Kur s'ke punë, nuk bëhesh merak. Kur të tjerët qajnë, ti qesh me 'ta. Kur të zë ndonjë hall, ti thua: «gjysma e mijës pesëqind».

Kur sheh të tjerët të shqetësohen, ti gërhet.

Kur vdes ndonjë fatkeq, ti thua që shpëtoi.

Kur sheh përpara ndonjë të mjerë, ti s'vë ré.

Orë e çast ti qesh. Këndon. Ngulesh ku të duash. Flet lirisht. Çdo derë e gjen të hapur. Nuk truhesh, se kujton se shkel gjithnjë në dhogë të shëndoshë. Ecën përpara krenar dhe nuk vëzhgon rreth e rrotull. Je i lumtur. Je optimist.

E zeza të duket e bardhë.

Nata të duket ditë.

Nuk njeh mjerim...

Nuk çan kokën për hiçëgjë. Shikon punën tënde. Vatrën dënde. Xhepin tënd. Je nikoqir. Kurrë s'të ka zënë e keqja. Kurrë s'të ka trokitur në dorë dëshpërimi.

Gjumi të zë përnjëherësh. Dhëmbët ditë e natë të zbardhullojnë.

Prandaj thua nga një herë me habi:

«Janë disa të marrë që qahen kot nga jeta. E humbasin toruan kot. Nuk përballojnë dot rrahjet e zakonëshme të kohës.

Bëhen të mjerë. Mërziten. Dëshpërohen... Budadallëk! Ja si qëndroj unë! I patundur, i palakuar. Jam i gjallë. Jam vepronjës. Punë e madhe! Unë do ta shpëtoj botën? Unë do t'i ndaloj fatkeqësitë? Unë do ti thyej prangat e fatit? E pamundur! E shkruara, e thëna le të bëhet. Unë s'guxoj ta ndaloj. S'kam gjë në dorë. Prandaj shikoj punën time. Qesh. Këndoj. Pa lumi le ta marrë!...»

Ke të drejtë, o burri i botës, të bërtasësh kështu. Je i lumtur. Je optimist. E sheh njerën anë të jetës. Më tutje s'di se ç'bëhet. Nuk çan kokën të shikosh tej vetes. Ti kujton se tërë bota të përngjan.

Kujton se ti je qënia, ti je gjallëria, ti je Jeta!...

Dhe e beson me gjithë mend!

Ke të drejtë. Se dhe po të përpiqet ndokush që të të tregojë, të paktën me pahir, anën tjetër të jetës, ti s'ke fuqi ta shikosh, s'ke sy e faqe. Të ka rrëmbyer vala e hovëshme e «optimizmit» dhe të vërvit atje poshtë, nga s'ke mundësi të shikosh se lëmi i madh i jetës shkelet prej lloj lloj gjurmash.

Ti vetëm shurdhohesh prej rrjedhjes së buriimit të lumturisë.

Rron në njerën anë të jetës!...

— Po ana tjetër?

(Gazeta «SHTÿPI», nr. 12, dt. 13 Maj 1937).

ANA TJETËR...

II

— Ti gjithnjë qan! Vajton, ulurin, dëshpëro-
hesh ,shqetësohesh — vdes!

— Dhe përse?

— Për hiç gjë!

— Kështu je mbrumur! Të lotosh tërë jetën
tënde! Dita të bëhet natë! E humbet toruan kot më
kot! Pyet njerin, pyet tjetrin:

«Si do vejë kjo punë kështu? Ah, jam i mërzi-
tur! Nuk gjej qetësi! Vuaj... Vuaj shumë...»

— Po përse?

— Sepse bota është e errët! Jeta është e kotë.
Mundime, mjerime! S'ka gjë në vijë! Të gjitha ve-
në për së mbrapshti: gënjeshtër, hipokrizira, tra-
dhëtira, poshtërsira — e ku di unë. Këto sundojnë
pa frikë... Ah! E Vërteta! E Vërteta ku është?

Dhe flet mengadale. Jo si Ibrahim Shyti, që
alarmoi dynjanë me reklamën e tij tërheqëse plot
kitara dhe grepa. Dhe nga dëshpërimi ka harruar
të shënojë se në dyqanin e tij njeriu gjen edhe një
muhabet të shtruar... Tamam si nën hijen e ndonjë
pise të Llogarait...

S'ke ç't'i bësh! Është pesimist. Prandaj pi anti-

ce dhe dehet. Harron fatkeqësitë e Jetës. Harron padrejtësitë e kohës. Dhe qesh me lot ndër sy.

— Eh, kjo jetë! — thotë. — Gjer kur do të na mudojë? Gjer kur do të na shtyjë përpara për në sheshet e përlotura?

Dhe pi. Pi në shtëpi. Pi në punë. Pi rrugës. Pi që të harrojë se rron.

Dhe kur vjen në vete, prapë kujton vuajtjet dhe bërtet:

— Bota do ndryshuar! Do ndritur. Do shterur burimi i lotëve! Ja mjerimi si na ka zënë! Shihni, shihni lotët si rrjedhin. Sytë e mi qajnë nga mundimet e kohës. Kam etje. Dua të pi. Të vdes rrugëve. Bota është hiç! «Hiç, hiç!» — thotë i shkreti Spasse, që përpiqet të pasqyrojë kaosin e frymës së dëshpëruar të djalërisë në romanin e tij «Pse?!».

— Pse rroj? Pse përpiqem? Pse? Pse?

Ti gjithnjë pyet vetveten dhe ajo, pa dashur, të përgjigjet egërsisht:

— Kot!

Ahere ti vazhdon havazin tënd të përherëshëm.

«Kështu nuk shkohet!»

Dhe qan. Dhe pi! Pi birë! Verë! Raki koçimare! Aniçe. Pi që të harrosh.

Je pesimist.

Rron në anën tjetër të Jetës. Në atë anë ku errësira nuk të lë të shikosh matanë: atje ku jeta dëfren!

Po... po dëgjo:

Hidhe poshtë më mirë atë cipë të zezë, që të ndalon të shikosh jetën siç është. Eja në vete se kot qan, kot ankohesh! Kot, kot thua se «jeta është e kotë!» Kush ta tha këtë? Loti yt, që rrjedh

«kot?» Apo kush? Mos vallë vala e jetës të ka rrëmbyer dhe të rrokullis pa mëshirë nëpër brigjet e vuajtjes? Apo rrethanat ta kanë nxirë shpirtin, zëmrën tënde dhe kërkon të thuash se dhe tërë qënia është e nxirë?

Jo, mor mik!

Ti nuk je qënia! Ti je vetja jote. Ndrej, pra, vetveten dhe pastaj ke për ta parë ndryshe botën. Ke për të shikuar dhe anën tjetër të jetës...

(Gazeta SHTYPI», nr. 13, dt. 15 Maj 1937).

HIDHNI POSHTË!...

— Hiqi, a paç belanë! Hiqi syzat se s'të venë!

— A, po, më fal! Ti i ke vënë se tani drita e diellit të vret!

— Të vret me të vërtetë?

— Sa gjynah! Sa fatkeqësi! Të vret drita e diellit! Ajo dritë që kërkohet firi-firi. Ajo dritë që jep jetë. Jep shpresë: gjallëri...

Bota vritet, pritët, bëhet theror për dritë dhe ty s'të pëlqen ta shohësh. Do errësirë. Do natë. Të pëlqen ta shikosh jetën të errët. Të pëlqen të shikosh njerëzinë të errët!

Sa mëkatë!

Hiqi! Hidhi poshtë! Ec pa frikë nën dritën e Diellit. Ajo do të të tregojë rrugën e vërtetë. Jo errësira! Jo ajo cipë e zezë që ti kërkon të të mbulojë qënien. As ai qelq i errët që të nxin rrëmetin.

Hidhe poshtë maskën e zezë! Dil në shesh siç je!

Apo të pëlqen ta shikosh ndryshe këtë jallane të shkretë!

Mos vallë drita e Diellit që bie me fuqi në dhë e tregon botën siç është dhe ti, i prekur thellë, nuk duron dot ta vëzhgosh vallen e përlotur se si hiqet?

Mos vallë sytë e tu nuk kanë atë guximin të përballojnë rrezet që kallëzojnë të vrtetën?

Mos vallë je mësuar, je lindur, rron në errë-sirë dhe kërkon të dergjesh për tërë jetën në errë-sirë?

Apo je armik i dritës?

— Oh, sa fatkeq që je, nëse e ke me të vërtetë dhe beson se do t'i ndalosh rrezet e forta dhe të gjalla të Diellit!

— Je skllav!

— S'vlen gjë!

Prandaj të ushqen errësira!

Po ta dije, o lumë se ç'jetë të jep Drita! Ta dije, o lumëmadh, se sa vlen Drita! Ta dije, o i humbur, se ç'do me thënë të rrosh nën dritën e Diellit! De more de, sa i lumtur do të ishje! Do të ishe me të vërtetë i denjë të rroje nën dritën e Diellit si një qenie e lirë...

Hiqi syzat e errëta. Kërko Dritë!

«Ç'më thua ti! Unë s'e dua dritën? Unë që linda në errësirë? Jo, mor mik. Unë dritë kërkoj. Po ç'ti bëj pluhurit që s'më le të vëzhgoj mirë. Ja! Shihe tramundanën e egër se si ma vërvit pluhurin në sy! Dhe po të mos kishja këto syza do të isha verbuar fare! Ti a je i zoti të ndalosh këtë erë të marrë! Këtë erë që fryn gjithnjë?»

— Jo.

— Atëhere, pashë Zotin, vë edhe ti syza se ke për ta humbur fare dritën e Diellit!...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 14 dt. 17 Maj 1937).

LEGATA...

Mëngjes për mëngjes para derës, në dy fro-
na të gjatë, ulen «mërgimtarët».

Nuk flasin!

Nuk ndjejnë gjë, përveç të rrahurave të forta
të zemrës.

Shikojnë njeri tjetrin dhe hera herës vështri-
mi i tyre ndalet me orë të tëra në kopshtin e madh
të Legatës Amerikane.

— *Good morning!*

— Allo!

— Jam nga Dardha!

— Unë nga Përmeti!

— Unë nga Himara!

— O, xha Vangjeli! Po kur erdhe? Po si je? Po
pse erdhe prapë? O, je i lumtur, për Zon' e vërte-
të! Vjen kur të duash! Herën e parë me Këqon. Ta
ni me Kostën. Pastaj me Foton. O, je me të vër-
tetë i lumtur...

— Ç'të bësh. Hé, hé! O kasolle ku na mblo-
dhe... Na qau gërmadha...;

Dhe qesh. Qesh dhe nuk di pse njeriu bëhet
tërë gas kur shkel në dheun lindor. Qesh e kapar-
diset tamam si në mes të fshatit duke dashur të
thotë: «Ja si vete e vij. Ja si rroj unë! Punova, fi-
tova. Vajta në Amerikë...»

Flet e flet pa pushuar.

Të gjithë shikojnë kopshtin. Dhe e shikojnë me mall. Bari i njomë. Fiq, rrepe, trandëfila. Atje tutje një zgjua. Rreth e rrotull pemë. Gjelbërime dhe... heshtje. As bletët nuk ndihen.

— Mirë po, pse Legata Amerikane e ka lënë kopshtin të pa punuar?

— Eh, mor zot. Amerikanët janë të thjeshtë. Ata duan ta shohin natyrën, jetën të pangatërruar.

— Jo, mor mik. Ka një tjetër qëllim, ky kopsht i madh i lënë kështu siç është, ky kopsht tregon vendin tonë. Dheun tonë të pasur. Ja se si është! Pret duar puntorë ta mbjellin me një farë të lagur me djersë shqiptare. Shikojeni! Shikoni! Kë kopsht ka për të na dalë përpara kudo që të jemi. Në daç në fabrikat e mëdha, në daç në dollarët e shumtë. Janë rritur të gjitha pa masë. Dheu ynë është pjellor! Ja ky kopsht është pasqyra e atdheut tonë. Ka vetëm bar, lule të egra, bar. Ka tokë pjellore...

— E dëgjuat? — Ka të drejtë...

— Kopshti i Legatës simbolizon dheun tonë djerr.

— *Allo! Gobeit!*

— Udhë e mbarë! Udhë e mbarë. Po mos harro se ke lënë pas një kopsht shumë të pasur që ka nevojë të vaditet me djersë shqiptare.

(Gazeta «SHTYPI», nr. 16, dt. 20 Maj 1937).

KUNDËRMIMI

— Ti, o Ndoc, je shumë i vlefshëm!

— Ti bën një punë për t'u lavdëruar. Lufton erën e keqe dhe, me pompën tënde, që kurdoherë e mban në dorë, shpërndan aromë, parfum. Sa mirë! Sa ëmbël!

— Tërheq atje brënda lloi lloi nejrëzish, që kanë nevojë të freskohen me erëkëndje, me kundërmimin e ndonjë vjollce të zier.

«Kam dhjetë vjet këtu, më the. Kanë shkuar nga dera ime qindra mijra njerëz: Ministra e deputetë. Të vegjël e të mëdhej. Të varfër e të pasur. — Sidomos femrat. Femrat, zotni, kanë nevojë për kundërmime.

— Domethënë, o Ndoc, ato po të mos spërkatën me parfume, bien më shumë erë të keqe!

— O, jo zotni! Më fal! Ato e kanë shpirtin të ëmbël, të pastërt, kundërmon erëkëndje. Duan që edhe trupin ta kenë si shpirtin...

— Ti kërkon të thuash se i fëlliquri në trup ka dhe shpirtin dhe zemrën të fëlliqur!...

— Këtë nuk e di unë. S'jam nga ata që shikojnë në brëndësirë. Unë shikoj vetëm përmbajtjen e përjashtme. Pastaj unë s'i pyes, mor zotni. Kushdo që hyn këtu brënda në «Parfumerinë» ti-

me, unë e kam bërë zakon që do ta freskoj me pak ujë kolonje. Me këtë gjë unë kënaqem, më pëlqen. që çdo njeri të kundërmojë erë të mirë...

— Mirë, po t'i mos kujton se gjithë njerëzit që mbyten dita-ditës me ujë kolonje, janë me të vërtetë të këndshëm si era e parfumit?

— Aaa! Zotni, unë këtë s'e di dhe pasha Zotin s'dua ta di. Ja, që ta përsëris: Njerëzit i shikoj nga përjashta. S'kam atë mjeshteri të thelloj brënda tyre. Pastaj ti kujton se është punë e kollajtë të depërtosh në shpirtin e tjetrit? Hoho! E pamundur. Kjo është punë e lehtë dhe e mirë. Fëlliqësirat e tjetrit mbuloi me «parfume.» Se po të vihesh t'i pastrosh fëlliqësirat e brëndëshme, do të mundohesh kot. Jo vetëm ti, po tërë ata që përpiqen për tërë jetën e tyre të zhdukin erën e keqe të shpirtave të ulëta...

— Ke të drejtë! Je me të vërtetë siç tregoresh. Po, të lutem, hidh, hidh sa të mundësh ujë kolonje në njerëzit që të vizitojnë, se tani që nisi vapa, nuk durohet dot fëlliqësia e trupit. Sa për atë të shpirtit ose të zemrës, mos u bëj merak ti. Jemi mësuar qysh në djep me atë kundërmim...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 17, dt. 22 Maj 1937.)

BISEDA NË PUNË

Tri herë ditën hyj e dal nga dyqani i Haxhiut. Dhe, po të mundesha, do të ngulesha atje me orë, se kërcet muhabeti tamam si në mulli!

— Jo kështu, jo ashtu!

— Jo filani bëri këtë, jo filanka është e përmëndur!

— Jo shiu bëri dëm, jo po dielli na përvëlon!

— Jo tregu këtë radhë ishte i vdekur, jo u vranë dy kriminela!

Njëri flet mbi shtazët. Tjetri mbi ndodhjet e ditës. Tjetri mbi «hallet»... mbi çdo gjë.

Veç mos harroni që dyqani i Haxhiut është rrobaqepsi.

Maqina hera herës mundohet të humbasë zhurmën e bisedës, por kot, se zëri i Shyqyriut nuk mbulohet kollaj nga tingëllimi i lehtë i hekurave...

— Mirë këto havadize, po këtë karafil të kuq ç'ma mban këtu çdo kohë?

— A, mor i dashur! E para e punës, unë i pëlqej lulet. Po Mustafaj e ka për ugur të verë në majën e maqinës dhe nga një lule. Pastaj, ç'pret nga ne ti? Ne jemi hallexhinj. Bëjmë ç'bëjmë dhe përpiqemi të tërheqim njerëzinë. Herë me fjalë, he-

rë me lule, herë me lutje. Mirëpo, siç e sheh dhe vet, këtu muhabeti kërcet.

Sa për punë, bereqatversën, se kemi zënë e kthejmë xhaketa e pantallona, tri-katër e pesëvjeçare, në gjuhën shqipe...

— Megjithatë. gjithëmonë jini të çelur, të qeshur!

— Eh, pra! Këtë dua të them edhe unë. Ne jemi mësuar. Pastaj s'kemi dhe shumë dëshira. Mjaftohemi me pak. Po dije se na vjen mirë kur qepim kostume, se përveç që punojmë, po sheh, bie fjala, një trup që përpara s'kish lezet, të dridhet e të përdridhet me krenari. Petku, mor zot, të nxjerr në mejdan, të bën të nderuar, të jep famë, të bën... njeri!

— Ke të drejtë. Ju rrobaqepësit mundeni brënda një dite të bëni njerëz egërsirat dykëmbëshe.

— Apo jo, o Haxhi i dashur?

(Gazeta «SHTYPI», — nr. 19 dt. 27 Maj 1937).

VAGABONDI

— Ti me dëshpërim vëren gjindjen që kalon nën dritaren tënde! Dhe nuk guxon të hapësh perdet. Ke frikë se mos loton.

— Je e marrë!

— Unë e marrë! Unë vëzhgoj me dhëmbje çdo njeri që ikën si i humbur në mes të këtij bulevardi të madh!

— E ç'njerëz kalojnë, pa!

— Të pasur e të varfër. Të mënçur e budallenj, e ku di unë.

— Po ai ç'është?

— Është «vagabondi»!

— Kush?

— Njeriu që shoh shpesh herë. Njeriu që ka humbur gjurmën e jetës dhe që vërtitet pa ditur se ku. Ai që ka humbur toruan.

— Kush?

— Ja, pra, shikoje se si ecën! Është i humbur. Është i çmëndur!...

Është jashtë rrethit. Është i vetmuar...

— Po përse?!

— Se është vagabond!

— Vagabond? Domethënë njeri i lig, i rrezikshëm?

— Nuk e di! Po shikoje se si nuk përfill njeri.
Nuk i bën tërt veshi as nga era, as nga dielli, as nga jeta.

Rri pa bukë dhe qesh. Rri zbathur dhe qesh.
Rri i parruar dhe qesh. Rri i vetmuar dhe qesh!

Rri nëpër rrugë dhe qesh! Është vagabond!
Është i heshtur. Por nuk çan kokën për «atë» që të tjerët kërkojnë ditë e natë. Nuk çan kokën të shikojë se kush i kalon pranë... Veç dije se çdo send e vëren me dhimbje. Dhe mbasi nuk i pëlqen, se nuk vete drejtë, e mallkon! E urren dhe thotë me vete: «Se ç'bën kjo botë e shkretë, lere mos e nga... Po ku je, moj e vërtetë.»

Atë kërkon me qiri. Prandaj u bë vagabond!

— Është i marrë atëhere!

— Jo! Është «vagabond!»

(Gazeta «SHTYPI», nr. 20, dt. 31 Maj 1937.)

«L I G J Ë R I M»

— Erdh Naimi, o bilbil!
Eja t'i këndojmë tok,
T'i themi një ligjërim,
Se dikur e kishim shok...
Dhe bilbili po ja thotë:

Naim! Erdhe? Prapë u takuam! Mba mënd, o Naim, kur këndonim një jetë që kishte për të lindur? Mba mënd? Të kujtohet kur ti më kërkroje dhe më thoshje se kënga ime të shëronte, të ngjallte, të bënte trim dhe të mallëngjente? Mba mënd kur ti nanurisje me ligjërimet të ëmbla një fis që flinte në gjumin e thellë të skllavërisë? Mba mënd? Naim! Fol! Jam unë shoku yt që kam heshtur se të humba me vjete? Çu bëre, Naim, fol, fol, o këngëtor i ringjalljes së kombit!

Dhe sa kam qarë! Të kam kërkuar «në bregoret bukuroshe», në «burimet e kulluar», nën «hijen e shkabave», atje ku nata është tjetër natë dhe dita tjetër ditë... Atje ku rrinë Perënditë...» Të kërkova, të këndova në heshtje, po më kot... Ku ishe? Naim, shok i ëmbël, luftëtar i ndritur... Ah tani, eja, eja t'ja themi... t'ja nisim prapë si atëhere, kur ti, i arratisur, digjeshe nga flaka e qirit. Përvëloheshe dhe, megjithatë, këndoje, ligjë-

roje idealin e lartë të një fisi skllav që dergjej në skllavëri.

Naim! Eja t'ja themi! Nisë ti siç e kishe zakon! Fillo, pra, «o malet e Shqipërisë!» Fillo me «vllazërit shqiptarë!» Folu, thuaju prapë të zgjohen, të ndriten dhe të marrin «rrugën e mbarë.»

Ligjëro, pra, Naim!

Pse hesht?

Ç'ke?

Oh, sa ke për të kënduar!

Plot 37 vjet të ngrehura me vargje të errëta, me vargje të ngjyrrura, me vargje jo shqiptare që kam dëgjuar. Prandaj edhe unë u fsheha në «pyjet e gjelbëruar» dhe pritja ditën që të takoheshim.

Tani eja!

T'ja nisim së bashku këngës së parë.

Apo ke për të ligjëruar ndryshe!

Apo ke për të shprehur tjetër flakë, tjetër ideal?

Pse s'këndon më?

Pse s'më shoqëron?

Naim, pse rri i heshtur?

Ç'pate?

Këtu je në dheun që ti zgjove. Në vatrën që ti e ndeze... Je në limeret e vjetra ku nisi kënga e përmallëshme të ligjëronte Lirinë...

Ndihmomë, pra, o Naim, se do të fillojë një tjetër këngë, me tjetër melodi:

Do të këndoј mshehtësinë,
Që ky fis me mall ushqen...
Si e gjete, pra, Shqipërinë?
Ardhja jote më dëfren...

— Mjaft, bilbil!

— Përse ma preve këngën?

— Mjaft më! Naimi s'këndon më! Nuk e sheh të mbyllur në kutin e fundit të varrit?

— Si? Naimi i vdekur! Jo, mor vëlla! Ai «është i gjallë e është në jetë, është në dritë të vërtetë!»

— Po kënga e tij ka ndaluar. Duhet tjetër këngë tani. Ajo këngë ndezi, ndriti, ngjalli. Tani ku është kënga që të thotë: «Përpara?!»

— A, kënga e Naimit është e përjetëshme! Po eja ta zgjojmë. T'i themi «mirëseerdhe!» Ti këndojmë këngën e ëmbël të fisit që ka kënduar...

Ëja:

Flij, i dashuri Naim!

Flij, se ndrite mjaft një natë

Përmbi varrin tonë të ngratë...

Po tani me mallëngjim

Të këndon me ligjerim

Përmbi varr një gjeneratë...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 22, dt. 5 Qershor 1937.)

BOTIME QE S'NA NDEROJNË

Kaluan vite me radhë dhe sytë tonë panë lloj lloj botime të pjekura dhe të papjekura, sharlatane banale, të urta, të vlerëshme, po në të vërtetë, duke shkuar koha dhe duke u përmirësuar, kalojnë afër njëzet vjet qëkur shqiptarët këndojnë fletore e revista shqipe dhe megjithëse «shtypi» ka përparuar shumë, megjithëse shkrimtarët dhe gazetarët janë shumuar, këndonjësit nuk janë shtuar. Vetëm tani, në kohët e fundit, kur gazeta koston 5 qindarka ari, munda që kjo të këndohet prej 5-6000 vetash. Ishte e vetmja mënyrë për t'u përhapur fletorja. Çmimi lot një rol me rëndësi...

Po lënda?

Lënda ka të bëjë shumë. Domethënë dhe këtu te ne këndonjësi çmon pak a shumë përmbajtjen e botimeve, zotësinë e shkrimtarëve, karakterin e tyre dhe... dhëmbët e tyre. Thotë, b.f. «Ai shkruan mirë, ky shkruan keq. Ai është i ndershëm, ky, është lere mos e nga se ç'është!»

Jemi shumë pak dhe e njohim njeri tjetrin aq mirë, sa nuk shpëton edhe ditja e «darkës» që ha tjetri në vatrën e tij...

Prandaj, këtu shkrimet më tepër shikohen

dhe nga kush shkruhen. Kam parë dhe kam dëgjuar: «Ama, filani shkruan?! Grise, grise gazetën, se e njohim surratin e tij!..» Kështu nga shkaku i «filanit», hidhet poshtë tërë botimi.

Mirëpo, kanë apo s'kanë të drejtë këndonjësit të çmojnë vlerën e shkrimit simbas personit që shkruan? Apo duhet të shikohet vetëm «brëndia» e shkrimit dhe të mos vërehet se e shkroi «i ndershmi» ose «i fëlliquri?»

Ç'vleftë ka një mendim i urtë, i matur, i dallë nga koka e fëlliqur e një sharlatani të njohur?

Ç'vleftë ka një predikim ideal patriotik i shkruar nga dora e një aventurieri të njohur?

Ç'vleftë kanë udhëzimet, këshillat, porositë, drita që gjoja mundohet të shpërndajë mëndja e errët e hipokritit e... e...?

Dhe ç'vleftë ka, për shëmbëll, një botim që s'di pse botohet, s'ka qëllim, s'ka asnjë vijë të caktuar?

Për të fituar para?

Për të fituar famë?

Për të fituar pozitë?

Pse?

Unë them që njerëz të tillë, të cilët marrin gëxim dhe nxjerrin në mejdan «pjellën» e tyre helmnjësë, nuk duhen të përkrahen as prej asgjë. Ata duhen luftuar. Duhet t'u thyhet hunda, t'u përplasat turrive botimi i tyre dhe t'u trumbetohet:

«Truri ynë i varfër, i virgjër, kërkon ushqim të mirë e të përshtatshëm. S'duam helm! S'duam sharlatanizma!

Mjaftë me lëvdatat! Le t'i tregohet kujtdo vëndi që meriton!

Del një revistë, lëvdo, mburr, ço në, qiell!
Del një fletore, lëvdo, uro; thuaj fjalë të mëdha!

Del prapë një revistë tjetër, gërmo me kazmë në fjalorin e lëvdatave bombastike...

Mirëpo s'vete kjo. Me të vërtetë duhet të inkurajohet çdo botim ose inisiativë ndriçonjëse. Po jo me sy të mbyllur. Me të vërtetë kemi nevojë, jemi të varfër, prandaj duhet t'u shtrëngohet dora atyre që mundohen me gjithë zëmër për të kontribuar qoftë edhe një grimë punë pemëdhënëse jetës sonë mendore. shoqrore, ose thuaj si të duash, po jo të çohen në qiell njerëz që s'meritojnë të dërgohen në baltën e thellë të Myzeqesë, të punojnë natë e ditë, që t'u vijnë në vënd trutë e kokës...

Me këtë qëllim të pastër, pa patur parasysh persona ose mërira a simpatira do t'i kqyrnin botimet.

Merr në dorë, përshëmbëll, revistën «Bota», që dolli tani afër në Korçë.

Ç'botim është ky? Ç'vlerë e ç'meritë ka një revistë e tillë? E përse del? Dhe ku pa! Në një djep të letërsisë kombëtare! Në vëndin tonë ku ka etje, ka nevojë të domosdoshme për dritë.

Na vjen keq, bile shumë keq, kur shohim botime të tilla që shpërndahen si bukë e mykur në të uriturit. Mirëpo këndonjësi shqiptar, që pak nga pak ndjen nevojën e këndimit, a thua se është në gjëndje të përtypë çdo ushqim ndriçonjës që i falet?

Do ta vazhdojmë muhabetin në numrin që vjen.

(Gazeta «SHTYPI», nr. 24, dt. 10 Qershor 1937.)

DOBËSI

— A je burrë?

Kështu të thotë me të parë një fshatar, një malësor, një shqiptar.

Domethënë herën e parë të pyet mbi burrnin tënde, mbi karakterin, mbi moralin... Pastaj nis kuvëndimin.

Mirëpo sot tjetri, lëre që s'ja di fare kuptimin kësaj thënieje, po duke e mbajtur veten si të ndershëm, kërkon me çdo mënyrë të mposhtë çdo njeri të panjollë, vetëm e vetëm sepse nuk duron dot që kjo shoqëri të ketë edhe disa me shpirt të pastër dhe të ndërgjegjshëm...

Njoh një njeri. Intelektual bir i botës, i cili kudo që gjëndet, mbahet si i plotfuqishëm: kudo e fut hundën. Dhe dalngadalë, kujtdo ja nxjerr zorret me «pallavrat» e tij të zakonëshme. Dhe vetë kujton se s'po e kupton njeri.

Flet, shpif, shan, trazon duke ngritur veten në qiell dhe duke përbuzur të tjerët.

Kërkon që edhe të tjerët të ndjekin gjurmën e tij. Atë gjurmë që njerëzit i shpie për në greminën e karakterit. E bëjnë të dobët dhe «të ultë».

Se ç'i duhet, p.sh., atij të thotë para kolegëve

dhe të tjerëve se «filani» shkruan në fletore kë-shtu e ashtu...

— Eh, mor lumë miku! Të them të drejtën, është më mirë që njeriu të mos i njohë për së afërmi disa «tipa», që përpara të bëjnë njëmijë lajka dhe pas shpinës të bëjnë varrin... Po, nejtse. Fjalët e tyre nuk kanë guximin të dalin të kthjellta. janë fjalë që dalin nga zori ose nga zakori. Fjalë të një karakteri të dobët. Fjalë boshe, që nuk duhet të ndihen... Po ç'të bësh, kur tjetri të akuzon rëndë? Është një dobësi, kur tjetri të mbleks ose të ngjit një bisht që ti, me mish e me shpirt, e lufton. Është bela kur tjetri të thotë «batakçi», kur-se ti për të luftuar «batakçinjte» vuan, heq dhe ndiqesh edhe prej më të afërmit...

Veç s'ka gjë, se kështu e ka kjo jallanë.

Megjithëkëtë, s'të vjen keq aspak kur kjo akuzë të bëhet nga ana e një njeriu të lindur për të akuzuar, të stërvitur për ngatresa dhe të rritur me një karakter të dobët...

Atij i merr fytyra qindra bojra dhe s'mbahet dot kur i thua:

— A je burrë!?

(Gazeta «SHTYPI», Nr, 26, dt. 14 Qershor 1961)

KUVËNDIME ME «NJERËZIT E PENËS»

Është bela e madhe të bisedosh me ndonjë «shkrimtar». Duhet të kesh mëndjen të mos të të shkasë ndonjë fjalë «e keqe» për shkrimet e tij. Duhet orë e çast ta mburrësh. Ta çosh në qiell. T'i thuash: «Vetëm ti je i zoti! Të tjerët s'vlejnë gjë para teje!...»

Dhe është qejf i madh kur gjëndesh midis shkrimtarëve! Po, shkrimtarëve! Se edhe ne kemi shkrimtarë!... Dhe t'i dëgjosh kur bisedojnë:

Shajnë të tjerët. I bëjnë paçavure dhe veten e ngrejné lart.

«Unë jam zheni!» — thotë njeri.

«Unë jam i pavdekshëm!» — thotë tjetri.

Dhe po t'u kundërshtosh, jo vetëm që s'të flasin më me gojë, po përpiqen të të bëjnë edhe varrin!...

Është mirë që të mos i njohësh për së afërmi «Njerëzit tonë të Penës!»

Dhe po të kesh ndonjë farë adhurimi ose respekti për «veprat» «e tij», me t'u njohur, me t'i dëgjuar zërin, përnjëherësh thua:

— Ah! Ç'm'u desh që e njoha! Ushqëja një simpati të veçantë për këtë, po tani e shoh se ky qënka i krisur. Orë e çast veten e tij lavdëron.

Sa veta janë vetëquajtur «Poet Kombëtar!»

Sa janë mbiemëruar «Shkrimtar!»

Sa e heqin veten të madh!

Save u është rritur mëndja!

Dhe me arësye, se:

Po të bëjë njeriu ndonjë varg — doemos poezi — gjithë të njohurit e urojnë, e përkëdhelin me «fjalë të mira», dhe atëhere ky, hopa dhe në qiell. Shkruan, ëndëron, s'përfill njeri, bashkëkohësit i duken miza...

Po të shkruaj dikush disa vija; në fletore ose revista, me të parë emrin e tij të botuar, ndryshon përnjëherësh fytyrë, mëndje, gjëndje: bëhet serioz dhe tallet me të tjerët...

Pa lere kur boton ndonjë volum, — sidoqoftë! S'mbahet më! Fluturon dhe hidhet në vallen e «Shkrimtarëve» të kohës. Vret e pret dhe pak nga pak bëhet më i lehtë... se lëvdatat, urimet, gradimet — që ky ëndëron — i erdhën përnjëherësh dhe i ranë si dërrasa tavani mbi kokën e tij të dobët, duke e trullosur aq sa ai bërtet:

— Unë jam! Pena ime vlen. Të tjerët s'vlejnë një paret!...

— Ç'të bësh! Jemi të varfër nga koka. Pa kur të tjerët ndonjëherë na trumbetojnë mengadalë ose me fuqi se ne jemi diçka, atëhere ngrehim kokën dhe shikojmë gjithnjë lart; pa qënë të zotë të vëzhgojmë as edhe vetveten. Kjo është fatkeqësia jonë më e madhe. Na pëlqen për vdekje lëvdata,

fama, pa qënë të zotë, që këto t'i fitojmë me punë e meritë. Po të na pëshpëritet në vesh e vërteta, ahëre bërtasim :-Gënjen! Nuk di të çmosh! Je pas nga bota!..»

Mirëpo edhe një tjetër zakon i keq që u mbuall këtu tek ne, është përçarja e «njerëzve të penës». Këta kurrën e kurrës nuk janë bashkuar tok e të bisedojnë mbi shkrimet e ndryshme që botohen. E ku afrohen këta, more vëlla! Njeri shikon polin e Veriut, tjetri atë të Jugut. Njeri shan tjetrin — doemos prapa shpinës — dhe shumë herë edhe në polemikat që shohin dritën e botimit. Pastaj nuk e çmojnë njeri-tjetrin.

Duke qënë se biri i botës veten e quan «të mbinatyrshëm.» domethënë «të krisur», si do të mundë ky të bisedojë mbi çështje kulturele, letrare — me ata që ky i quan... miza? Dhe kështu të paafruar njeri ushqen mëri ndaj tjetrit.

Veç duhet të dihet se ndahen edhe këta në disa grupe. Bie fjala janë katër a pesë që bashkëbisedojnë, që kanë miqësi të ngushtë midis tyre, se janë të një kallëpi dhe lidhja e tyre e ka burimin tek interesi.

Këta a e dini se ç'bëjnë?

— Mburrin njeri tjetrin!

Këta, po të duan, njerin prej tyre e çojnë aq lart, sa jo vetëm që e bëjnë «Poet Kombtar», ose «Skulptor Kombëtar» ose «Novoselist Kombëtar», po i thonë:

— Mor, ti je zheni!

Dhe «Zheni u» shkel pa frikë mbi trupat e «shkrimtarëve» të tjerë, duke i mposhtur dhe duke i tallur. Në këtë mënyrë, s'ka mundësi të afrohen kurrë «Njerëzit e Penës».

Në këtë mënyrë, jo vetëm që s'del gjë e lartë dhe e pastërt në shesh, por duket haptazi shpirtvogëlsia jonë: ajo shpirtvogëlsi që na verbon dhe që nuk na lë të shikojmë, përpara vetveten, pastaj të hedhim një sy rreth e rrotull për të vëzhguar pellgun «gërnjar», ku notojnë të përçarë «Njerëzit e Penës...»

(Gazeta «SHTYPI», nr. 26, dt. 14 Qershor 1937).

BISEDIME ME...

...Pallatet ministeriale!

Pallate!

Palalate të mëdha... Shumë të mëdha. Tre më njëren anë dhe tre më anë tjetër. Një kopsht plot bar e zall...

— Pse s'është mbjellur fare ky kopësht? Pse e kanë lënë kështu pa asnjë lule, pa asnjë... pemë! Mos vallë simbolizon dheun e virgjërt arbëror?

— Jo! Kështu mbahen në botën e perëndimit kopshtijet...

Duke ecur gjithnjë nga e djathta, ndërtesa e parë madhështore — dera e dytë, përsëri nga e djathta — mban një tabelë të vogël — formë zyrtare — me këto fjalë: «Kryeministria» dhe pak më poshtë: «Inspektorja e Oborrit».

Pak njerëz hyjnë e dalin. Qetësi. Pastërti... Pallat me të vërtetë!...

Nga e mëngjëra, koridori shkelet dita ditës prej këmbëve të lehta dhe të matura të inspektorëve të oborrit... Tani afër ato pllaka përkëdhelen edhe prej këpucëve të bardha të z. N. B...

— Zotni! A këtu është Kryeministria?

— Po, përse?

— Kam pak punë... Jam një «hallexhi» që

kam hedhur qysh vjet një lutje me fotografinë time për ndonjë punë... Kam pritur tamam një vit e ca. Mbasi s'po bëhet gjë erdha të marrë fotografinë time, se dua të nxjerr pasaportën për në Amerikën e Jugut...

Ç'm'u kujtua! Aman, o zyrë e lutjeve, ku je! Ku jini, o fotografira të qindra mijra «shqipove» që me poza të ndryshme presin akoma emërimet!;..

— Që të gjesh fotografinë tënde, vëlla do të kaloj edhe ndonjë vit tjetër. Kushedi se sa kuin-talë fotografirash dergjen në depot e këtij pallati... Megjithatë kanë një vlerë, jo vetëm historike, po kushedi ndonjë ditë mund të duhet koleksioni i fy-tyrave të arbëreshëve për studime tipash fiziolo-gjikë...

Duke hypur lart, gjithnjë nga e djathta, një «zotni» i veshur si më mirë dhe me një paraqitje të rrallë, që zbriste me të shpejtë, u ndal pakëz për të pyetur. Ishte zoti *Adem Çali*.

Dhe kush nuk e njeh këtë nëpunës!

— Kam 17-20 vjet protokollisht në Kryemi-nistri.

— Domethënë, ti njeh shumë gjëra. Dhe për-mbi të gjitha, hallet e çdo nëpunësi të vdekur e të gjallë...

Ai shpejton, se duart i ka plot akte. Kushedi se ç'përmbajnë ato të uruara. Ai i di. Ai aktet i ka si lule. Qesh kur ato kanë erë të mirë dhe hesht kur ato tallen me fatin e ndonjë nëpunësi. Ka afro njëzet vjet që dita ditës shkruan emra, shuan, emë-rime, qortime, vërejtje, transferime, gradime... Be-soj se vetëm njëqind fjalë zyrtare të plota bëjnë krejt fjalorin e madh të jetës nëpunësore.

Vetëm dy gërmat «P.T.» dhe «me nderime të larta» dhe «duke shpresuar», thurin vargjet e këngës së Mukës...

Dua ta pyes:

— Mirë, ti që ke afro njëzet vjet këtu, as më thua, sa kryeministra ke ndruar? Sa pallate ke parë? Sa kafazë dhe shërbëtorë ke pasë këtu? Sa akte protokollon dita ditës? Me ç'Ministri ke më tepër allish-verish? A i mban mend tërë emrat e nëpunësave? Dhe kur emërohet ndonjë i ri, a pyet se ç'surrat ka ky ushtar i ri i batalionit nëpunësor?...

— Mirëpo iku me të shpejtë, se kushedi se ç'lutje do të regjistronte në qitapet e tij.

Po tani, ku të vete?

Ku të hyj?

A bën të takohem me Shkëlqesinë e tij?

Apo të trokas në derën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Vallë, çdo derë do të hapet?

Kushedi...

Dhe ndërsa matem të flas me «portjerët» — se, helbete, dhe ata diçka do të thonë — andej larg ma bën me sy «zyra e biografisë», duke më thënë:

— Eja, eja këtu. Eja të shikosh se ç'mbaj unë brënda mijra zarfeve... Këtu dergjet jeta e çdo nëpunësi!...

— Ç'urdhëron, zotni!

Më flet z. SH.K. që dolli me të shpejtë nga zyra dhe kushedi se ku shkonte.

— A dini, z. SH! Kam dëshirë të kuvëndoј — vetëm të kuvëndoј — me personelin e këtij Pallati të Madh...

Shikon me buzëqeshje dhe, si i ri që është, i ri plot energji dhe vullnet, që pasqyrohet në fytyrën e tij, më thotë:

— Urdhëroni tek z. B. Flisni përpara me 'të dhe i kallzoni qëllimin tuaj...

Dhe unë, që z. B. të cilin gjer pardje e shikoja midis «përfaqësuesve» të popullit, tani do ta shoh prap në një tjetër detyrë të lartë.

I afrohem derës së tij, ku shkruan: «Sekretaria e Përgjithëshme», dhe duke trokitur lehtë, flas:

— Me leje?

(Gazeta «SHTYPI», nr. 25, dt. 12 Qershor 1937).

Desha të hyja në gjithë zyrat për të parë se ç'bënin tërë ata nëpunës kishin siguruar jetën e tyre me ndonjë mik të fortë... Desha të nxirrja jetën parasitare të «mehmurëve» që mirrin rroga të majme pa punuar. Fillova nga kryeministria dhe botova këtë pjesë të parë. Të nesërmen më thirri ministri i brëndëshëm dhe më kërcënoi pak a shumë me këto fjalë: «Ju bollshevikët, pasi s'kini punë vetë, u kini zili të tjerëve, u qani hallin kalorësve, doni të prishni aparatit shtetëror, po do t'ua thyejmë kokën, s'do të lëmë këmbë komunisti në Shqipëri. Të shitur te Moskovi!» Kështu, reportazhi, nuk u botua... (P.M.)

SHËTITJA...

Vendosa të dalë jashtë qytetit.

Shoku më pyet:

— Nga t'ja mbajmë?

— Ku të duash! Ku të na shpien këmbët...

Gjelbërime kudo. Kudo një këngë e heshtur këndonte një jetë të re. Dhe ne, midis grurit të rritur dhe gati të pjekur, këndonim këngën tonë të re. Një këngë pa vargje e pa melodi. Një këngë që mban notat e përjetësisë: heshtjen!

Atë heshtje, që vetëm të rrahurat e zëmrës plot shqetësime e përcjellin me dhëmbje të thellë...

Kishim heshtur. Shikonim herë tokën e rëndë, ngarkuar nga gjelbërimet e ëmbla, herë ja ngulnim sytë njeri tjetrit dhe pëshpritnim:

— Sa vënde të bukura që kemi!

— Sa afër u jemi dhe sa larg na duken!

— Po, na duken larg, se mëndja jonë është kredhur në pellgun e ëndërimeve për një jetë të ngatruar. Vështrimi ynë është ngulur larg e larg, në fushat e punuara prej dorës së tjetërkujt. Dhe këto vënde të bekuara po gjëmojnë nga kambana e heshtur e shekujve të perënduar, që përsëriten:

— Dora shqiptare, dikur do ta shtrëngojë me

mall këtë tokë, këtë baltë dhe do të bërtasë: «Kë-
jo është qënia ime!»

...Bilbilat ligjëronin. Ne të shtrirë nën hijen
e pemëve, lehtësoheshim aq sa fluturonim e flutu-
ronim mbi dheun tonë të magjepsur. Dhe prapë
ulehim të rënduar mbi grurin e porsapjekur.

— Ej, zotni! Mos e shkelni atë bereqet të shë-
njtë! Ju do ta hani. Po, ju, ju, zotni!..

Zëri i bujkut na trëmbi. Me të vërtetë na
trëmbi. Ishte i rëndë, i ngjirur, i prekshëm. E hu-
mbëm toruan. Heshtëm. Dhe ai na u afrua. Duket
se depërtoi në mendimet tona. Na shikoi me dhë-
mbje. Na foli:

— Mos u trëmbni, bre! Jemi vëllezër!..

(Gazeta «SHTYPI», nr. 27, dt. 17 Qershor 1937).

PËR 2000 FR. AR?

Me gjithë mënd shpreson të fitosh çmimin e parë? — Çudi!

Ti, o lumë miku, më duket se nuk je në vete. Të mungon një dërrasë! Ose flë i nanuritur në djep prej ëndrave djaloshare.

E ç'thua?

Ti do të fitosh, dhe «vargjet» e tua do të këndohen prej gjeneratave të së ardhmes, ë ?Ti kujton se me strofat e tua e përjetësive emrin tënd dhe flamurin kombëtar!

Ndënje disa orë ose minuta, këndove andej këndeje disa «hymne» të huaj, pastaj duke ëndëruar herë të 2000 fr, ar, herë famën, herë — ku di unë — fët e fët nxore në mejdan «Hymnin e Flamurit», Dhe pa humbur kohë ja dërgove «Komisionit». Dhe që atëhere ti ke humbur gjumin, qetësinë. Pret me padurim të dalin përfundimet. Je i sigurtë se «kënga» jote ka për të ndezur zëmrën e «Komisionit», ka për t'u ngjethur mishtë tërë atyre që do ta këndojnë dhe, me një zë e me lotë ndër sy, kanë për të thirrur: «Ja hymni i Flamurit! Ky ka për të ngrohur zëmrat e një fisi të përmëndur!»

Dhe ti këto i beson me gjithë mënd.

Çudi!

Nuk më thua, mor mik vëllai, ti si s'pate pak turp që guxove të shkaravitësh, dhe si pra? — Duke patur në gojë Flamurin? O lumë, a je ti në gjëndje të përkëdhelësh valavitjet e atij Flamuri, që ngjalli dhe që mbron nën hijen e vet një shtet të porsalindur?

A je ti i zoti të «këndosh» me pak vargje ëndrrat, idealet, shpirtin që ndizet e ndrit nën Flamurin kombëtar?

A je në gjëndje t'i futesh thellë zëmrës së fisit arbëror dhe andej, me fuqinë e vargut tënd, të shtosh të rrahurat e qënies dhe të ecjes së tij?

Ç'thua, pra?

A e ndjen ti atë dhëmbje të shënjtëruar, që lëkund themelet e shpirtit kur përmendet emri «Flamur?»

A të ngjethet mishi, kur dëgjon të oshëtijë tingulli i përvetësuar: «Rreth Flamurit ne të bashkuar?»

Apo në kokën tënde vlon me shqetësime numri i rumbullatë 2000?

Më pëlqen të ta them copë, se ti s'ke dhe kaq faj. Fajin e ka «adhurimi dhe respekti» yt ndaj Flamurit. Po ta dije ti se ç'domethënë «Flamur» dhe po t'i hyje thellë kuptimit të ndrimit të «Hymnit të Flamurit», atëhere patjetër nuk do të guxojë fare të radhitje fjalë bombastike pa kuptim, pa qëllim dhe pa vlerë...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 28, dt, 22 Qershor 1937).

KUSH?

Një poet dhe një fajdexhi shëtisin krah për krah.

Thotë poeti:

— Ç'ke atje nën sjetull?

Dhe fajdezhiu duke i shtrënguar «defteret» e tij të trashë përgjigjet:

— Këtu brënda janë «hesapet» e mi. Këtu brënda janë shkruar qindra mijra e mijra franga dhe tërë «punët» e mia... Mirëpo, as më thua, o mik i dashur, ti ç'ke atje nën sjetull? Ç'janë ato deftere?

Dhe poeti, duke shtrënguar librat e tij, thotë:

— Këtu brënda edhe unë kam hesapet e mia, domethënë qindra mijra vargje lirike që më ushqejnë.

— Oh, si, si? Të ushqejnë vargjet! Mos fol marrëzira tani...

— Të lutem, zoti fajdexhi, mos u çudit! Po, as më thua, zotrote ç'i do këto «hesape», ç'i do këta emra të shumtë që mbushin «defterët» e tua?

— Që thua zotrote, këtu brënda janë hesapet e parave. Para, mor mik! Para! Pa para nuk shkohet... Dhe unë, tani që do të shkoj në shtëpi, do të rri pak orë sa të bëj hesapet e fitimeve të ditës.

Pastaj do të përkëdhel disa «napolona» sa të mëzërë gjumi. Po nuk zura para me dorë, po nuk i pashë verdhushkat të grumbulluara, nuk më zë fare gjumi... Po ty, o lumë, si të zë gjumi. Si flë i qetë, kurse s'ke asnjë qindarkë në xhep?

Poeti shtrëngon më me fuqi librat e tij, heq krahun nga fajdexhiu dhe thotë:

— Dhe unë, po nuk këndova disa strofa, nuk flë i qetë, Më pëlqen që, çdo darkë, të shtrihem në shtrat dhe të lexoj vjersha të ndryshme, Ato më ushqejnë, më japin dritë, jetë!

Dhe, duke u ngjatjetuar, u ndanë. Njëri: me «paratë» nën sqetull; tjetri: me vjershat nën sqetull.

Njëri natën do të përkëdhelte «flori», ndërsa tjetri do të këndonte «vargje».

Që të dy jetonin... Po kush do të flinte më i qetë? Kush do ta bënte gjumin më të ëmbël? Kush do të mbyllte sytë me ndërgegje të pastër? Poeti, apo fajdexhiu?

Kush?...

(Gazeta SHTYPI, nr, 35, dt, 30 Qershor 1937)..

K O M E D I A

Burri — E dëgjove, moj shoqe, apo jo? Zonja Agushe prish shumë të holla për veshje, për mbathje të tepërta, për mobilje, për luks. Dorën e ka lëshuar shumë. Nuk i dhimbet leku... Jep kush i kërkon. Prish kur i teket:..

Gruaja — Mirë bën. Ajo shkon jetë. Nuk është si ne që mendojmë për të nesërmen. Pastaj, ç'i kuptuam kësaj jete gjithnjë duke menduar, duke vrarë kokën se mos nesër bëhet... gameti! Le të bëhet ç'të dojë. Tani që kemi, le të prishim...

Burri — Mirë m'i thua zotrote këto, po nuk mendon pak se si fitohen këto të holla.

Gruaja — Punë e madhe! Siç fitohen, kështu edhe prishen. Po t'i fitosh me djersë, do t'i prishësh me... djersë; po i fitove me fjalë, do t'i prishësh me fjalë...

Burri — Moj, ç'i do fjalët, po pa shiko zonjën Agushe se si katandisi me vajzat e saj. Ajo përpara qeshte, këndonte, mburrej. Tani e ka humbur to-ruan, se iu zbraz qesja, iu shit malli, iu shit edhe shtëpia...

Gruaja — Po pse? E gjora!

Burri — Sepse nuk mendonte për të nesërmen.

Gruaja — Oh edhe ti me të nesërmen! Ç'është kjo e nesërmja! Sot ke? — Jeto sikur ke. S'ke? — Jeto sikur s'ke! Ç'të bësh! Kështu e ka kjo jallane. Tërë puna qëndron te njeriu. Një që s'i trëmbet jetës, gjithnjë, herë mirë, herë keq, jeton. Tjetri, që trëmbet si ti, tërë kohën me ahe dhe vahe ka për ka shkuar. Dëgjon, apo jo?

Burri — O, të lumtë! Ti qënke trime! Po pse më kërkon e më shan e më qorton e më vërsulesh kur s'kam të të blej fustane të reja? Pse, de? Pse var buzët kur s'kemi para për të shkuar në plazhin e Durrësit? Pse s'bëhesh edhe ti trime?

Gruaja — Kështu e ka komedia?

Burri — Cila komedi?

Gruaja — Jeta jonë, pra!

(Gazeta «SHTYPI», nr. 38 dt. 3 Korrik 1937).

FALLXHESHA

— Dëgjo, biro!

— Ti, mor bir — të marrça të keqen — ke shumë siklet. Syri yt qan për një gjë, qan për një njeri, qan për një zëmër, qan për një punë. Po mos u bë merak, se për së shpejti do të qeshësh.

— Birô, ti ke shkuar një siklet të madh. Dhe zëmra jote pikon gjak. Ke, mor bir, një njeri që të do të mirën. Ai për ty, mor bir, bëhet theror. E ç'nuk bën për ty, mor bir, ky njeri... Mirëpo ke dhe shumë armiq! Janë disa që s'lënë gjë pa thënë për ty dhe të ndjekin këmba këmbës. Po njeriu që të mbron është i madh dhe me fuqi. Prandaj mos u bë merak...

— Ti, mor bir, do të kalosh një sëmundje të keqe. Dhe nëna jote ka për të qarë. Dhe një zëmër ka për të plasur. Dhe një shpirt ka për të vajtuar. Po ti, mor bir, do ta kalosh edhe këtë siklet...

— Ti, mor bir, do të martohesh me një vajzë të dëgjuar, që ka prikë të madhe, që ka sy të zinj dhe flokë të zeza, Ah, mor bir, se ç'bën ajo kur të sheh! Zëmra i dridhet dhe shpirti i fluturon...

— Ti, mor bir, ke një rrugë të gjatë. Do të kalosh detin. Dhe atje ku do të shkosh do të kesh siklete. Megjithatë, mor bir, ti do të shpëtosh...

— Ti, mor bir, shumë fiton, po xhepi yt është i shpuar. S'mban gjë brënda. S'ke për të bërë prokopi. . .

Dhe ky, me të dëgjuar këto fjalë, që rridhnin si ujët e burimit, pyeti fallxheshën:

— Mirë, moj e bekuar, ti si i merr vesh këto punë? Si e di ti se çdo të më ngjasë?

— Kjo është puna ime, mor bir!

Atëhere ai, që thoni ju, ngreh dorën dhe i këput një pëllëmbë të fortë në fytyrë, duke i thënë:

— Po këtë, e dije zotrote?

(Gazeta «SHTYPI», nr. 40, dt. 6 Korrik 1937).

EDHE UNË NJOHA NJË NJERI

- Të njohësh një Njeri, nuk është kollaj!
— Sidomos kur s'ke njohur vetveten.
— Se që të njohësh tjetrin, duhet të njohësh më përpara veten tënde.
— More vesh?
— Sa zor është t'i futesh tjetrit në zëmër, në shpirt!
— Sa zor është të thuash se filani është kë-shtu apo ashtu!...
— Megjithatë, unë besoj se njoha një Njeri.
— Kur flet, më duket i ëmbël! Kur këndon, më pëlqen! Kur më shoqëron, më qan hallet, më zbraz zëmrën. Dhe unë them: «Sa i mirë që është! asgjë nuk më fsheh!» Dhe sytë e tij, dhe pamja e tij, dhe «tërë ai», më duket aq i mirë, sa kurrë nuk më bie ndërmënd ndonjë dyshim. Dhe unë i flas. e shoqëroj. i zbraz barkun, i prek plagët, e dua me zëmër, se e di që Njeriu me të cilin shoqërohem është ai që njoh, domethënë tipi që pajtohet me mua.

Kur dëgjoj keq për 'të, hidhërohem e grindem me këdo qoftë. Kur vjen rasti e mburr, e lavdëroj me të drejtë, E ndihmoj, e këshilloj, e ruaj se më do dhe e dua.

Dhe jam i bindur se e njoh dhe më njeh:

Mirëpo, kjo jallane ka taksirate: Sa herë ga-bohet njeriu! Sa herë kur njeh një njeri kënaqesh, dhe sa herë dëshpërohesh se «njeriu i njohur» të del i kundërt! Të del i pabesë, gënjeshtar! Dhe atëherë mallkon veten se s'qënke i zoti të njohësh: asgjë! As edhe veten!

— Sa veta besojnë kollaj, sidomos femrat! Çdo fjalë zë vënd në zëmrën e tyre! Çdo nënqeshje shqetëson shpirtin e tyre! Ah, sa keq! Sa njerëz ka kjo botë e shkretë! Dhe sa zor është që t'i njohësh! Se ndryshe tregohen, ndryshe janë. Dhe me ç'mjeshtëri e ndrojnë lëkurën, o Zot!

— Megjithatë, edhe unë njoha një Njeri. Më duket i singertë. Dhe kështu dua ta besoj. Dhe, kushedi, në ardhhtë ndonjë orë e ligë, që bota të më thotë se «filani» s'është ashtu siç tregohet, unë nuk do të besoj njeri. Do të vazhdoj ta dua si gjithnjë. Gjersa të më coptohet zëmra...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 44, dt. 10 Korrik 1937)

DO TA QAJ...

- Të lutem, qaje me lot!
— Nexhi! Bjeji mirë të shkretës violinë! Qaje me lot!
— Mos u bë merak, bre! Ç'ke ti, do t'a qaj...
— Usta, ndreqe bukur shtëpinë!
— Flij i qetë, se do ta qaj me lot...
— Nënë, vishe mirë nusen!
— Birô, do ta qaj...
— Ore, berber, qethi mirë flokët! Qaji me lot...
— Kolo, Ndreo... Shkruaje mirë atë reportazh të jashtëm dhe sidomos ngjarjet kino-japoneze! Qaje me lot!
— Ore! Ti që jeshë në dasmën e filanit, bëju një përshkrim të mirë valleve të bukura...
— Do t'i qaj me lot...
Dhe shko tutje...
Gjithnjë «qarja me lot» shpreh kulmin e përsosjes së çdo pune.
Kur të thotë tjetri: «Do ta qaj me lot», domethënë do ta bëjë atë punë aq mirë, sa nuk tregohet dot.
Mirëpo, ç'djallo shprehje është kjo e jona! Në vënd që t'i thuash tjetrit: «do ta këndoju» ose «do ta kënaqu», i thua: «do ta qaj!»

Çudi është kjo shprehje. Po sidoqoftë, «qarja me lot» që, padashur, pasqyron thellësitë e shpirtit, më hoqi vrejttjen pardje, kur në Plazhin tonë i tha garsonit një prind me katër a pesë fëmijë, që ishin duke mbaruar së ngrëni në tryezat e «banjave popullore».

— Pa na bën pak llogarinë, mor djalë i mbarë!

— Ç'ke ti, zotni! Do ta qaj me lot!

Dhe me të vërtetë e qau me lot. Kur i dha listën, prindi i gjorë hap sytë dhe shikon. E ç'të shikojë, pa! Lere mos e nga! Ai kujtonte se fëmijtë do të hanin pakëz. Nuk e dinte që deti të bën të hash nja dhjetë herë. Prandaj, me të hedhur syrin në fundin e listës, shikon një herë garsonin, që me shpejtësi të madhe lëvizte dhe, duke e paguar, i thotë:

—Me të vërtetë e qave me lot!...

(Gazeta «SHTYPI» nr, 54, dt. 22 Korrik 1937).

MISËR...

— Misër i pjekur, zotni!

Dhe xha Duli është mbështetur në murin e rrugës. Ka përpara tij një grumbull misrash të njomë dhe mangallin e tij, ku i radhit dhe i kthen herë andej, herë këndej, tamam si mishi i pjekur.

— Si venë punët, mor xha Dul?

— Ç'ka, ç'ka!...

— Po sa i ke këto?

— Dy, një çerek leku! Katër, gjysëm leku!

Dhe i kthen. Nuk shikon njeri. Veç këndon një fletore të muajit maj, të cilën e mban për të mbështjellur misrat e pjekur.

— Ja, shiko. mor zotni! Dëgjo se ç'thotë gazeta: «Këtë vit, misri do të bëhet me bollëk. Sihariq i madh për popullin». Domethënë, që thua ti, këtë vit do ta hamë badjava bukën? Domethënë, morë zotni, ky vit është i mbarë për ne? Domethënë, që edhe unë do ta blej xhaba misrin dhe do të fitoj diçka edhe unë, me gjithëqë jam plak edhe kënaqem me pak...

Ai fliste dhe unë mendoja fushat e punuara, të cilat, përveç që u vaditën me djersë, po edhe Zoti i kënaqi me shiun e fundit. Kujtoja bisedën që bëra me bujqit. Dhe në veshët e mi tingëllonin

akoma fjalët e fundit të tyre: «Mos kini frikë, bre, se ky vit qënka me të vërtetë i mbarë!» Dhe përgjigja e heshtur e shokut tim me kënaqësi që shtrihet me mall në mes të grurit duke më shikuar me dhëmbje, më humbi bisedën e xha Dulit, i cili vazhdonte të fliste:

— Misër i pjekur!

— Misër xhevahir! Misër flori! Misër me shije!..

Dhe mora një. E hëngra. E shijova. Dhe duke ecur përsërita:

— Misri na rrit kryelartë. Misër, shpirti ynë, misër, që hijeshon fushat shqipëtare, që përkëdhelet prej dorës sonë, që bluhet nëpër mullinjtë ku gurgullon uji i ftohtë i burimeve tona; misri që piqet në vatrat, ku ndihet kënga jonë, misri që mbërthehet me mall prej dorës sonë, misri që adhurohet prej nesh, është burimi i gjakut tonë, është qënia jonë...

Dhe do të vazhdoja të këndoja misrin, po t'ë mos kishja parë edhe një fëmijë të vogël që rrinte në një kënd të rrugës dhe bërtiste:

— Misër i pjekur!

(Gazeta «SHTYPI», nr. 56, dt. 24 Korrik 1937).

LUTJA

«...Duke qënë, pra, se jam shumë ngushtë, ju lutem më shpëtoni edhe këtë herë me disa franga.

Shpresoj se fisnikëria juaj nuk do të më lerë në baltë, po do të ketë mëshirë për mua!»

Dhe tjetri që ka dëgjuar se kushdo që dëshiron të zërë punë të mirë, vete tek një shkronjë, i jep ndonjë frangë dhe merr lutjen...

Kur e këndon çuditet edhe vetë. Se shkronjësit vetëm emrin i tha edhe punën që kërkon.

«...Jam kryetari i dhjetë njerëzve, të cilët vetëm nga duart e mia presin.

Prandaj, shpresoj se do të më emëroni gjithëkundi».

— Mirëpo unë vetëm nënën kam, mor zot! Pse ke vënë që kam dhjetë njerëz!

Pastaj, ç'thua ti: «Çdo punë?» — E ç'thua, mor lumë! Unë vetëm tagrambledhës dua. Dhe ti e vure pas kokës sate, duket, e? Hiqi këto, a paç belanë, dhe shkruaj ç'të them unë...

— Atëhere do të paguash edhe pesë lekë të tjera, se kështu është e drejta ime.

— Mor, unë s'po të paguaj asnjë kacidhe, po s'ma bëre lutjen siç e dua vetë...

Mbasi shkronjësi e pa ngushtë punën, foli:

— Hajde se s'po ta prish qejfin. Folë, pra!
Dhe ky nisi të tregonte jetën e tij dhe ëndrën e vetme që kishte:

Të martohej. I duheshin të holla. Dhe keto, në fshat, kurrë nuk do t'i bënte. Vetëm në ndonjë nëpunësi të vogël dhe me ekonomi do të kursente nja dyqindë ose treqindë lekë që të martohej.

— A ke më! — i tha shkronjësi.

— Po, mor vëlla! Shto:

«Dhe pesë lekë më tepër dua t'i jap këtij që më bëri lutjen, se tani s'kam me vete asnjë qindarkë! . . .»

(Gazeta «SHTYPI», nr. 60, dt. 29 Korrik, 1937).

NGA ÇENGELI NË... TABUT!

— Ç'ka ngjarë dje në mes të tregut? Tërë esnafët ishin grumbulluar rreth pusit të pazarit të miellit! Dhe bërtitnin :

— Çengelin ,litarin, se vallahi u mbyt!

Alarm në tërë tregun. Lanë jorganët, kungujt, sqeparët, teneqetë, miellin, plaçkat në shesh dhe vraponin rreth pusit.

— Ç'është, bre!

— Çengelin, litarin, se vallahi u mbyt!

Dhe që nga fundi i pusit dëgjohej zëri prekës i të gjorit Bajram.

— Ho-ho Vdiqa! Opingat!... Koka!

Ndërsa grumbulli ishte bërë i madh, çengeli po ngulej në brekushet e Bajramit, që notonte gati i vdekur mu në fund të pusit.

— Hopa! Hiqni, bre se qënka i gjallë!...

Kur po e nxirrnin në dritë kufomën e gjallë të të ziut katundar, i cili u fut në pus për të marrë opingat që i kishin rënë, aty afër për çudi ndodhej karrua e zezë e Bashkisë, që ndjek rrugën e... Bamit.

E rëmbyen nga qafa, i hodhën çengelin dhe e shtritën në karon e tabuteve.

Porsa e pa karocieri, hosh kalit dhe rrugën e zakonëshme. . .

Bota kur sheh atë karro të re, tmerohet. Ndal-
let dhe heq kapellën, duke pëshpëritur: «Ndjesë
pastë! . . .»

— I shkreti, — thoshin esnafët, — humbi jetën
për opingat dhe vete i zbathur në atë jetë.

Mirëpo ç'ngjau, pa! . . .

Duke ecur rrugës së Bamit, karrua hidhej aq
shumë nga gropat, sa që i gjori Bajram erdhi në
vete.

Çon kokën dhe shikon!

E ç'të shikojë ,pa! Gjëndej mbi karron e vde-
kjes!

Vërren andej këndej njerëzinë që hiqnin ka-
pelat, pastaj hedh sytë në këmbët.

— Opingat! Opingat! Bërtet me një zë që ka-
rrocierin e trëmbi dhe e la të shastitur.

I ngjalluri, plot me plagë, thëriste: «opingat»,
ndërsa karrocieri pyeste:

— Mor, ku ta shpie tani këtë?

— Në spital! — i bërtiti një gushëkuq. . .

Dhe Bajrami kundërshtonte, se la opingat në...
pus!

(Gazeta «SHTYPI», nr, 61, dt. 30 Korrik 1937).

NJE VAJZË SHKRUAN

«Unë s'di as me këndue mirë, as me shkruë. Por një shoqe po na ban këtë letër, që të mirrni vesh se mue më kanë fejuë me një plak gjashtëdhjetë vjeç. Dëgjoni apo jo? Mua, një gocë gjashtëmbëdhjetë vjeçare, po më japin një goxha plak. E tani ç'të baj unë?

Si të sillem për mos me u martue me atë plak?

A mundeni me më këshillue?

Ju lutem shumë, ju qi shkrueni, qani hallin tem, si dhe të motrave të tjera tona që, ma mirë të mbyten në lumë, se sa të jetojnë me një burrë të moçëm.

...Unë s'di ç'ka më thanë mâ, por ju që dini e që kuptoni se ç'domethanë martesë e këtillë, mos përtoni me shënue mjerimet tona.»

Letra vjen nga veriu i Shqipërisë. Dhe kup-tohet fare kollaj nga shkrimi. Mirëpo tani, ç'të thotë njeriu mbi këtë çështje! Mos ka ngjarë vetëm një herë, dhe të falet, ose të mos përmendet.

— Oh, jo, moj motra ime!... Këto ngjasin edhe në vëndet më të qytetëruar, me ndryshim që atje vajzat dinë edhe të rrojnë.

— Ti kërkon udhëzime, shpëtim. Dhe shpëtimin tënd ta ka siguruar ligja e re... Doemos se ti nuk e di, po ja ku ta përmënd unë:

— Po të shkosh ndonjë ditë me «të ndershmin» burrin tënd në zyrën e gjëndjes civile, atje do të pyesin: «E do këtë për burrë?» Atëhere ti, moj motër, hape gojën pa frikë dhe fol kështu: «Unë e dua dhe e nderoj si një plak të ndershëm, po jo si burrë!... Jo!... jo!... jo!...

Dhe po the kështu në zyrën e Shtetit, dije se ai s'ka se ç'bën më. Në tavan le të hidhet, le të pëlcasë, ty s'të merr dot! Ti do të gjesh shokun tënd që e meriton. Se martesë jote nuk domethënë në vdekje, po jetë.

E di, moj motër, se s'ke guxim. Ke frikë. Po në të tilla raste duhet të mos trëmbesh. Dhe ti ke një mbrojtëse shumë të madhe, që asnjë nuk e mund ligjën e re...

Më kuptove?

Ndryshe... humbe!

(Gazeta «SHTYPI», nr, 63, dt. 3 Gusht 1937).

DRAMA IME

— Kam kohë që përpiqem të shkruaj një dramë! Një dramë me një temë aq të lartë, sa koka ime e vogël ka nisur të blejë andej këndeje brumë, se i imi s'mer vesh nga kjo temë që dua të zhvilloj. E ç'them unë, pa! Një temë që nesër do të nderë zëmrat e një brezi të ri, që do të frymëzojë një gjeneratë të re.

— Mirëpo, përpiqem ditë e natë, që këtë dramë ta bëj aq të përsosur, sa emri im të përmëndet brez pas brezi e shekull pas shekulli, jo vetëm me paraqitjen artistike, po në frymën, në brendinë, në qëllimin e shënjtë që do të ketë!

— Dhe jap e marr, si i çmëndur, që të fitoj në këtë përpjekje, që bëhet për famë edhe për «*materia prima*».

— Pyes njërin, pyes tjetrin, sidomos maestron tim, dhe që të gjithë më japin fjalën se do të përkrahem me mish e me shpirt prej tyre edhe prej historisë.

— Mirëpo unë nuk kam pyetur personin më kryesor që duhej me doemos pyetur: vetveten.

— Se po ta pyes atë, e di se ç'do të më thotë. e di se ç'do të më detyrojë të bëj.

— Doemos do të më pëshpëritë me ankim: «Pse nuk bën dramën e jetës sate, që është me të

vërtetë një dramë plot peripetira të njohura edhe prej gurëve! Pse kërkon të bësh një dramë që s'ka të bëjë fare as me jetën tënde, as me qëllimet e tua, as edhe me shpirtin tënd! Ku e ke hallin? Mos kërkon vallë që me bërjen e dramës tjetër, do të zhdukësh gjurmat e dramës së vërtetë të jetës sate? A, sa i vogël që je, që kërkon të mbytësh dramën e hidhur tënde! . . .»

— Dhe me gjithë këtë, unë s'dëgjoj njeri. Dramën jam duke e mbaruar dhe jam i sigurtë se do të çmohet prej miqëve të mi, që më ngjasin mua. . .

(Gazeta «SHTYPI», nr. 65, dt. 5 Gusht 1937),

NGA KOKA NË KËMBËT!

— E ç'nuk bën nevoja, mor vëlla! — Më thoshte shoku duke më kallzuar këmbët. Kishte një palë këpucë të zeza. Ja zë me dorë; ishin të bëra prej një lëkure të butë!

— Nga se janë bërë këto?

— Pse, nuk i sheh?

— Jo, nuk i shquaj dot!

— Ha, ha! Shihi ,shihi! Këto gjer dje ishin në kokë dhe sot janë në këmbë!

— Si?

— E pse, nuk i sheh? Këto janë bërë prej festeve të zeza! I kam blerë në Elbasan, Dhe, siç e di, atje kishin shumë feste të zeza, sidomos tregëtarët, Dhe, me humbjen nga qarkullimi të festes, ç'do të bëheshin gjithë ato qindra mijra qylafe? Të dheshin në lumë? Të digjeshin? Të çireshin? — Ç'të bëheshin, pra?

— Hë de, ç'të bëheshin?

— Shqipua s'lë gjë jashtë përdorimit. Po këtë radhë, me merhumin «qylaf» u gabua pakëz, apo jo?

— Pse?

— Ja sepse. Në vënd që qylafi të mbahej si kujtim i kohëve të përmendura, u dënua aq keq sa,

nga koka që ishte, u vu në këmbë. U pre, u bë këpucë dhe mengadalë po bëhet... dhé.

— Shumë keq!

— E pse?

— Sepse një gjë që mbahej në kokë kaq shekuj, si djall u shtyp me këmbë për pak muaj?

— E këto ka koha. Por sidoqoftë kjo gjë nuk duhet të të çuditë, mbasi në s'lëmë asnjë send jashtë përdorimit. Pa shikoi këpucët se sa të bukura që janë! Të pëlqejnë? Bën edhe ti po të duash. Do të kënaqesh.

— Doemos, se përpara kjo cohë e zezë, domethënë qylafi, mbulonte kokën, ndërsa tani mbulon këmbët...

(Gazeta «SHTYPI», nr, 67, dt. 7 Gushi 1937).

Ç'THOTË NJË KOLEG...

«Dy gazetarë kinezë në frontin e Kinës, një poloneze dhe një kanadez në lëmet luftarake të Spanjës, paguan detyrën me gjakun e tyre. Të tre të parët me vdekje, dhe me prerjen e këmbës i katërti. Mjafton ky gjak për t'u kushtuar këto rreshta kolegëve tanë dëshmorë. Sa vjellin fjalë të liga, me ironi dhe tallje, për gjithë ata që shkruajnë me djersë dhe me gjakun e tyre ngjarjen e ditës, le të ndalen përpara tre arkivoleve dhe këmbës së prerë. Asnjëri s'do t'u kërkojë që të vendosin kurora mbi varret e këtyre heronjëve. Profesionin nuk është heroizëm. Është diçka më tepër dhe më njerëzor se heroizmi. Është detyrë. Dhe njerëzit që i hodhi përdhe lufta në krye të detyrës, le të na gjejnë pakëz minuta... gatitu.

Heroi ndriçohet nga feneri i besimit, misionari ecën drejt idealit të vet. Gazetarin e përvëlton dhëmbja e punës së tij. Dhe puna e tij nuk është as floridhënëse, as e mërzitëshme, as edhe e kollajëshme. S'është gjë për ata që e lenë me kohë këtë profesion, po është e zorëshme për ata që i qëndrojnë besnik.

Kërkon shumë, jep pak. Punëtori i shtypit nuk ka atë kënaqësi morale që ka shkrimtari ose

cilido krijonjës. Megjithatë, edhe ky krijon. Vetëm pakëz orë rron pjella e tij. Dhe kur kalon dita, pjella e tij bëhet plaçkë mbështjellëse dhe, Zoti na ruajtë... bëhet edhe më... keq! Kështu gazetari ditën tjetër të vdekjes së tij harrohet. Ah, mjerisht s'jemi të gjithë të famshëm. Shkencëtari, shkrimtari, inxhinjeri, artisti, do të qëndrojnë para veprës së tyre dhe do të kënaqen. Gazetari s'ka kohë. Sepse në mëngjes duhet të përgatitë veprën e tij për pasdreke, dhe pasdreke veprën e së nesërme. Luftë vrapimi është jeta e tij dhe, në fundin e rrugës, është edhe fundi i qënies së tij, gjëndet harresa. Edhe ky ndihmon në ngrehjen e faltoreve. Po turmat që do të përulen nëpër faltore, kurrën e kurrës nuk do ta kujtojnë. Thonë se shtypi është zëri i njerëzimit. Dhe zëri ndihet në tërë anët e rrozullimit, entuziazmon, ngreh, qetëson, prin drejt brigjeve të mira ose të këqija. Mirëpo njeriu që nxjerr këtë zë, humbet pas... mikrofonit.

Ka të drejtë Zola, që gazetarin e quan kaminë. Dhe ankohet se flagët e tij i ushqen kjo kaminë pa llogari. E ku ta ngopë? Të tëra i djeg, i humbet: talent, kulturë, djalëri, shëndet. Të gjitha, përveç zëmërës. Dhe kjo zëmër, që nuk numëron as lodhje, as ecje pa pushim, as rreziqe, as familje, as pleqëri dhe mbetet kurdoherë e virgjërt dhe e palodhur, qëndron tamam si atëhere që ndjen të rrahurat e para të profesionit të saj.

Kështu do të rrihte edhe zëmra e kolegëve tanë, kur një darkë, papritur, u këshilluan dhe u ngarkuan për të shkuar në front.

— Për pakëz duhet të shkojmë...

Nuk ka kohë për përgatitje. Valice, fëmi, gra? Mos i përmëndni në tryezat e redaksisë, sepse këto

gjëra radhiten në faqet letrare dhe që të gjithë do të qeshin mbi kurriz tuaj. Gazeta s'ka kohë dhe nxitohet, se edhe publiku i saj s'ka kohë, nxitohet. Këndonjësi, porsa të hapë fletoren, do që redaktorin ta gjejë në vëndin e ngjarjes, Në vëndin e vrasjes, të mbytjes, të luftës, të zjarrit... të vdekjes. Kërkon që prej shtyllave të fletores të dalin flagë, të bërtasin të mbyturit, të flasin kriminelët, të tërhiqen zvarrë trupa të gjakosur, të lartësohet ty mi i topavet, të ndihet krisma e bombave... Me sa mundime, me sa therori do të bëhen gjithë këto, vetëm e vetëm për të përcjellur flagën tënde, o i dashur këndonjës!

Me kodakun, mbi sup, gjetën të vdekur polonezen Gerda Taro, një vogëlushe flokëverdhe që sapo i kishte mbushur të njëzetepesë pranverat. Shënimet e tyre, që i mbanin të shtrënguar në dorë, i kishin të dy gazetarë kinezë, midis gjithëtrinjve të tyre të ngrirë. Dhe kanadezi, porsa hynte në derën e spitalit, kërkonte kartë e kalem që t'i dërgonte lajme telegrafike fletores së tij, që priste ngjarjet e luftës. A kini shëmbëlla të tilla profesionistësh të ndryshëm, me kaq dashuri në punë dhe me kaq besnikëri në detyrë?...

Nuk ka, jo, mor i dashur koleg, por sidoqoftë, uganjëherë le të ngushëllohemi vetë, duke shprehur atë që ne rrallë na bie ndërmend. Se puna jonë me të vërtetë është një kaminë që djeg, hem shëndetin, hem rininë... përveç zëmrës sonë...

(Gazeta «SHTYPI», nr, 70, dt. 11 Gusht 1937).

HËNA E RE

Pa pandehur pashë hënën e re.

Dhe ç'm'u kujtua? — Ah, se ç'm'u kujtua!

M'u kujtua «hëna e re», që shikoja atje në fshat, shumë vjet më parë, atëhere kur gjyshja më jepte një grosh dhe më thoshte: — Me njërën dorë zë veshin, me tjetrën afro groshin në gojë dhe puthe duke thënë: — «Kurrë mos më mungofshin të hollat!»

Kështu desha të bëja dhe unë dje, kur pashë hënën e re, që si rreth i florinjhtë, si një drapër ari atje në fund, mengadalë po humbiste. Futa dorën nëpër xhepe, po s'gjeta gjë, përveç një misri. E mora misrin, e putha dhe duke hequr veshin, thashë dhe vete: «Kurrë mos më mungofsh!» Por, ah! Ah, se hëna kishte humbur pa mbaruar mirë fjalët...

Se ç'sjell hëna e re! Fat, mjerim...

Sidomos hëna e gushtit, që sa qartë shëndrit në qiell.

Tani e sheh këtu të re, dhe për dhjetë ditë e sheh të plotë nëpër udhëtime të largëta! Dhe ç'të kujton, pa! — Lëri mos i nga kujtimet e hënës! Veçanërisht kur e shikon me mall dhe kur gjëndesh i lënë nëpër valët e ietës.

— Ja edhe hëna e re! — më thosh një shok.
— Sa ndryshime sjell! Sa dëshpërime, sa gëzime!

— Mëgjithatë vjen hëna tjetër dhe ndrojnë këngët e jetës. Kështu e ka kjo jallane. Është pikërisht si hëna. Herë e re, herë e plotë, herë e humbur, herë e qartë.

— Dhe a e di ti, që hëna më ngushëllon, se duke e parë, harroj jetën e ditën dhe fluturoj lartë e më lart, gjer atje ku nuk ndihet vaji i njerëzimit.

— Edhe mua më kënaq, se më kujton kohën e kaluar, kur gjyshja më thoshte:

«Hëna e re, jetë e re!» Dhe unë tani, që pak a shumë e kam parë qindra herë hënën e re, shtoj:
«Më mirë është që njeriu të mos e shikojë fare hënën e re, se do të detyrohet të puthë« para» dhe në rast se s'ka, atëhere do të puthë... misrin!»,
në e pastë dhe Atë!

(Gazeta «SHTYPI», nr, 71. dt. 12 Gusht 1937).

SA JANË?

— Një, dy, tre, dhjetë, njëqind, njëmijë!

— E ç'janë këta?

— Pse, nuk i ndjek ti listat e patriotëve që dalin nga çdo krahinë? — Oh, ka kohë që, kudo, në çdo kënd t'Atdheut tonë, gërmohet historia e Rilindjes sonë kombëtare dhe përmenden emrat e atyre që punuan dhe ndihmuan për çlirimin tonë nga të huajt.

— Domethënë, që thua zotrote, tërë ata që janë përpjekur për arritjen e 28 Nëntorit 1912, tani do të kujtohen, ë?...

— Doemos po, se tani që kremtojmë 25 vjetorin e çlirimit tonë nga të huajt, duhet t'i dijë tërë bota shqiptare emrat e atyre që therorizuan jetën, pasuritë, qënien e tyre. vetëm e vetëm për Shqipërinë.

— Mirëpo, a janë shumë këta?

— Unë nuk i di, po simbas thënieve dhe disa botimeve, nuk janë me mijra, de! Mund të jenë dhjetë, njëzetë. Ja, përshëmbëll, nuk e njeh ti Naimin, Ismail Qemalin, Jani Vreton, Petro Nini Luarasin, Vaso Pashën, Spiro Belkmenin, Mihal Gramenon, Çerçizin, Ceno Sharrën, e të tjerë, e të tjerë?

—Oh, këta i di edhe çilimiu në djep!

— Doemos, se vëndi ynë është i vogël dhe çdokush njihet.

— Mirëpo, as më thua, kam dëgjuar se janë shumë emra. Shumë, shumë.

— Aq më mirë! Se sa më tepër të jenë, aq më tepër do të krenohemi, se do të themi që edhe ne kishim atdhetarë të shumtë, të cilët me mundime dhe me sakrifica, prunë ditën historike të Vlorës, ku u shpall pavarësia jonë.

— Unë s'të them të më tregosh historinë tonë, se shyqyr Zotit e di, por të lutem kallzomë sa janë këta patriotë tanë?

— Këta, as unë nuk i di. Do t'i shohim ndonjë ditë të radhitur në lista të gjata prej komisionit të 25 vjetorit të indipendencës sonë...

(Gazeta «SHTYPI», nr. 72, dt. 13 Gusht 1937).

«BARBIERE DI SEVIGLLA»

Tre kandidatë-mjekë bisedojnë: rrahin probleme të ndryshme kombëtare.

Dhe kokë për kokë, mengadalë, afrojnë filxhanet e kafesë së zbratur, ku hera herës përpiqen cigaret e mbajtura mbi disa pipa kokalli:

Hija e Bankës që po ndreqet, ka zënë «Kursalin» dhe fjalët e ngadalëshme të të tre studentëve humbasin nga rrahja e çekiçit që ndreq sheshet e Tiranës.

— Duhet të përgatitem mirë për provimet!

— Këtu njeriu nuk ka mundësi t'i shtrohet punës me zëmër!

— Është vapa, është...

— Ç'është shkaku?

— Oh, lere, pash Zotin! Po belaja është se edhe bursa na u pezullua. Mirëpo jemi të sigurtë se mbase Ministria të marrë vesh mirë se si qëndron puna, do të na japë të drejtën tonë...

Gjishtrinjtë e duarve me «tempo» qëllojnë tryezën dhe biseda ndron tonin:

— Afron koha të mbarojmë mësimet. Edhe një vit na mbeti. Pastaj do t'i përvishemi punës sonë. Sa nevojë ka vëndi për neve, sa dhëmbje kemi për

këtë truall, që na rriti me djersën e popullit, na përgatiti e na bëri të vlershëm... Nesër, kur do të ushtrojmë profesionin tonë, do të gjejmë doemos pengesa, po ne, si të rinj që jemi dhe si djem të mirë të këtij vëndi, të cilin pak a shumë e njohim, nuk do të dëshpërohemi...

— Çështja qëndron këtu, mor vëlla: përpara të mbarojmë, pastaj mendojmë!

— Ah, jo! Tani që jemi këtu dhe që kemi kohë, duhet të bisedojmë dhe të rrahim mëndjen, të paktën pak orë ditën, për të nesërmen tonë...

Këta bisedonin dhe të rrahurat e gjithëtrinjve ndiheshin më tepër, mbasi një këngë e njohur ua mori mëndjen doktorëve-kandidatë.

«Ha-ha-ha-hahahaha-ha!...» një violinë e marrë po lozte në radio «Barbiere di Seviglia» aq mirë, sa, jo vetëm që ua zhduki problemin e së nesërmes, por i bëri tre të rinjtë të këndonin mengadalë këngën, që kushedi se ç'u kujtonte, ose kushe-di se ku i shpinte. Mbase notat e shpejta të violinës i largonin nga hieja e thellë e ndërtesës së Bankës, që kishte rënë mbi «Kursalin» e qetë dhe i shpinte atje ku jeta lë gjurmë të paharruara. Dhe sidomos në zëmrat e të tre të rinjve, dy prej të cilëve shpesh herë përkëdhelen prej dorës së muzës të poezisë.

(Gazeta «SHTYPI», nr, 73, dt, 14 Gusht 1937).

NËN HIEN E MINAREVET...

Mesditë!

Vapë e madhe!

Rrugët e Kryeqytetit rrallë e tek shkelen prej këmbëve të ndonjë kali që tërheq karrocën... që ecën e ecën duke lëshuar një potere — që prish qetësinë e ... pazarit.

Ora e madhe tingëllon rëndë, ndërsa nga maja e minareve del një zë prekës, që lutet ndaj përrëndisë...

Dhe njerëzia e qetë është mbyllur nën strehën e shtëpive të ulta, ku pjergulla të shumta janë përndarë pa frikë.

Vetëm nën hien e xhamisë së Vjetër, një botë e tërë, bota që nesër do t'i kujtojë me nostalgji orët e qeta që kalon tani atje, është shtrirë dhe pa asnjë kërshtëri vëren ngandonjëherë muret e vjetra që i rrëzon çekiçi.

Dy qiparisa shekullorë kanë lëshuar një hie të thellë dhe nën to, bota e xhamisë së Vjetër vazhdon ritmin e zakonshëm të saj:

Disa janë shtrirë mbi gurë dhe mbase ëndërojnë katundet që lanë atje larg... Opingat i kanë vënë nën kokë dhe bri tyre shquajnë trastat e zbratura. S'duan të dinë fare se ku gjënden. Dhe asqë kanë ndonjë fije frike, se ata e dinë që në qytet... njerëzia është e urtë... dhe s'i trazon njeri!

Disa kanë blerë një bostan, i janë grumbulluar, e kanë çarë dhe e hanë me shije dhe me një uri të zakonëshme për ta...

Nja katër a pesë muratorë — siç duket nga fshatrat e Dibrës — ndajnë ca të holla. Këmbë kryq, vëzhgojnë paratë që me radhë u hidhen në kësulata e vendosura së prapthi. Asnjëri nuk flet, përveç *ustait* që numëron: «Një unë, një ti, një ti, një ti...»

Disa të tjerë kanë rrethuar një «fallxheshë» dhe duke qeshur e të hutuar, i dëgjojnë fjalët që i burojnë si ujët e kroit të fshatit...

Pak më tutje ndihet tingulli monoton i kovës që me ngashërimë ngrihet nga thellësitë e pusit, nga duart e thata të njeriut të perëndisë, i cili orë e çast mbush depon e burimeve, ku fanatikët venë e marrin avdesën e zakonëshme...

* * *

Mesditë!

Vapë e madhe!

Të rrahurat e kazmës mengadalë rrëzojnë muret që rrethojnë xhaminë e Vjetër dhe hieja e thellë, pak nga pak, shkrihet dhe zëvendësohet prej diellit përvëltonjës.

Disa tela të rrëzuara, detyrojnë udhëtarët e shpejtë t'i shtëmëngen rrugës që ndreqet dhe të çajnë mespërmes botën që jeton nën hien e minaresë së xhamisë së Vjetër. Dhe që të gjithë vrapojnë e vrapojnë pa vëzhguar fare se ç'botë jeton atje nën hien e minaresë së heshtur. As edhe qiparisat e mëdhenj që qëndrojnë atje me shekuj, besoj se nuk i sheh njeri. Sa keq e sa mëkatë!

Të shkojë tjetri andej dhe të mos qëndrojë një çast, vetëm një çast, sa të vërejë se ç'bëhet atje, ku një botë e tërë lëshon me agoni psherëtimat e fundit të saj!

Dhe plot çudi sheh se oborri po priset dhe sheshi plot hije, ku gjente prehje me vjete një pjesë e botës sonë, tashti po bëhet lulishte.

Punëtorët, me nxitim, thyejnë gurë. Dhe lopata po nxjerr dheun nga vijat e thella, që i përngjan varrit të hijes së qiparisave.

* * *

Mesditë!

Vapë e madhe.

Djersa e krahut të palodhshëm që ndreq, që shtron dhe që rrëzon mure, vadit me nder lëmin, që nesër do të mbillet me lule.

Dhe bota e shtrirë nën hijen e minaresë, e çuditur, vëren se streha e saj bëhet rrugë, rrugë ku do të shkelin këmbët e një gjenerate të ndritur.

Ora tingëllon, dhe prap ndaj qiellit lëshohet një zë lutës, i cili, nga maja e minaresë, lajmëron besnikët se erdhi koha e punës.

Dhe ky zë humbet nga zhurma e qepenave që hapen me nxitim, si dhe nga ajo e një makine të rëndë që shtyp gurët e rrugës, që shtron koha e re. Dhe era e Bashkisë mengadalë lëkund degët e dendura të selvive, duke lejuar dritën të depërtojë gjer në lëmin ku gjëndet e shtrirë bota e vogël, por besnike ndaj kohërave të kaluara, e cila, pa dashur, rrëmbëhet prej valës qytetare.

Shikon se muret ranë.

Shikon se drita mengadalë bie.

Dhe fallxhesha vazhdon të tregojë fatin e kë-

saj bote: «Erdhi dita, thotë, që të vini kapele dhe të bëni punë të mbara. Dhe nesër do të bëheni më mirë. Do të bëni shtëpira, do të bëni prokopi, se një jetë e re lindi, kudo qetësi dhe kushdo shikon punën e tij. Dhe ja muret u rrëzuan. Jini të lirë të shikoni qartë valën e kohës që do t'ju rrëmbjë. . . »

* * *

Dora e punëtorit ndreq dhe vallja e jetës përdron këngët.

Nën hijen e minaresë, disa përmendore kanë mbetur dhe po shikohen si sytë e ballit prej të tërëve, se ato ruajnë kujtimet e një bote që përrëndon

Ora tingëllon dhe zhurma e automobilave shkatron qetësinë e oborrit të shtëpisë pa mure.

Kova mengadalë po i ngjitet pusit të Xhamisë dhe besnikët e heshtur po i falen Perëndisë për përmirësimet që shohin.

Ndryshoi ecja jonë. Shpejtoi.

Dhe fshesa e kohës mengadalë mbledh disa mbeturina që kujtonin — oh se ç'kujtonin!

Vetëm përmendoret asnjë s'i trazon. Përkuandrazi i ndreqin, i përmirësojnë, se ato dikur do të na pasqyrojnë të kaluarën tonë.

* * *

«Çak», «çuk», «çak», «çuk»!

Qëllon çekiçi. . . Ndeq rrugën, ku u rrëzuan muret që humbisnin nën hijen e minareve dhe nga do të shkelë këmba e kohës së re.

(Gazeta «SHTYPI», nr, 71, dt, 12 Gusht 1937).

PËRMBAJTJA

I. TREGIME

1. VARFËRIA	17
2. ZIA	13
3. SHËNJTORJA E VOGËL	16
4. SHPRESA	29
5. VDEKJA E SHOKUT	24
6. DERËSHUARI	36
7. KËRKONTE VDEKJEN	42
8. «KËSMET»	61
9. VAJZA E VALAVE	56
10. KUR TALLET DHE FATI	51

II. SKICA DHE VËZHGIME

1. PROVIM	67
2. Ramazan	68
3. Pazar i mbarë	69
4. Udhëtim nga Ballkani, në Llonon, Berlin	70
5. Vërtet u ngjall?	76
6. Tre me zero	79
7. Kur nderon ushtari	81
8. Abuzime dhe skandale	83
9. Si do të priten deputetët	85
10. Udhë e mbarë	87
11. Në krua... të qytetit	90
12. Shtëpia ime	92
13. Kursali na burra	94
14. Përthimet e reja	97
15. Streha vorfnore	99
16. Urdhëri i ditës	101
17. KËNGA E diktaturës	103
18. Diktatura e ndritur	106
19. Këtu apo atje?	109
20. Eja në vete!	111
21. Nesër	113

	faqe
22. Java e zezë	115
23. Grindje	117
24. Një përgjigje	119
25. Dje	121
26. Shok i dashur	123
27. Doktor	125
28. Pikat e shiut	127
29. Andrea	129
30. Pará! Pará!	131
31. Njëra anë	133
32. Ana tjetër	135
33. Hidhi poshtë	138
34. Legata	140
35. Kundërmimi	142
36. Biseda në punë	144
37. Vagabondi	146
38. Ligjërimi	148
39. Botime që s'na nderojnë	151
40. Dobësi	154
41. Kuvëndime me njerëzit e penës	156
42. Bisedime me	160
43. Shëtitja	164
44. Për 2000 fr. ari	166
45. Kush?	168
46. Komedia	170
47. Fallxhesha	172
48. Edhe unë njoha një njeri	174
49. Do ta qaj	176
50. Misër	178
51. Lutja	180
52. Nga çengeli në... tabut	182
53. Një vajzë shkruan	184
54. Drama ime	186
55. Nga koka në këmbët	188
56. Ç'thotë një koleg	190
57. Hëna e re	193
58. Sa janë?	195
59. «Barbiere di Seviglia»	197
60. Nën hien e minarevet	199

JANE NË QARKULLIM

Letërsi artistike e autorëve shqiptarë

		Lekë
Q. STAFA	— Qortimet e vjeshtës	15
F. PAFRAMI	— Dy drama — Në tufan — Mbi gërmadha	30
DH. S. SHUTËRIQI	— Fyelli i Marsiasit (Tregime)	40
S. SPASSE	— Kurora e rinisë (Shkrime të zgjedhura)	50
A. VARFI	— Në zgjim	40
S. XHAI	— Premtimi i heshtur (Tregime)	40
TH. KACORI	— Për mëmëdhenë vëll. II (Roman)	45
A. ÇAÇI	— Flamuj të kuq (Poezi)	20
TOMIL	— Letër perëndisë (Vjersha satirike)	20
A. SKANJETI	— Nora (Dramë)	30
N. JORGAQI	— Ëndra dhe plagë (Novelë)	25
M. GREBLESËI	— Albumi i një bojaxhiu (Tregime)	30
Q. BUXHELI	— Një ndodhi në plazh (Tregime)	40
R. BEDO	— 100 episode partizane	50
A. MAMAQI	— Ëndëra vashërie (Poezi)	30
S. PITARKA	— Familja e peshkatarit (Dramë)	30
Z. SAKO	— Njerëz dhe ngjarje (Tregime)	30
R. NEPRAVISHTA	— Pelikanët ndrojnë fole (Roman)	40
A. CERGA	— Njeri i zakonshëm	30
M. KALLAMATA	— Shokë lufte (Tregime)	15
S. ANDONI	— Dasmë e çuditëshme (Tregime)	25
DH. QIRIAZI	— Ballada intime (Poezi)	15
M. XHAXHIU	— Vargje për dashurinë	20